

'Ndërtimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile për Evidentimin dhe Monitorimin e Reformës së Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, 2009-2011'

Analiza e Kontekstit & Kronologjia e Reformës së Sektorit të Sigurisë në Shqipëri 1991-2009

**INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
TIRANË**

Ky publikim është një produkt i projektit "Ndërtimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile për Evidentimin dhe Monitorimin e Reformës së Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, 2009-2011", i cili financohet nga Ministria e Jashtme e Mbretërisë së Norvegjisë. Ky projekt rajonal përfshin 7 organizata kërkimore nga Shqipëria, Bosnja & Herzegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Ky produkt u zhvillua në bashkëpunim me DCAF (www.dcaf.ch) dhe BCSP (www.ccmr-bg.org)

Shkurt 2011

Përmbajtja:

Shkurtime	2
Hyrje	4
Periudha I: Rënia e komunizmit dhe e strukturave të sistemit të vjetër (1991-1997)	7
Periudha 2: Rikthimi i normalitetit dhe orientimi Euro-Atlantik i reformave (1997 - 2000)	15
Periudha 3: Konsolidimi i institucioneve të sektorit të sigurisë dhe mbikëqyrjes (2000 - 2009)	21
Përfundime	33
Aneksi 1: Analiza e aktorëve kryesorë politikë	35
Bibliografia	38
Kronologjia e Reformës së Sektorit të Sigurisë në Republikën e Shqipërisë	49

Shkurtime

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FA	Forcat e Armatosura
ICITAP	International Criminal Investigative Training Assistance Program
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KM	Këshilli i Ministrave
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MB	Ministria e Brendshme
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MRP	Ministria e Rendit Publik
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
NJIF	Njesia e Inteligjencës Financiare
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PAMECA	Police Assistance Mission of the European Community to Albania
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PD	Partia Demokratike
PIP	Programi Individual i Partneritetit
PIU	Prisons' Intelligent Unit
PpP	Partneriteti për Paqe
PP	Prokurori i Përgjithshëm
RSS	Reforme Sektorit të Sigurisë
PPSH	Partia e Punës e Shqipërisë
PSA	Procesi i Stabilizim Asocimit
PS	Partia Socialiste
PSH	Policia e Shtetit
PVA	Plani i Veprimtimit për Anëtarësim
RSS	Reforma e Sektorit të Sigurisë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHIK	Shërbimi Informativ Kombëtar
SHISH	Shërbimi Informativ Shtetëror
SHIU	Shërbimi Informativ i Ushtrisë
SHKB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
SHPS	Shoqëritë Private të Sigurisë
SKM	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes
SSRP	Strategjia Sektoriale e Rendit Publik

Hyrje

Ky studim analizon kontekstin në të cilin është zhvilluar Reforma e Sektorit të Sigurisë (RSS) në Shqipëri që nga rënia e regjimit komunist. Studimi është konceptualizuar në tre periudha kryesore, në funksion të veçorive shoqërore, politike, dhe ekonomike. Nën këtë këndvështrim fillimi i **periudhës së parë** përkon me rënien e regjimit komunist **në vitin 1991 dhe përfundon me krizën e vitit 1997.**

Megjithëse Shqipëria nuk u përfshi në konflikte të armatosura apo ripërcaktim kufijsh, çka ndodhi me vendet e ish-Jugosllavisë gjatë viteve 1990, ajo vuajti prapambetjen e shkaktuar nga politika e izolimit që u ndoq gjatë Luftës së Ftohtë. Kjo periudhë karakterizohet më së shumti nga kryerja e reformave të gjeneratës së parë: krijimi i institucioneve dhe strukturave të reja si dhe të linjave të reja të përgjegjësisë për sektorin e sigurisë. Sidoqoftë procesi i reformave të gjeneratës së parë nuk përfundoi si rezultat i krizës së vitit 1997 e cila çoi në rënien e qeverisë. Këto ngjarje shënojnë dhe fillimin e **periudhës së dytë: nga viti 1991 në 2000.**

Konteksti dominues gjatë periudhës së dytë (duke u nisur nga vetë kriza e vitit 1997, lufta e ashpër politike e cila kulmoi me destabilizimin dhe rënien e qeverisë në vitin 1998, dhe krizën e Kosovës që vijoi) kuadrohet në atë post-autoritar dhe pjesërisht me tipare post-konflikti. Kjo periudhë mund të quhet dhe si lidhëse midis fundit të reformave të gjeneratës së parë dhe reformave të gjeneratës së dytë - ato reforma të cilat përqëndrohen në përforsimin e strukturave për qeverisjen dhe mbikqyrjen demokratike të sektorit të sigurisë. **Periudha e tretë** dhe e fundit fundit, konkretisht ajo **nga viti 2000 deri në vitin 2009**, nisur nga hapi i reformave, ka qenë më realiste dhe përfituese për vendin nëpërmjet konsolidimit e institucioneve të sigurisë dhe qeverisjes së tyre.

Kjo analizë konteksti ndjek një linjë kronologjike dhe analizon secilin aktor të sektorit të sigurisë nën perspektivën e faktorëve që kanë formësuar qëndrimet dhe sjelljen e tyre si dhe marrdhëniet me aktorët e tjerë dhe kontekstin në përgjithësi.



PERIUDHA I: RËNIA E KOMUNIZMIT DHE E STRUKTURAVE TË SISTEMIT TË VJETËR (1991-1997)

Ky kapitull analizon RSS gjatë periudhës së viteve 1991-1997. Kjo periudhë u karakterizua nga tre ngjarje kryesore: së pari rënia e komunizmit dhe organizimi i zgjedhjeve të para pluraliste në vitin 1991, së dyti ishin zgjedhjet e vitit 1992 të cilat shënuan shkëputjen përfundimtare me sistemin komunist, dhe së fundi kriza e vitit 1997 gjatë së cilës autoriteti i shtetit dhe i institucioneve u shemb tërësisht, megjithëse për një kohë të shkurtër. Fillimisht ky kapitull analizon kontekstin e përgjithshëm politik, duke u përqëndruar në forcat kryesore të brendshme dhe të jashtme të cilat ndikuan në drejtimin dhe përmbajtjen e reformave dhe më pas do të analizojë me radhë aktorët e sistemit të sigurisë, duke parë karakteristikat e reformës dhe rolin e luajtur nga secili aktor.

Duke qenë së pari një proces politik (OECD DAC: 2007:28), i cili kushtëzohet nga vullneti i partive politike dhe parlamentarëve për të kryer reformat (Born: 2002), RSS në Shqipëri fillon me krijimin e parlamentit të parë pluralist në mars të vitit 1991. Megjithatë, rezultatet e dy zgjedhjeve të njëpasnjëshme të mbajtura brenda një kohe të shkurtër, në vitin 1991 dhe 1992 ndikuan në mënyrë të veçantë për shkak të natyrës së konfliktit politik të dalë nga këto zgjedhje së bashku me trashëgiminë politike dhe institucionale, përcaktuan drejtimin dhe përmbajtjen e RSS.

Sektori i sigurisë ishte tepër i politizuar gjatë regjimit komunist dhe shërbente si instrumenti kryesor për mbajtjen e pushtetit politik, kështu që reforma e këtij sektori shihej si sfidë kryesore nga Opozita. Edhe fitorja e PPSH-së¹ në zgjedhjet e para pluraliste të vitit 1991 u pa nga Opozita si një rezultat i ndërhyrjes dhe mbështetjes së strukturave të sigurisë (Vickers & Pettifer: 1997). Kështu reforma e këtij sektori u kthye në çështje kyçe për periudhën deri në zgjedhjet e vitit 1992. Megjithëse PS² kishte shumicën në

¹ Partia e Punës e Shqipërisë (PPSH), fitoi zgjedhjet me 67 përqind të vendeve në parlamentin e parë pluralist.

² Në qershor të vitit 1991, PPSH-ja u transformua në Partia Socialiste e Shqipërisë.



parlament edhe ajo mbështeti shkëputjen nga aparati i vjetër i sektorit të sigurisë dhe dha mbështetjen e saj në këto reforma. Për pasojë, në periudhën ndërmjet dy zgjedhjeve, 1991-1992, u miratuan shumica e ligjeve kryesore për depolitizimin e sektorit të sigurisë dhe reformimin e institucioneve kryesore si ushtria, policia dhe shërbimet sekrete.

Mbas fitores së zgjedhjeve në vitin 1992 Partia Demokratike (PD), u bë forca me ndikim kryesor për drejtimin e reformave. PD-ja kontrollonte një shumicë të konsiderueshme të vendeve në parlament³ dhe gëzonte mbështetje të fuqishme ndërkombëtare. Kriza e identitetit politik dhe ndarjet e brendshme brenda PS-së e lejuan PD-në të shfaqej si aktori dominues i reformave. E shtyrë nga preokupimi për të shkëputur lidhjet ndërmjet institucioneve të sigurisë dhe PS, të cilën PD e konsideronte si vazhdim të PPSH-së, reforma mori drejtimi të gabuar në dy aspekte. Së pari Opozita e cila përfaqësohej kryesisht nga PS u marginalizua nga procesi i reformave dhe së dyti, shumica e personelit u zëvendësua me njerëz besnikë të PD-së (The Economist: 1993:56).

Dominimi i skenës politike nga PD-ja ndikoi në ecjen graduale drejt një forme të re autoritarizmi në të cilin zgjedhjet pluraliste nuk ishin në funksion të shtetit ligjor, ndarjes së pushteteve dhe respektimit të të drejtave themelore (Zakaria: 1997). Trashëgimia e kultit të individit çoi në një formë të re të personalizimit të pushtetit nga ana e Presidentit të Republikës i cili kontrollonte dhe institucionin e fuqishëm të Këshillit të Mbrojtjes.⁴ Gjyqet politike, mediat dhe policia u përdorën si instrumente kundër anëtarëve të Opozitës dhe kujtdo që shprehte pikpamje të ndryshme nga ato të shtetit (Human Rights Watch: 1996). Të gjitha këto patën ndikim negativ mbi reformat pasi minuan profesionalizmin e institucioneve të sigurisë dhe shmangën rolin mbikqyrës të parlamentit duke e dobësuar atë.

Midis faktorëve të jashtëm një ndikim të madh pati lufta në Jugosllavi, kryesisht për ndikimin që pati në formësimin e marrdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (The Economist: 1993:55) Shqipëria u kthye në një vend me rëndësi strategjike si avanpost për NATO-n dhe veçanërisht për SHBA-të që morën rol kryesor në konflikt. Kështu SHBA-të u bënë donatori i dytë më i madh mbas Italisë, duke dhënë ndihmë ekonomike, poli-

³ PD fitoi 65.7 përqind të vendeve në parlamentin mbas zgjedhjeve të vitit 1992.

⁴ Këshilli i Mbrojtjes kishte kompetenca për të marrë vendime të cilat ishin të detyrueshme për zbatim nga institucionet e sigurisë.



tike dhe ushtarake. Nevoja për një aleat të qëndrueshëm bëri që SHBA-të të mbështeste pa rezerva partinë në pushtet por jo procesin politik në tërësi (Abrahams: 1997). Ky qëndrim i SHBA-ve u mbështet edhe nga shumë kancelari të kryeqyteteve europiane, të cilat konsideronin se mbas rënies së komunizmit Shqipërisë i nevojte një qeverisje e fuqishme (Pettifer & Vickers: 2007:7). Kjo lloj mbështetje nga partnerët kryesorë ndërkombëtarë të Shqipërisë, i dërgoi mesazhin e gabuar qeverisë e cila ndër morri një seri reformash dhe politikash të njëanshme si dhe margjinalizimin e opozitës. Ky qëndrim i partnerëve ndërkombëtarë të Shqipërisë ndryshoi vetëm mbas zgjedhjeve të manipuluar të 26 majit 1996, të cilat u kritikuan ashpër prej tyre (The Economist: 1996:52).

Përsa i përket ekonomisë, megjithëse gjatë kësaj periudhe Shqipëria ndër morri reforma ekonomike më të thella ndërmjet vendeve ish komuniste të Europës, dhe konsiderohej si vend model në këtë drejtim (Dirk.J: 2001), mbas vitit 1995 filloi lindja e një sërë skemash mashtruese piramidale. Nën presionin e zgjedhjeve, qeveria i injoroi paralajmërimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe nuk ndërhyri për ti mbyllur këto skema, dhe duke synuar të nxirrte përfitim politik në zgjedhje i dha dhe besueshmëri shtetërore (Jarvis: 1999). Kur skemat piramidale u shembën në janar 1997, qeveria e cila që prej zgjedhjeve shihej si e korruptuar politikisht u perceptua nga publiku edhe si përgjegjëse për humbjet financiare. Revoltat që shpërthyen çuan në rënien e autoritetit të shtetit, vendi ra në anarki dhe shumë qytete u morrën nën kontroll nga civilë të armatosur. Normaliteti u kthye vetëm me ndërmjetësim të fuqishëm ndërkombëtar dhe prezencën e një formce ushtarake shumëkombëshe e cila ndihmoi në rikthimin e rendit publik dhe ndihmoi në mbrojtjen e procesit zgjedhor (Human Rights Watch: 1998).

Analiza Sektoriale

Reforma në mbrojtje

Politika e izolimit e ndjekur nga regjimi komunist për mbi 30 vjet pati pasoja rrënuese si mbi politikën e mbrojtjes ashtu edhe në modernizimin e pajisjeve. Kështu, reforma në fushën e mbrojtjes duhet të adresonte çështje të tilla si ripërcaktimin e konceptit të mbrojtjes, depolitizimin, profesionalizimin dhe reduktimin e forcave të armatosura (FA) si dhe krijimin e kuadrit ligjor dhe institucional për të siguruar kontrollin demokratik.



Reduktimi i forcës dhe i bazave ushtarake avancoi në mënyrë të konsiderueshme për sa i përket numrit, por treguesit mbi cilësinë është e vështirë që të nxirren. Fillimi i luftës në Jugosllavi çoi në rishikimin e reduktimit të forcës si prioritet pasi trupat u dislokuan në kufijtë veriorë. Lufta në Jugosllavi pati efektet e saj edhe mbi konceptet e mbrojtjes dhe sigurisë në tërësi pasi rreziku nga kërcënimi ushtarak i drejtpërdrejtë vazhdoi të ishte prezent në perceptimin e publikut dhe të elitës politike. Megjithatë reduktimi i forcës dhe i bazave ushtarake vazhdoi dhe për të lehtësuar këtë proces Akademia Ushtarake u mbyll për dy vjet. Ajo u rihap vetëm në vitin 1995, kur personeli i FA ishte reduktuar me 40 % (Vickers & Pettifer: 1997: 217). Përveç nevojës për të ndërprerë rekrutimin e oficerëve të rinj, ndërkohë që ushtria i ishte nënshtruar një procesi reduktimi të thellë, ndërprerja e procesit të arsimimit ushtarak kishte si qëllim edhe reformimin e strukturës dhe kurrukulave të akademive ushtarake dhe përshtatjen e tyre me mjedisin e ri (Bazo: 2006).

Si pasojë e mbështetjes ndërkombëtare, Shqipëria u bë vendi i parë nga vendet ish-komuniste të Evropës Lindore që iu bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior dhe Partneritetit për Paqe (PpP) që me gjithë problemet me demokracinë, pati efekte të tjera pozitive. Bashkëpunimi me NATO-n dhe vende anëtare si SHBA-të, Turqia, Gjermania, Italia dhe Britania, rezultoi në një mjet të rëndësishëm për reformat gjatë kësaj periudhe, pasi i dha mundësinë e veçantë një numri të konsiderueshëm personeli të FA të marrë pjesë në stërvitje dhe trajnime të NATO-s, dhe të sjellë eksperiencë të vlefshme për rolin dhe mënyrën se si operojnë FA në një sistem demokratik (Çopani: 1996: 24-28).

Megjithatë, ashtu si edhe me reformën në shërbimin civil (The Economist: 1993:56), procesi i reduktimit të forcës u politizua dhe kriteret e promovimit të kuadrove ushtarake ngelën të dyshimta (Bumçi: 2004). Nga ana tjetër imazhi në rënie i ushtarakut, në periudhën menjëherë mbas ndryshimeve demokratike, pagat e ulëta dhe iniciativa për të emigruar jashtë vendit, u bënë pengesa serioze për rekrutimin e personelit cilësor dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira dhe funksionale ndërmjet personelit civil dhe atij ushtarak (Çopani: 1998). Një nga problemet e vazhdueshme ngeli situata e dobët financiare, pasi pothuaj i gjithë buxheti shpenzohej për paga, ushqime dhe veshje për personelin, duke mos lënë mundësinë për shpenzime për stërvitje dhe operacione. Kështu në buxhetin e vitit 1996, 98.4 përqind parashikohej për pagat, ushqimin dhe veshmbathjen e personelit, 1.6 përqind për investime dhe asnjë fond për nevojat operacionale (Çopani: 1998). Një tjetër dobësi e reformës në këtë periudhë ishte përfshirja si pjesë e FA-



së e aktorëve të tjerë të sigurisë si policia dhe shërbimet informative. Duke qenë se Presidenti i Republikës, njëkohësisht edhe Kryetar i Këshillit të Mbrojtjes mund të influenconte tërë procesin e RSS-së,⁵ ai përdori në mënyrë të konsiderueshme shërbimet informative për të ndikuar mbi institucionet e tjera në këtë proces. Roli i shërbimeve informative u duk qartazi gjatë krizës së vitit 1997 kur kreu i Shërbimit Informativ Kombëtar (SHIK) u emërua nga Presidenti si Shef i Shtabit i Operacioneve gjatë situatës së emergjencës, duke shmangur si kreun e ushtrisë, ashtu edhe atë të policisë (Luarasi: 1997).

Reforma në Polici

I parë si instrumenti kryesor represiv i diktaturës dhe nisur nga deklaramë se forcat e policisë dhe të sigurisë kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve të marsit 1991, reforma e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), e cila përfshinte të gjitha forcat e brendshme të sigurisë dhe policisë në vend, u bë një nga prioritetet kryesore të opozitës. Në korrik 1991, vetëm katër muaj mbas zgjedhjeve, parlamenti miratoi një paketë ligjesh për reformimin e MPB-së. Koncepti dominues i reformës ishte ndarja e shërbimeve informative dhe të sigurisë nga ato policore dhe të ruajtjes së rendit publik. Kështu Drejtoria e Sigurimit të Shtetit u shpërbë dhe funksionet informative i kaluan me ligj Shërbimit Informativ Kombëtar (SHIK), ndërsa strukturat e Policisë Popullore krijuan bërthamën e Ministrisë së Rendit Publik (MRP), por duke u decentralizuar dhe më tej (Bala: 2008). Duke konsideruar se reformat në këtë periudhë konsistonin në strukturimin e institucioneve të sigurisë sipas modeleve demokratike, ndarja e funksioneve policore dhe atyre informative ishte në drejtimin e duhur.

MRP-ja e reformuar përbëhej nga Policia e Rendit Publik, Policia Kriminale, Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë, Policia e Ruajtjes së Objekteve me Rëndësi të Veçantë, Garda e Republikës dhe Policia Gjyqësore, e cila u krijua me dekret të Presidentit në vitin 1995, mbas amendimeve në Kodin Penal (Luarasi: 1997). Megjithatë mbas zgjedhjeve të vitit 1992, reforma në polici nuk konsiderohej më si prioritet i rëndësishëm dhe reforma nuk u ndoq në terma të qartë (Mobek: 2005). Në ndryshim nga rasti i reformave në ushtri, ku dimensionin e jashtëm ndikonte më së shumti nëpërmjet reformave përafuese me NATO-n, modeli i policimit u zhvillua nga brenda dhe refor-

⁵ Këshilli i Mbrojtjes ishte mjaft influent në këtë periudhë pasi vendimet e tij ishin të detyrueshme për t'u zbatuar nga qeveria.



mat nuk i shpëtuan ndikimit dhe objektivave afatshkurtëra. Trashëgimia e sistemit komunist, ku misioni bazë i policisë ishte siguria e shtetit, pati një ndikim të konsidershëm në aftësinë e policisë për t'iu përshtatur nevojave të reja. Si pasojë e mungesës së mekanizmave mbikqyrës dhe predominant të ndërhyrjeve politike, policia u përdor si instrument për të frikësuar kundërshtarët politikë të qeverisë dhe u vu në qëndër të shumë kritikave për shkelje të të drejtave të njeriut gjatë gjithë kësaj periudhe (Human Rights Watch: 1996). Kjo e dobësoi legjitimitetin e policisë duke gërryer mbështetjen e publikut për të.

Mënyra se si policia u përdor nga qeveria, pati ndikime serioze mbi konceptin dhe profesionalizmin e policisë. Kështu gjatë krizës së vitit 1997, policia jo vetëm që dështoi në zgjidhjen me profesionalizëm të situatave por u vu në qëndër të zëmërimit të publikut dhe pësoi dëme të konsiderueshme njerëzore dhe materiale.

Strukturat para-policore

Si rezultat i decentralizimit të funksioneve të MPB dhe i lindjes së nevojave të reja, gjatë kësaj periudhe u krijuan disa struktura para-policore, si: Policia e Zjarrfikësve nën MRP-në, Policia Ushtarake (Ligji Nr.7508:1991) nën Ministrinë e Mbrojtjes (MM), Policia e Doganave dhe Tatimeve nën Ministrinë e Financave (Ligji Nr.7938 & Dekreti Nr.7463:1991), Policia Ndërtimore nën Ministrinë e Ndërtimit, Strehimit dhe Planifikimit të Territorit (Ligji Nr.7623:1992). Megjithatë efektiviteti dhe efënca e këtyre strukturave mbetet e dyshimtë. Duke qenë nën përgjegjësinë e ministrive respektive, procedurat e rekrutimit, trajnimit dhe burimit kanë qenë të pakta dhe për pësojë ato kanë qenë të detyruara që vazhdimisht të mbështeten tek strukturat e policisë në MRP për kryerjen e detyrave të tyre (Hroni: 2007).

Reforma e shërbimeve informative

Gjatë regjimit komunist, i tërë aparati informativ ishte në varësi të Ministrisë së Brendshme. Paketa e reformave e vitit 1991 synoi decentralizimin e aparatit ekzistues informativ duke krijuar katër shërbime të tilla. Shërbimi Informativ Kombëtar (SHIK) i cili përmbante si shërbimin e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm, Shërbimi Informativ i Ushtrisë (SHIU) në Ministrinë e Mbrojtjes, Shërbimi i Kundërzbulimit i Organeve të Rendit



Publik në Ministrinë e Rendit Publik, dhe Shërbimi i Burgjeve nën Ministrinë e Drejtësisë (Bala: 2008). Reforma decentralizuese synonte përmirësimin e performancës së shërbimeve duke i vendosur sa më afër institucioneve të cilat kishin nevojë për informacion, por dominimi i komunitetit informativ nga SHIK-u e pengoi zhvillimin e shërbimeve të tjera.

Siç u përmend më sipër, si rezultat i procesit të lustracionit 98 përqind e personelit të mëparshëm të SHIK u pushua nga puna dhe u zëvendësua me personel të përzgjedhur mbi kritere partiake. Gradualisht SHIK u kthye në një instrument nën kontrollin personal të Presidentit (Vickers & Pettifer: 1997:131) dhe u përdor si një polici sekrete ndaj kundërshtarëve politikë, gazetarëve dhe intelektualëve të pavarur.

Ashtu si policia, SHIK-u ngeli si pjesë përbërëse e formave të armatosura dhe kishte kompetenca ekzekutive të cilat përfshinin të drejtën e marjes në pyetje dhe mbajtjes në arrest. Këto kompetenca e kthyen SHIK-un në një polici sekrete të frikshme me mjaft influence edhe ndaj institucioneve të tjerë të sigurisë dhe segmenteve të tjera të shtetit.

Reforma e gjyqësorit

Përsa i përket reformës së gjyqësorit, legjislati i ri përcaktoi parimet e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, detyrimin që gjyqet të zhvillohen të hapura për publikun dhe respektimin e konventave ndërkombëtare. Për t'i dhënë më shumë pavarësi gjyqësorit, gjyqtarëve dhe prokurorëve iu garantua me ligj imuniteti ndaj hetimit. Autoriteti për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve dhe prokurorëve iu dha Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Gjyqësori u organizua në tre nivele: Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Kasacionit (Ligji Nr.7574: 1992). Për mbrojtjen e zbatimit të Kushtetutës dhe për të bërë interpretimin korrekt të saj, u krijua Gjykata Kushtetuese. Legjislati i ri u miratua në drejtim të mbrojtjes së të drejtëve themelore të njeriut, përfshirë dhe ratifikimin e Konventës Evropiane për të Liritë Themelore dhe të Drejtat e Njeriut. Po kështu u miratuan Kodi Penal i ri dhe Kodi Penal Ushtarak i ri. Megjithatë, me gjithë progresin e shënuar në drejtim të miratimit të legjislatit dhe riorganizimit institucional dhe strukturor, gjyqësori vazhdoi të ishte subjekt ndërhyrjesh nga ekzekutivi dhe u përdor për qëllime politike (Human Rights Watch: 1993). Përveç ndërhyrjeve politike, gjyqësori filloi të vuante edhe korrupsionin, një fenomen i panjohur deri në ata kohë.



Kompanitë private të sigurisë

Liberalizimi dhe zhvillimi i ekonomisë së tregut çoi në mënyrë të pashmangshme drejt kërkesës për rregullimin e kërkesë-ofertës edhe në tregun e sigurisë. Kështu u miratua legjislacioni që në vitin 1993, i cili rregullonte kërkesat themelore në këtë drejtim si kriteret për rekrutimin e personelit dhe limitin e numrit të personelit që shoqëritë private të sigurisë (SHPS) mund të rekrutonin në nivel rrethi / qarku. MRP-ja ishte përgjegjëse për liçensimin dhe kontrollin e aktivitetit të tyre (Ligji Nr.7696: 1993 & Ligji Nr.7985: 1995). SHPS-të ofronin kryesisht shërbime sigurie për bankat, biznese të huaja, institucione ndërkombëtare, mediat private etj, por dhe mbrojtje fizike personale, duke kontribuar në përmirësimin e sigurisë publike, veçanërisht në parandalimin e krimeve. Sidoqoftë, edhe ky sektor megjithëse privat, nuk u kursye nga politizimi nëpërmjet seleksionimit mbi baza partiake në dhënien e liçensave (Rynn et al: 2005).

Media dhe shoqëria civile

Proceset demokratike krijuan kushtet për lindjen e mediave të pavarura dhe të grupeve të pavarura të interesit. Në këtë periudhë, media në veçanti, por edhe organizatat e shoqërisë civile, gjithashtu u zhvilluan mjaft, por ato ngelën në nivelin e grupeve të presionit. (Çili: 2005). Trysnia mbi mediat dhe grupimet e pavarura, përfshirë dhe burgosjet, e kushtëzuan shoqërinë civile dhe mediat që të përqendroheshin më shumë në denoncimin e shkeljes së standardeve demokratike, se sa të përqendroheshin në cilësinë dhe hapin e reformave (Amnesty International Albania: 1994; 1995; 1996; 1997).



PERIUDHA 2: RIKTHIMI I NORMALITETIT DHE ORIENTIMI EURO-ATLANTIK I REFORMAVE (1997 - 2000)

Ky kapitull analizon RSS-në gjatë periudhës 1997 – 2000. Dështimi i qeverisë dhe institucioneve të sigurisë për të zgjidhur në mënyrë paqësore krizën e vitit 1997, nxorri në pah edhe dobësitë e reformave në sektorin e sigurisë. Për pasojë, vetë kriza dhe pasojat e saj shënuan një pikë kthese për kursin e reformave në Shqipëri. Megjithëse e shkurtër, kjo periudhë u shënuan nga ngjarje me rëndësi të madhe siç ishin:

- Miratimi i Kushtetutës e cila ishte kthyer në një çështje të nxehtë politike që nga rënia e komunizmit
- Vrasja e njërit prej themeluesve të PD-së njëkohësisht edhe deputet Azem Hjadari
- Një tentativë për marrjen me dhunë të institucioneve që e rriti dhe më tej tensionin politik
- Kriza e Kosovës dhe e refugjatëve që vërshuan me qindra mijra në Shqipëri
- Dhënia nga NATO-ja e Planit për Veprim të Antarësimit (PVA) në Samitin e Uashingtonit
- Formalizimi i marrëdhënieve me Bashkimin Europian nëpërmjet Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA)

Zgjedhjet e qershorit 1997 rikthyen në pushtet PS-në mbas pesë vjetëve në opozitë. Si rezultat i efekteve shkatërruese të krizës, sfidat e menjëherëshme të qeverisë së re ishin normalizimi në tërësi i rendit ekonomik dhe shoqëror. Situata politike ngelej e tensionuar pasi PD-ja refuzoi të njihte rezultatet e zgjedhjeve dhe legjitimitetin e të gjithë institucioneve të dala nga parlamenti. Po kështu ajo refuzoi deri në fund pjesëmarrjen në procesin e formulimit të draftit të kushtetutës dhe praktikën bllokuese të procesit përfshin protestat në rrugë, bojkotim të institucioneve dhe greva urie (East European Constitutional Review: 1998). Vrasja e njërit prej figurave më të rëndësishme të PD-së dhe tentativa për rrëzimin e pushtetit që vijoi, ishte një provë e përsëritur për institucionet e sigurisë. Si pasojë e krizës politike që pasoi këto ngjarje qeveria ra, por PS-ja kishte shumicë të qëndrueshme në parlament dhe formoi një qeveri të re.



Me gjithë destabilitetin politik, Kushtetuta u miratua në nëntor 1998 dhe u bë referenca themelore për reformat e mëtejshme. Kushtetuta parashikonte një shpërndarje më të balancuar të pushteteve dhe kompetencave. Kështu Presidenti do të kishte kompetenca më të vogla kundrejt parlamentit, Këshillit të Ministrave (KM) dhe Kryeministrit. Presidenti vazhdoi të ishte Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe kreu i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, por tashmë vetëm si organ këshillimor, i ndryshëm nga Këshilli i Mbrojtjes. Pothuajse i gjithë legjislacioni që rregullonte organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sigurisë u rishikua ose amendua duke e sjellë konform me kërkesat dhe parimet e Kushtetutës. Megjithatë Opozita mbajti qëndrim kundër reformave të cilat patën pësojë ngadalsimin e zbatimit të tyre veçanërisht në reformën në polici dhe gjyqësor. Edhe në këtë rast pati lëvizje në masë të personelit dhe shumë prej atyre që ishin larguar mbas ardhjes në pushtet të PD-së në vitin 1992 u rikthyen, kryesisht në shërbimet informative dhe policore. Opozita e kundërshtoi këtë praktikë duke pretenduar se PS-ja po përpiqej të rikthente aparatin e kohës së komunizmit.

Përsa i përket faktorëve të jashtëm, përfshirja e NATO-s në krizën e Kosovës pati një ndikim të madh si në përmbajtje ashtu edhe në shpejtësinë e reformave. Pasojat e krizës së vitit 1997 dhe kriza në Kosovë, që po merte dimensione më shqetësuese, bënë që NATO-ja dhe vendet aleate të ndërhynin me shpejtësi për të asistuar reformat në Shqipëri. Për rrjedhojë, ndërsa Operacioni i NATO-s *Allied Force* vazhdonte në Kosovë, Shqipërisë iu dha Plani i Veprimit për Anëtarësim, duke u bërë kështu i pari vend i Ballkanit Perëndimor që mernte një plan të tillë.⁶ Kjo ngjarje, së bashku me lëshimin e Procesit të Stabilizim Asociimit nga Bashkimi Evropian e drejtuan kursin e reformave drejt integritit të plotë Euro-Atlantik.

Analiza Sektoriale

Reforma në mbrojtje

Gjatë analizës së periudhës së parë pamë se përpjektjet për zhvillimin e një modeli modern mbrojtjeje dështuan dhe po kështu edhe mbikqyrja demokratike. Për më tepër trazirat e vitit 1997 shkaktuan dëmtime serioze

⁶Vendet e tjera që morën PVA ishin Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Maqedonia, Rumania, Sllovakia, dhe Sllovenia.



të infrastrukturës dhe kapaciteteve ushtarake. Për pasojë reforma duhej të adresonte të dy aspektet; zhvillimin e një koncepti të ri mbrojtjeje dhe përmirësimin e kapaciteteve teknike të cilat edhe pa dëmtimet e sjella nga kriza ishin të vjetëruara.

Menjëherë mbas formimit, qeveria e re i kërkoi zyrtarisht mbështetje NATO-s, e cila iu përgjigj pozitivisht kërkesës duke i dhënë Shqipërisë Programin e Individual të Partneritetit (PIP) (Solana: 1997). PIP, i cili rinovohej çdo vit (NATO Update: 1999), përbëhej nga dy shtylla; shtylla e parë ishte asistenca e NATO-s për trajtimin e çështjeve konceptuale, strukturore dhe teknike; dhe e dyta synonte kanalizimin e asistencës bilaterale nga vendet aleate dhe partnerët në mënyrë të koordinuar nëpërmjet një forumi të quajtur Clearing House (Katsirdakis: 1998). Për të koordinuar zbatimin e PIA-s, në qershor 1998, NATO hapi Zyrën e Partneritetit për Paqe në Shqipëri (NATO: 1998).

Në janar 2000, parlamenti miratoi për herë të parë dokumentin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (2000) dhe Politikën e Mbrojtjes (Dokumenti i Politikës të Mbrojtjes: 2000). Këto dokumente reflektonin progresin e arritur që nga fillimi i proceseve demokratike dhe kriza e vitit 1997 si dhe miratuan një koncept të ri të sigurisë duke shtruar objektiva për reformat strukturore që do të zhvilloheshin gjatë dhjetë viteve të ardhshme. Në këtë fazë, reforma në FA ishte e përqëndruar në riorganizimin strukturor dhe rregullimin e linjës së komandimit ushtarak, rritjen e kapaciteteve operacionale dhe efektivitetin dhe zhvillimin e Komand, Kontroll, Komunikimit dhe Informacionit (C3I) (Abazi: 2004).

Reforma në polici

Reforma në polici ishte një çështje tjetër e rëndësishme që duhej adresuar mbas krizës së vitit 1997. Qëllimi i reformës në polici ishte zhvillimi i një koncepti të ri policimi dhe krijimi i një force moderne policore të bazuar në modele demokratike. Por për shkak të mosmarrëveshjeve politike, numrit të madh të armëve të paligjshme në duart e popullsisë dhe problemet e krijuara nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, e bënë reformën në polici të ecte ngadalë dhe me probleme. Incidentet e dhunshme dhe konfrontimi i bandave të armatosura me policinë ishin të shpeshta (Human Rights Watch: 1999). Për shkak të trajnimit të dobët dhe problemeve të tjerë strukturore dhe logjistike, gjatë periudhës 1997-2000 u vranë mbi 100 policë (Smith:



2000). Mbas miratimit të ligjit për Policinë e Shtetit (PSH), i cili u miratua në dhjetor 1999, MRP-ja filloi ristrukturimin e forcës policore. Ligji e shkëputi policinë nga FA-të duke e orientuar atë drejt konceptit të policimin në komunitet. Reforma në polici u mbështet nga asistenca ndërkombëtare shumëpalëshe dhe bilaterale, e cila konsistonte në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit, përmirësimin e menaxhimit të kufijve, rritjen e kapaciteteve në luftën kundër krimit të organizuar, përmirësimin e procedurave të rekrutimit dhe trajnimit e eprorëve të policisë (Mobekk: 2005). Megjithatë policia u bë objekt kundërshtimesh dhe kritikash për çështje si korrupsioni, mungesa e profesionalizmit dhe ndikimi politik.

Strukturat para-policore

Proceset reformuese në këtë periudhë çuan në krijimin e strukturave të reja para-policore si: Policia e Burgjeve në varësi të MD-së, e cila ishte përgjegjëse për sigurinë në burgje dhe zbatimin e rregullave të brendshme (Ligji Nr.8321: 1998), Policia Ndërtimore e cila ishte përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e ndërtimeve dhe planifikimit urban (Ligji Nr.8408: 1998), Policia Bashkiake dhe e Komunave, në varësi të njësive të pushtetit lokal, e cila ishte përgjegjëse për garantimin e rendit dhe ecurinë e punëve publike në territorin e bashkive dhe komunave, për ato funksione që nuk mbuloheshin nga PSH-ja (Ligji Nr.8224: 1997). Policia Elektrike monitoronte zbatimin e legjislacionit në menaxhimin dhe përdorimin e energjisë elektrike (Ligji Nr.8637: 2000).

Reforma e shërbimeve informative

Evidentimi i SHIK-ut si organ i rëndësishëm gjatë krizës së vitit 1997, dhe reputacioni që kishte krijuar gjatë viteve të fundit, e bënë atë një nga objektet kryesore të sulmeve të njerëzve të armatosur, çka rezultoi në dëmtime të rënda të infrastrukturës së institucionit, por edhe në humbjen e jetës së personelit. Kjo situatë çoi në vendimin e pazakontë të Qeverisë së Stabilitetit për të pezulluar aktivitetin e institucionit dhe bllokimin e fondeve për të (UNHCR: 1998). Ligji i ri i miratuar në tetor 1998 e shkëputi SHIK-un nga FA-të, duke i dhënë një mandat tërësisht informativ, pa kompetenca ekzekutive (Ligji Nr.8391: 1998). Përveç detyrave tradicionale të zbulimit dhe kundërzbulimit, ligji i ri e ngarkonte SHIK-un me detyra informative ndaj kërcënimeve të reja si terrorizmi, prodhimi i narkotikëve, trafiqet e pa-



ligjshme dhe krimi i organizuar. Ligji përcaktonte dhe krijimin e një komisioni parlamentar për mbikëqyrjen e këtij institucioni.

Kuadri i ri ligjor dhe kontrolli më i balancuar i SHIK-ut nga Presidenti dhe Kryeministri, çuan në përmirësimin e performancës dhe imazhit të tij. Veçanërisht puna e SHIK-ut u lavdërua kur arriti të çrrënjoste në vitin 1998 disa celula ilegale të terroristëve islamikë që operonin në Shqipëri. Megjithatë aktiviteti i SHIK-ut nuk i shpëtoi trysnive politike të ndryshme. Opozita e akuzoi SHIK-un se qëndronte mbas vrasjes së deputetit Azem Hajdari dhe ushtri trysni për largimin nga detyra të drejtorit të saj. Nga ana tjetër SHIK-u u vu nën trysninë e rivalitetit ndërmjet Kryeministrit dhe Presidentit, të cilët konkuronin për kontrollin e tij (East European Constitutional Review: 1999). Në kuadrin e reformës në FA, u krijua Drejtoria e J2 e cila kishte si mision të prodhonte informacion për nevojat të Forcave të Armatosura (Bala: 2008).

Reforma e gjyqësorit

Në lidhje me reformën në gjyqësor nuk pati ndryshime të dukshme, përveç krijimit të zyrës së Avokatit të Popullit (AP) e cila sanksionohej nga Kushtetuta. Ligji për rregullimin e aktivitetit të AP-ë u miratua në shkurt 1999 (Ligji Nr.8454: 1998), dhe Avokati i parë u zgjodh nga parlamenti në vitin 2000. Me miratimin e Kushtetutës, e cila vendoste bazat për sistemin e gjyqësorit Parlamenti miratim ligjin e ri për organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit në dhjetor 1998. Megjithatë, ndërhyrja e politikës dhe korrupsioni vazhduan të mbeten kërcënime kryesore për mirëfunksionimin e gjyqësorit në këtë periudhë (American Bar Association: 2001).

Kompanitë private të sigurisë

Si rezultat i së pasigurisë së përgjithshme të krijuar nga trazirat e vitit 1997, numri i lartë i bandave kriminale të armatosura dhe sasia e madhe e armëve dhe municioneve në duart e popullsisë civile, vetë koncepti i sigurisë dhe perceptimi i rrezikut kishin ndryshuar. Kështu për bizneset në veçanti, varësia ndaj kompanive të sigurisë private u rrit, ta cilat kryesisht ofronin mbrojtje fizike dhe mbrojtje personash. Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor operonin një numër i madh kompanish të parregjistruara (Holtom, P. et al.: 2005).



Media dhe shoqëria civile

Media dhe shoqëria civile morën një zhvillim më të madh si rezultat i kuadrit të ri kushtetues i cili ishte më liberal dhe lejonte krijimin e lirë të shoqatave për qëllime të ligjshme. Legjislacioni i miratuar në periudhën 1997-1999 jo vetëm që hoqi kufizimet ndaj medias, duke sanksionuar se 'media është e lirë', por lehtësoi transmetimin e mediave private dhe krijoi Këshillin Kombëtar të Radiotelevizionit, i cili ishte shumë-partiak dhe kishte për mision rregullimin dhe mbikëqyrjen e transmetimeve të mediave elektronike (Ligji Nr.8410:1998). Në maj 2000, Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) u bë një entitet i pavarur. Menjëherë më pas, dy transmetues televizivë të pavarur, TV Klan dhe TV Arbëria, u pajisën me licenca kombëtare.

Operatorët privatë të furnizimit me lidhje interneti filluat të operojnë në treg gjatë viteve 1998-1999, megjithatë deri në vitin 2000 numri i abonentëve vazhdonte të ishte tepër i kufizuar (Freedom House: 2002: A).

Përsa i përket rritjes së transparencës ndaj publikut, me gjithë miratimin e ligjit për rregullimin e këtij aspekti (Ligji Nr.8503: 1999), aksesit ndaj dokumenteve zyrtare ngeli një problem tepër i vështirë (Lora: 2003).

Në përgjithësi, megjithëse kjo periudhë u shënjua nga një epërsi e mediave elektronike në shpërndarjen e informacionit për publikun, u pa se përanësia e informacionit mund të ndikohej jo vetëm nga influencat politike, por edhe nga interesa më të ngushta të biznesit. Përsa i përket zhvillimit të shoqërisë civile, OJQ-të vazhduan të ngelen të dobëta dhe të varura nga financimi nga donatorë të huaj (Freedom House: 2002:B).



PERIUDHA 3: KONSOLIDIMI I INSTITUCIONEVE TË SEKTORIT TË SIGURISË DHE MBIKËQYRJES (1997 - 2000)

Periudha e tretë e zhvillimeve në RSS në Shqipëri, përmbledhet në vitet 2000-2009. Gjatë kësaj periudhe RSS-ja u përqëndrua si në konsolidimin e reformave të kryera në dy periudhat e para, ashtu edhe në ndërmarrjen e reformave të reja.

Rimëkëmbja e institucioneve dhe rivendosja e shtetit ligjor, mbas krizës së vitit 1997, sëbashku me orientimin drejt integritit në NATO dhe BE, i drejtuan reformat drejt një ere të re. Samiti i Zagrebit (2000) dhe Samiti i Selanikut (2003) lehtësuan dhe përcaktuan kursin drejt Procesit të Stabilizim Asociimit (SA) dhe integritit të plotë në Bashkimin Europian. Në shkurt 2003, BE-ja filloi negociatat me Shqipërinë për procesin e Stabilizim Asociimit. Reformat e mëtejshme të ndjekura nga qeveria e PD-së e cila erdhi në pushtet mbas zgjedhjeve të vitit 2005 çuan në nënshkrimin e Marrveshjes së Stabilizim Asociimit. Zbatimi i sukseshmëm i procesit të SA-së, së bashku me nënshkrimin e marrveshjes, shënuan dhe mbylljen e fazës paraprake drejt integritit të plotë në BE.

Si rezultat i konfliktit në Kosovë gjatë vitit 1999 dhe krizës në Maqedoni gjatë vitit 2001, kërcënimi me origjinë nga vendet fqinje vazhdoi të konsiderohej si eminent. Megjithatë në vitet në vijim kërcënimet ndaj sigurisë po orientoheshin më tepër ndaj çështjeve të brendshme. Ky perceptim u pasqyrua si në dokumentin e rishikuar të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (2004) ashtu edhe në Strategjinë Ushtarake (2005), të cilat pohonin se rreziku kryesor për sigurinë nuk buron nga vendet fqinje, por nga mungesa e stabilitetit politik, zhvillimi i dobët ekonomik dhe zgjatja e procesit të tranzicionit (Islami: 2007).

Procesi i RSS-ë edhe gjatë kësaj periudhe u kushtëzua përsëri nga konteksti politik. Mjedisi konfliktual i krijuar si rezultat i konfrontimit ndërmjet partive politike vazhdoi të ngelej tipar kryesor. Kjo situatë bëri që edhe standardi i zgjedhjeve parlamentare dhe lokale të vazhdonte të ishte i ulët dhe të mos



arrinte standartet e kërkuara nga institucionet ndërkombëtare që monitorin dhe mbështesnin proceset demokratike (OSBE: 2000-2009). Në këtë kontekst, partitë e Opozitës (pamvarësisht orientimit të tyre politik), në përgjithësi refuzuan t'i mbështesnin reformat në sektorin e sigurisë, të iniciuara nga qeveria dhe shumica në parlament. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet forcave politike në përgjithësi, çoi në ngadalësimin e reformave.

Mjedisi politik i polarizuar dhe konfliktual pati ndikim edhe në aktivitetin e parlamentit, i cili shpesh u dominua nga axhenda afatshkurtëra. Debatet kundërshtuese dhe polarizimi politik e shmangën vëmëndjen nga çështjet e rëndësishme që lidheshin me reformat. Miratimi i ligjeve të reja ose vonohej për shkak të grindjeve për interesa të ngushta politike ose kryhej në mënyrë të shpejtë pa iu nënshtruar diskutimeve (Komisioni Europian: 2007). Për më tepër ngërçet politike shpesh i penguan përpjekjet e parlamentit për të realizuar reforma të cilat kërkonin miratim me shumicë të cilësuar (kryesisht reforma që lidheshin me gjyqësorin). Megjithëse në përgjithësi legjislativi u përmirësua kontrolli i parlamentit mbi zbatimin e tij nga institucionet e sektorit të sigurisë ngeli i kufizuar. Arsyeja qëndronte në faktin se debati konstruktiv ndërmjet parlamentarëve, por edhe ndërmjet parlamentit dhe qeverisë, të shoqëruara edhe nga mungesa e eksperiencës dhe ekspertizës nga stafet, si të qeverisë ashtu edhe të parlamentit (Van Doel: 2004).

Bashkëpunimi i munguar filloi të shfaqej gjatë viteve 2006-2008 kur parlamenti kaloi disa ligje të rëndësishme për përafrimin e legjislativit shqiptar me *acquis communautaire* të BE-së (European Commission: 2008). Në prag të samitit të NATO-s në Bukuresht ku Shqipëria pritej që të merrte ftesën për anëtarësim, ky konsensus midis PD-së dhe PS-së u shtri më tej dhe çoi në finalizimin e disa amendamenteve kushtetuese në prill 2008. Megjithëse këto amendamente mendohej se do të sillnin përfaqësueshmëri më të mirë dhe stabilitet politik në të ardhmen, u panë me pasoja për balancën midis institucioneve (Venice Commission: 2009) dhe nuk sollën ndonjë rezultat të qëndrueshëm në klimën politike në vend. Me këto amendime vihej në dyshim neutraliteti i Presidentit dhe roli i tij i rëndësishëm mbi institucionet e sektorit të sigurisë dhe gjyqësorit, ndërkohë forcohej pozicioni i Kryeministrit dhe ndikohej pa-anësia e Prokurorisë (Shkëmbi: 2008). Amendimet u kundërshtuan nga shumica e partive politike më të vogla, por kryesisht pasi ato panë se me këto amendime, rëndësia e tyre politike binte. Ato e konsideruan këtë marrëveshje midis PD-së dhe PS-së si marrëveshje të fshehtë (Gazeta Shqiptare: 2008).



Në përgjithësi dallimet midis partive politike gjatë kësaj periudhe buronin nga qëndrime personale të liderëve të tyre më shumë se sa nga dallimet serioze ideologjike apo programore (Freedom House: 2006). Por diferencat politike nuk u kufizuan vetëm në konfliktin ndërpartiak, midis partive të majta dhe të djathta, por edhe brenda vetë partive. Si rezultat i mosmarrëveshjeve brenda PS-së gjatë periudhës 2001-2005, katër qeveri pasuan njëra-tjetrën. Këto kontradikta u reflektuan edhe në sondazhet e opinionit publik, ku 83 përqind e të pyeturve i identifikonin partitë politike si burimin kryesor të konflikteve në vend dhe e shikonin mungesën e stabilitetit politik si me pasoja serioze për interesat kombëtare (UNDP-AIIS: 2004). Këto tendenca patën një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe cilësinë e reformave gjatë gjysmës së parë të kësaj periudhe.

Aspekte të brendshme të reformave

Reformat gjatë kësaj periudhe u karakterizuan nga lëvizje të vazhdueshme të personelit, si përpjekje e partive politike për të kontrolluar institucionet, duke rekrutuar njerëz nga partitë respektive (Bumçi: 2004). Kjo prirje pati ndikim negativ të vazhdueshëm në performancën e institucioneve të sektorit të sigurisë dhe bëri që institucionet të identifikohen me partinë politike në pushtet (Gumi: 2004). Zgjedhjet e vitit 2005, që u fituan nga PD-ja në opozitë, për herë të parë që nga fillimi i proceseve demokratike u karakterizuan nga një kalim më i butë i pushtetit. Transferimi paqësor i pushtetit, pati pasoja pozitive për institucionet e sektorit të sigurisë dhe lejoi një vazhdim të reformave pa tronditjet e provuara në rotacionet e mëparshme.

Me ardhjen në pushtet të koalicionit të udhëhequr nga PD, RSS-ja solli disa prirje të reja, kryesisht në mënyrën e marrjes së iniciativave, të cilat kryesisht ishin treguese të aftësive vendimmarrëse të Kryeministrit të ri. Shumë vendime rutinë merreshin nga vetë Kryeministri duke sjellë vonesa dhe zgjatje të procesit të reformave (European Commission: 2006). Gjatë kësaj periudhe Kryeministri rriti numrin e institucioneve që raportonin drejtpërsëdrejti tek ai ose në Këshillin e Ministrave. Kryeministria, jo vetëm u angazhua vetë në hartimin e legjisllacionit, por e rriti dhe autoritetin e zyrtarëve të lartë. Ky proces centralizimi rezultoi në rritjen e pushtetit të Kryeministrit.

Gjatë kësaj periudhe nga Kryeministri u ndërmorën aksione të cilat dhanë rezultate të prekshme në luftën kundër trafikëve të paligjshme



dhe korrupsionit. Disa amendime ligjore i dedikoheshin rezultateve afatshkurtra, ndërsa masa të tjera u përqendruan në rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional. Megjithatë urgjenca, dhe shpesh herë natyra e tepruar e këtyre veprimeve, ngritën shqetësime në lidhje me abuzimin me pushtetin dhe qëndrueshmërinë e këtyre politikave nga pikëpamja e afatgjatësisë së tyre. Disa masa legjislative gjetën kundërshtimin e medias dhe opininit publik ndërsa disa të tjera u hodhën poshtë nga Gjykata Kushtetuese, pasi preknin të drejtat e individit apo çënonin pavarësinë e institucioneve (European Commission: 2006).

Bashkëpunimi midis dy partive politike më të mëdha zgjati deri në anëtarësimin e plotë në NATO, në samitin e Brukselit në prill 2009. Por mbas zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2009 situata politike u bllokua sërisht. PS-ja refuzoi të hyjë në parlament (me bazë të pretendimeve për manipulim të procesit të zgjedhjeve) dhe kërkoi zgjedhje të parakohshme dhe hetimin e procesit të votimit. Këto zhvillime ndikuan drejtpërsëdrejti në bllokimin e ecurisë së reformave, veçanërisht të atyre që kërkojnë shumicë të cilësuar në Parlament.

Aspekte të politikës së jashtme

Një nga faktorët më të rëndësishëm në nxitjen dhe mbështetjen e RSS-së gjatë kësaj periudhe ka qenë komuniteti ndërkombëtar. Në ndryshim nga periudha e parë dhe e dytë ku SHBA kishte qënë aktori i jashtëm më me influencë, gjatë kësaj periudhe Shqipëria u orientua gradualisht drejt politikave të BE-së. Megjithatë roli i SHBA-ve vazhdoi të ishte veçanërisht i rëndësishëm në RSS. Ndërsa reformat në fushën e mbrojtjes kanë qenë të mbështetura nga SHBA-të dhe NATO-ja, reformat në gjyqësor, polici dhe institucionet e tjera të sigurisë janë mbështetur si nga BE-ja ashtu edhe nga SHBA-të. Një tregues i kësaj dinamike janë financimet për sektorin e sigurisë nga SHBA-të dhe BE-ja. Buxheti i BE-së për dy komponentët – *Asistenca për tranzicionin dhe ndërtimin e institucioneve dhe Bashkëpunimin ndërkufitar* – shënuan rritje me 62.95% për vitet 2007 deri në 2012 (European Commission: 2007-2012). Nga ana tjetër, ndihma e dedikuar për Shqipërinë nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-ve (USAID) u reduktua në 53.9 %, gjatë periudhës 2004-2007 (USAID: 2004-2007).⁷

⁷ Në vitin 2007 buxheti për Shqipërinë i USAID ishte 20 milionë USD ndërsa ai i BE, 61 milion Euro.



Sidoqoftë SHBA-të dhanë një mbështetje politike të fuqishme për RSS dhe partneriteti me SHBA-të njohu dimensione të reja me luftën kundër terrorizmit, mbas ngjarjeve të 11 Shtatorit të vitit 2001. Që në fillim të kësaj fushate Shqipëria mbështeti politikën e SHBA-ve në luftën globale kundër terrorizmit, duke mbyllur organizata joqeveritare me lidhje të mundshme me financimin e terrorizmit, dëbimin e elementëve ekstremistë dhe kontribuoi me trupa ushtarake në operacionet në Afganistan dhe Irak (Binaj: 2004). Me mbështetjen e SHBA-ve, në maj 2003, tre vende partnere të NATO-s - Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia - nënshkruan Kartën e Adriatikut si një partneritet ushtarak (US Department of State: 2009). Vendet nënshkruese u angazhuan për të përfunduar përpjekjet individuale dhe bashkëpunimin për të intensifikuar reformat e brendshme, të cilat rrisnin sigurinë dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Karta e Adriatikut shërbeu si një instrument i pazëvendësueshëm në realizimin e anëtarësimit të Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO.

Për shkak të reformave integruese ka pasur rezultate të prekshme dhe konkretisht rekomandimet që kanë dalë nga institucionet ndërkombëtare, janë formuluar dhe zbatuar në formën e strategjive kombëtare në fusha të ndryshme. Megjithatë shpesh herë iniciativa të tilla kanë anashkaluar dhe dëmtuar nevoja dhe kapacitete vendore pasi janë marrë prej komunitetit ndërkombëtar në mënyrë skematike dhe të papërshtatura me nevojat dhe situatat specifike, duke e mbingarkuar sektorin e sigurisë me një numër të madh strategjish të cilave u mungon autoriteti për t'u zbatuar (Ryan: 2009:311).

Gjatë kësaj faze, qasja e BE-së ndaj Shqipërisë ka qenë e përqendruar në dy aspekte: (1) *reformimi i institucioneve demokratike* dhe (2) *përafrimi i legjislacionit dhe zbatimi i akteve ligjore të harmonizuara*. Megjithatë për shkak të mungesës së stabilitetit politik BE-ja dhe komunitetit ndërkombëtar në përgjithësi, i është dashur të shërbejë si instrument ekuilibri dhe ndërmjetësimi ndërmjet partive politike.

Në raste të caktuara pozicionet e kundërta të aktorëve të komunitetit ndërkombëtar kanë prodhuar tensione në marrëdhënie. Kështu, marrëveshja e arritur në vitin 2003 midis Shqipërisë dhe SHBA-ve në lidhje me mosdorëzimin e ushtarakëve Amerikanë në Gjykatën Ndërkombëtare të drejtësisë (US State Department: 2009), shkaktoi reagim të kundërt në marrëdhëniet me BE pasi një një marrëveshje e tillë ishte në kundërshtim me udhëzimet e BE mbi marrëveshjet bilaterale mbi imunitetin (European Commission: 2007).



Analiza Sektoriale

Reforma në mbrojtje

Në sektorin e mbrojtjes reforma u udhëhoq nga axhenda e integritit në NATO. Gjatë kësaj periudhe në veçanti, reformat në sektorin e mbrojtjes avancuan më shpejtë se sa reformat në sektorë të tjerë (Donais: 2005). Kjo më së shumti sepse konsensusi politik predominoi përse i përket axhendës së reformave të lidhura me integrimin në NATO. Ky konsensus u reflektua dhe në miratimin e vendimit për rritjen e buxhetit prej 0.1 përqind në vit të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) deri në arritjen e standardit prej 2 përqind të PBB-së deri në vitin 2010. Si rezultat i angazhimit politik ky objektiv u realizua që në vitin 2008.

Në kërkim të gjetjes së drejtimit të kursit të reformave në sektorin e mbrojtjes dhe njëkohësisht të përgatitjes për anëtarësimin në NATO, parlamenti shqiptar miratoi në gusht 2002 Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes (SKM), e cila zëvendësoi Dokumentin e Politikës së Mbrojtjes që ishte miratuar në vitin 2000. SKM-ja kërkonte një rivlerësim të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë, ristrukturimin e FA-ve dhe njohjen e anëtarësimit në NATO si objektivin më të rëndësishëm të reformës (Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes: 2002). SKM-ja bazohej në Planin e Veprimit për Anëtarësimin në NATO dhe në Planin Afatgjatë të FA-ve që synonin krijimin e një force profesioniste të vogël dhe efektive sipas standarteve të NATO-s. Për t'ju përshtatur zhvillimeve të sfidave të sigurisë, SKM-ja u rishikua edhe dy herë të tjera. Në dokumentin e rishikuar në maj të vitit 2005, SKM-ja rivlerësoi përsëri mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë dhe ristrukturimin thelbësor të FA-ve (Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes: 2005). Dokumenti i rishikuar në dhjetor 2007 i SKM-së synonte përmirësimin e koncepteve bazë të FA-ve nga sistemi tradicional i mbrojtjes së pavarur në sistemin e mbrojtjes kolektive, në përputhje me angazhimet që buronin nga perspektiva e anëtarësimit në NATO, e cila u realizua në prill 2009 (Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes: 2007).

Reforma në polici

Reformat në polici në përgjithësi u karakterizuan nga politikat afatshkurtra dhe mungesa e vizionit në periudhat e mëparshme por edhe në gjysmën e parë të periudhës së tretë. Dokumenti i rishikuar i Strategjisë së Sigurisë



Kombëtare (SSK), i cili vuri në pah rreziqet nga kërcënimet asimetrike si krimi i organizuar dhe terrorizmi, kërkonte realizimin e një reforme më të plotë të policisë. Kjo solli dhe përmirësimin e reformave në këtë sektor dhe policia filloi të shfaqet si një aktor gjithnjë e më i rëndësishëm në sektorin e sigurisë. Në vitin 2005 MRP dhe Ministria e Pushtetit Lokal (MPL) u bashkuan duke krijuar Ministrinë e Brendshme (MB). Ky bashkim synonte përmirësimin e bashkëpunimit midis policisë dhe administratës vendore dhe në fakt solli disa efekte pozitive në luftën kundër prodhimit lokal të narkotikëve. Kompetencat e Ministrit të Brendshëm u forcuan mjaft dhe MB-ja u bë një aktor më tepër i rëndësishëm dhe më influencë në procesin e RSS-së.

Për të arritur objektivat që buronin nga MSA-ja për rritur efektivitetin e punës së policisë dhe për t'i dhënë një dimension më afatgjatë reformave në këtë sektor, në vitin 2007 Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Sektoriale të Rendit Publik 2007 -2013 (SSRP). Duke parë rritjen e nivelit të sofistikimit të krimit të organizuar gjatë dekadës së fundit, SSRP-ja përcaktoi objektiva të reja në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve me orientim ekonomik dhe financiar, krimit të organizuar, terrorizmit, krimeve me natyrë kibernetike, mbrojtja e dëshmitarëve etj (Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013: 2007). Ndërkohë disa arritje të dukshme ishin realizuar në nivel rajonal dhe më gjerë dhe autoritetet e policisë shqiptare nënshkruan një marrëveshje strategjike me Evropolin, e cila krijonte mundësinë për një bashkëpunim më të afërt dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit me organizatat e huaja partnere (Europol: 2008).

SSRP-ja vendosi dhe themelet e zbatimit të policimit në komunitet, duke ngushtuar hendekun që ekzistonte ndërmjet policisë dhe publikut. Aktorë kryesorë në drejtimin dhe hapin e kësaj reforme ishin organizatat e huaja partnere si ICITAP e Departamentit të Drejtësisë të SHBA-ve, dhe PAMECA e financuar nga BE-ja. Në vijim të këtij orientimi që buronte nga SSRP-ja u miratua Plani i Veprimit për Policimin në Komunitet 2008-2010, me qëllimin rritjen e legjitimitetit dhe efektivitetit të strukturave policore. Megjithatë zbatimi i reformës ka ecur ngadalë pasi koncepti i policimit në komunitet ka hasur vështirësi për shkak të traditës së policimit, trajnimit dhe nivelit të ulët të bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe pushtetit lokal (Baka: 2009).

Në përpjekje për të bërë një ndarje më të qartë të punës së MB-së dhe PSH-së, ligji për policinë u rishikua nga parlamenti në vitin 2007 (Ligji Nr. 9749: 2007). Ligji shkaktoi reagime negative të Avokatit të Popullit dhe shoqërisë



civile të cilët dhe u përjashtuan nga procesi i hartimit të ligjit. Grupe të shoqërisë civile kërkuan që ligji duhet të rishikohet për shkak të mospërputhjeve me standardet ndërkombëtare, por edhe me kuadrin e ligjit shqiptar në tërësi (NOSA:2006). Megjithatë këto pretendime nuk u morën parasysh nga institucionet hartuese të ligjit dhe parlamenti.

Reforma në shërbimet informative

Përveç institucioneve informative ekzistuese si SHISH⁸ dhe SHIU, gjatë kësaj periudhe u krijuan me ligj edhe disa institucione të reja. Kështu në MB u krijua Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB) (Ligji Nr.10002: 2008), në Ministrinë e Financave u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave si Njësia e Inteligjencës Financiare (Ligji Nr.9917: 2008), dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, në varësi të MD-së u krijua Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve (Ligji Nr.9397: 2005). Nuk është e qartë nëse nisma për një shumim të tillë të agjencive informative buronte nga nevoja për më shumë informacion apo ishte më tepër një përpjekje e ekzekutivit për të dubluar SHISH-in, i cili gjatë kësaj periudhe konsiderohej si jashtë sferës së kontrollit nga vetë ekzekutivi.

Politizimi i shërbimeve informative gjatë periudhave të mëparshme dhe kontrolli demokratik i pamjaftueshëm kanë qenë dy elementë që kanë ndikuar negativisht në reformën e mëtejshme në këtë fushë. Shërbimet informative kanë qenë jashtë mbikëqyrjes dhe vlerësimit të publikut për shkak të mbrojtjes me ligj të mënyrave të punës, strukturave, burimeve njerëzore dhe numrit të tyre, titujve dhe pagave. Të drejtën për të kontrolluar këto dhe aktivitetin e shërbimeve e ka Komisioni Parlamentar i Sigurisë, por në përgjithësi kontrolli efektiv i aktivitetit të shërbimeve ka qenë i vështirë për shkak ta traditës së gjatë të mbylljes dhe ruajtjes së sekretit mbi aktivitetin e tyre (Dempsey: 2009). Në vitin 2002, pretendimet për ndërhyrje të SHISH-it në proceset zgjedhore, çuan në shkarkimin e kreut të këtij shërbimi mbas zgjedhjes së Presidentit. Parlamenti ndërmori një hetim mbi aktivitetin e SHISH-it dhe për të marrë masa ligjore për profesionalizimin e mëtejshëm të tij. Kjo iniciativë u mbështet më shumë nga PD-ja, e cila që gjatë kohës që ishte në opozitë ishte shprehur për ndryshime strukturore thelbësore të SHISH-it dhe varësisë së tij. Mbas ardhjes në pushtet në vitin 2005, PD-ja

⁸ Emri i SHIK u ndryshua në SHISH me ligjin Nr.8479, date 29.4.1999



tentoi ta realizonte këtë reformë, por pa sukses. Më së shumti për shkak se gjeti kundërshtim të fortë të institucioneve ndërkombëtare.

Vizioni i PD-së ishte shpërbërja e SHISH-it dhe vendosja e një pjese të tij nën varësinë e MB-së dhe një pjese tjetër në varësinë e Ministrisë së Jashtme. Dështimi i realizimit të këtij projekti mund të shihet dhe si pikënisje e iniciativave të ekzekutivit për përforcimin e agjencive informative të sipërpërmendura në varësi të ministrive. Kompetencat e tyre u rritën vazhdimisht, dhe për këtë qëllim edhe ligji për përgjimin e telekomunikimeve u ndryshua dy herë me synim dhënien e kompetencave për përgjim këtyre agjencive. Më parë këtë të drejtë e kishte vetëm Prokuroria, Policia e Shtetit dhe SHISH (Ligji Nr.10172: 2009).

Këto priroje krijuan shqetësim tek opozita dhe grupe të shoqërisë civile, që e kundërshtuan këtë reformë. Miratimi i ligjit për SHKB-në u pa me shqetësim dhe konsiderohej si i orientuar drejt kontrollit politik të policisë, kjo parë kompetencat e gjera të kësaj agjencie mbi policinë (Gazeta Shqip: 2008). Nga ana tjetër shoqëria civile ishte e shqetësuar se këto kompetenca mund të përdroreshin për qëllime abuzive nga elita politike në pushtet (Rapushi: 2008). Nga ana tjetër, amendimi i ligjit për përgjimin e telekomunikimeve (Ligj Nr.10172: 2009) i dha akses më të madh institucioneve të tjera të sigurisë, akses i cili më parë ishte i rezervuar vetëm për SHISH-in dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Këto ndryshime ngjallën reagimin e Opozitës dhe shoqërisë civile të cilët ishin të preokupuar nga mundësia e abuzimit për qëllime politike (Rapushi: 2008).

Nisur nga traditë e kulturës së sekretit si dhe kontrolli dhe mbikqyrja e dobët demokratike e shërbimeve (Dempsey: 2009), këto preokupime tingëllonin të arsyeshme. Edhe Avokati i Popullit, po të shihen raportet e aktivitetit të tij, vetëm në raste të rralla është marrë me mbikëqyrjen e aktivitetit të shërbimeve. Për më tepër aktivitetit i shërbimeve informative ka qenë jashtë mbikqyrjes së publikut përsa i përket transparencës për ligjshmërinë në përdorimin e metodave të punës, zbatimin e legjislacionit për informacionin e klasifikuar, strukturat, përkrahjet e punës, numri i personelit etj. Vetëm komisionet parlamentare kanë akses në këto të dhëna. Me rritjen e kërcënimeve nga terrorizmi dhe krimi i organizuar, si aktivitete me dimension ndërkombëtar, për t'i dhënë SHISH-it hapësirat për bashkëpunim me agjenci partnere, Këshilli i Ministrave me vendim përcaktoi prioritetet, fushat dhe nivelet e bashkëpunimit me shërbime të huaja (Këshilli i Ministrave: 2004).



Edhe SHIU gjatë kësaj periudhe u bë objekt reforme, por ndryshe nga SHISH-i ka qenë më pak në qendër të debateve mbi aktivitetin e shërbimeve informative. Në vitin 2003 u miratua një ligj i plotë i cili përcaktoi rolin dhe misionin e SHIU-t (Ligj Nr. 9074: 2003). Ky ligj rregullonte edhe marrëdhëniet e këtij shërbimi me SHISH-in, duke rregulluar disi koordinimin ndërinstitucional që më parë kishte qenë më problematik. Reformimi erdhi si nevojë e orientimit të FA-ve drejt anëtarësimit në NATO, pjesëmarrja në aktivitetet e PpP-së dhe në operacionet për luftë globale kundër terrorizmit (Bala: 2008). Procesi i anëtarësimit në NATO solli dhe ndikimin e vet në reformën e shërbimeve informative, si civile ashtu edhe ushtarake, të cilat duhet të funksionojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive jo vetëm më njëra-tjetrën, por edhe me vendet anëtare të NATO-s (Dempsey: 2009).

Reforma në gjyqësor

Gjyqësori gjatë kësaj periudhe u vu në qendër të vëmendjes së publikut, kryesisht për shkak të mungesës së pavarësisë dhe ndërhyrjeve politike, vendimeve të gabuara dhe subjektive si dhe përhapjes së korrupsionit. I konsideruar si një pushtet i cili duhet të ishte i drejtë dhe i pa-anshëm, gjyqësori shihej si më i korruptuari. Ndërkohë rastet e ndëshkimit të gjyqtarëve për korrupsion ngelën të rralla. Kjo çoi në një rënie të madhe të besimit të publikut ndaj gjyqësorit dhe 60 përqind e tyre shpreheshin se kishin pak ose aspak besim tek drejtësia (SIDA: 2007).

Ballafaqimi midis politikës dhe sistemit të drejtësisë, herë bashkëpunues e herë konfliktual, ka qenë tipari më i dukshëm. Përpjekjet e gjyqësorit për të luftuar korrupsionin ndeshnin në pushtetin e fortë të politikës dhe nga ana tjetër përpjekjet e qeverisë për të ndërmarrë masa më të forta kundër fenomenit të korrupsionit kanë çuar në një konflikt ekzekutiv-gjyqësor. Edhe gjatë kësaj periudhe tradita e shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm (PP) mbi motive politike u shfaq dy herë, duke bërë që autonomia dhe forca e këtij institucioni të bëhen të diskutueshme. Në vitin 2002, Prokurori i Përgjithshëm u vu në shënjestër të politikës dhe u shkarkua si rezultat i një periudhe qetësie të luftës politike dhe e marrëveshjes PS-PD. Shkarkimi i Prokurorit të Përgjithshëm, u konsiderua jo kushtetues nga Gjykata Kushtetuese, por vendimi i saj nuk u zbatua (Home Office–UK: 2003). Edhe në vitin 2007 u ngrit një komision hetimor parlamentar për shkarkimin e PP-së, i cili u akuzua nga vetë Kryeministri se ishte personalisht i lidhur me anëtarë të krimit të organizuar dhe



se ishte i pa-aftë për të ndjekur dhe çuar para drejtësisë në mënyrë objektive çështjet që lidheshin me korrupsionin (Çela: 2007). Të gjitha këto kanë çuar drejt një dobësimi gradual të pozicionit të PP-së duke treguar se në një konfrontim të tillë politika ka dalë gjithmonë fituese.

Me gjithë kuadrin kushtetues dhe përmirësimet ligjore për garantimin e autonomisë vendimmarrëse të gjykatave, gjyqtarët kanë qenë të ekspozuar ndaj presionit të dyfishta, si nga politika ashtu edhe nga grupet e krimit të organizuar (SIDA: 2007). Përveç këtyre, problematike ka qenë edhe mungesa e transparencës në lidhje me zbatimin e disiplinës gjyqësore. Si Këshilli i Lartë i Drejtësisë ashtu edhe Ministria e Drejtësisë, kanë krijuar inspektoriate me kompetenca dhe përgjegjësi që i mbivendosen njëra-tjetrës (American Bar Association: 2006). Ligji i ri i miratuar për gjyqësorin, i cili krijon premiset për një proces emërimesh dhe karriere mbi bazën e meritave, pritet që të sjellë një ekuilibër më të madh (Ligji Nr.9877: 2008).

Në përpjekje për të rritur efektivitetin e gjyqësorit në luftën kundër krimit të organizuar në rritje, në janar të vitit 2004 u krijua Gjykata e Krimeve të Rënda. Edhe në fushën e pastrimit të parave u miratua legjislacion dhe struktura të reja, por rezultatet në zbatimin e ligjit në këtë fushë ngelën të ulta, pasi ka munguar eksperiencia, bashkëpunimi dhe burimet brenda autoriteteve mbikëqyrëse shqiptare dhe të agjencive zbatuese të ligjit (Santiago: 2006). Në përpjekje për të kapërcyer këtë situatë, në maj 2007 si një bashkim burimesh dhe ekspertize nga institucione si Policia e Shtetit, Ministria e Brendshme, e Financave, SHISH-i dhe Prokuroria e Përgjithshme, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje e solli krijimin e njësisë e Task Force, me qëllim koordinim në luftën kundër korrupsionit dhe krimeve financiare (Panorama: 2007).

Kompanitë private të sigurisë

Si rezultat i rritjes së nevojave në fushën e tregut privat, kompanitë private të sigurisë u shtuan në numër dhe e rritën aktivitetin e tyre gjatë kësaj periudhe, si një alternativë ndaj ofruesve tradicionalë të sigurisë. Si rezultat i rritjes ekonomike dhe liberalizimit të tregut, u krijua një kërkesë më e madhe për shërbime sigurie, ç'ka solli dhe rritjen e tyre. Në vitin 2005, sipas MB-së, në vend operonin 259 shoqëri private sigurie duke krijuar një sektor që punësonte mbi 4000 vetë (Centre for Peace and Disarmament Educa-



tion: 2005). Me gjithë përpjekjet për të kompletuar kuadrin ligjor, aktiviteti i SHPS-së ngeli jo shumë transparent për shkak të vështirësive në verifikimin e aftësive dhe sigurisë së personelit.

Shoqëria civile

Shoqëria civile dhe mediat gjatë kësaj periudhe nuk u shfaqën si aktorë influentë të reformave në sektorin e sigurisë. Kontributi i tyre në bërjen e politikave, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë, ka qenë i kufizuar. Në kontekstin e formulimit të politikave, koordinimi i qeverisë dhe i parlamentit me shoqërinë civile, ngeli i dobët duke bërë që edhe dialogu ndërmjet këtyre aktorëve të artikulohet në mënyrë të dobët. Kjo shkallë e ulët kontributi i dedikohet edhe mungesës së kapaciteteve dhe ekspertizës. Kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile vazhduan të mbështeteshin në grupe të vogla njerëzish dhe financiarisht të varura nga donacione të huaja duke bërë që dhe axhenda e tyre të përcaktohet nga faktorë të jashtëm (European Commission: 2003).

Në çështjet e sigurisë, angazhimi civil ngeli i ulët dhe për pasojë edhe influenca e opinionit publik si mbi çështje legjislative ashtu edhe të qeverisjes së sektorit të sigurisë ngeli e ulët (Lora: 2003). Numri i organizatave dhe instituteve me qasje ndaj çështjeve të sigurisë mbeti i kufizuar duke sjellë një praktikë të pazhvilluar të konsultimeve të ministrive me shoqërinë civile në fazën e hartimit të politikave dhe ligjeve (European Commission: 2008). Shpesh shoqëria civile është gjendur në pozicionin e partnerit të bindur të institucioneve shtetërore, duke e dëmtuar rolin e saj në proceset demokratike (Çili: 2005). Gjatë fazës së dytë të kësaj periudhe organizatat e pavarura jo-qeveritare kanë qenë më aktive dhe ndikimi i tyre mbi qeverinë ka qenë më i ndjeshëm (Freedom House: 2007). Konkretisht, gjatë hartimit të Planit të Veprimit për Policimin në Komunitet, bashkëpunimi i Policisë së Shtetit dhe i organizatave të huaja që e asistojnë, ICITAP dhe PAMECA, ka qenë më i dukshëm duke përfshirë si shoqërinë civile ashtu edhe grupe ekspertësh nga universitetet.

Edhe komponenti tjetër – media – gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë aktor me influencë në ecurinë e reformës së sektorit të sigurisë. E monopolizuar nga një numër i vogël grupesh biznesi privat, media ka synuar më shumë të mbrojë interesat e ngushta të biznesit, përfshirë dhe interesa politike të përziera me to (Londo: 2004). Kjo përzierje e bizneseve të mëdha, politikës



dhe interesave të medias pengoi edhe lindjen e mediave të tjera të pavarura (Freedom House: 2008).

Gjatë kësaj periudhe u pa edhe fenomeni i trajtimit në mënyrë të diferencuar të mediave pro-qeveritare dhe atyre kritike ndaj saj (Lora: 2003). Këto tipare kanë ndikuar së tepërmi në profesionalizmin e medias dhe shmangien e saj nga roli i 'rojtarit' të aktivitetit të qeverisjes dhe të sektorit të sigurisë në veçanti. E përmbledhur, kjo periudhë shfaq dy tipare: (1) kontrollin direkt apo indirekt të mediave nga qeveritë në pushtet dhe (2) mungesën e aftësisë nga ana e medias për të trajtuar me kompetencë çështje të reformës në sektorin e sigurisë.

Përfundime

Siç u shtjellua më sipër, e kaluara totalitare ka pasur një ndikim të rëndësishëm në RSS gjatë periudhës së parë të zhvillimit të këtyre reformave. Trashëgimia e sistemit totalitar, ku siguria nëpërmjet kontrollit nga aparati shtetëror i sigurisë, ishte koncept dominues. Ky ndikim u shpreh në përqendrimin e kontrollit të institucioneve dhe të reformave të sistemit të sigurisë në duart e Presidentit. Transferimi i kompetencave të shumta tek Presidenti, megjithëse paketa kushtetuese parashikonte një sistem parlamentar, ishte tregues i qartë i kulturës totalitare. Kompetencat e tij përmbledhnin kontrollin mbi institucionet e sigurisë në varësi të ekzekutivit, të politikës së jashtme por edhe mbi gjyqësorin. Duke qenë se Presidenti nuk ishte objekt kontrolli demokratik nga parlamenti, sistemi i kontrollit dhe balancës dështoi, roli i parlamentit ngeli formal dhe gjyqësori u bë objekt ndërhyrjesh të hapura politike.

Ecuria e reformave gjatë periudhës së parë dhe kriza e vitit 1997, bënë që RSS-ja gjatë periudhës së dytë të ndikohet nga zhvillimi në periudhën paraardhëse. Gjatë periudhës së dytë, u bënë përpjekje për t'u larguar nga tradita totalitare, por edhe për të shmangur ripërsëritjen e problemeve që u hasën gjatë zhvillimit të reformave në periudhën e parë. Megjithatë konflikte si ai i tentativës për grusht shteti në shtator 1998, dhe konflikti në Kosovë gjatë vitit 1999, e vështirësuan këtë proces. Ripërtëritja e angazhimit ndërkombëtar në rajon, nëpërmjet perspektivës së integritimit Euro-Atlantik solli ndryshim në tërë rajonin duke shënuar dhe përfundimin e kësaj pe-



riudhe. Me gjithë hyrjen në rrugën e pakthyeshme drejt integritimit Euro-Atlantik, RSS-ja do të ballafaqohet me probleme si institucionet e dobëta të shtetit dhe nivelet e larta të krimit dhe korrupsionit.

Gjatë periudhës së fundit RSS-ja eci në një rrugë tjetër, e cila përmbante dy perspektiva. Nga njëra anë proceset u përqendruan në konsolidimin e reformave të nisura më herët, dhe nga ana tjetër u nisën reforma të reja. Progres i dukshëm dhe përmirësime u arritën në fusha të ndryshme si mbrojtja, policia dhe drejtësia. Në drejtim të kontrollit demokratik u vendosën procedura mbikëqyrjeje dhe transparence me qëllim kontrollin e zbatimit ligjor dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve të sigurisë. Reformat sollën edhe rritjen e bashkëpunimit më të mirë ndër-institucional si dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përputhjen me standarde ndërkombëtare.

Sidoqoftë, duhet shënuar që edhe në këtë periudhë, konteksti i polarizuar politik luajti një rol negativ në RSS. Konflikti politik dhe mungesa e vullnetit për të përmirësuar qeverisjen e sektorit të sigurisë patën efekte jo të favorshme. Përpjekjet për të luftuar krimin e organizuar dhe forcuar shtetin ligjor çuan në një përqëndrim të pushtetit në duart e Kryeministrit, duke ngritur preokupime mbi autonominë dhe profesionalizmin e sektorit të sigurisë. Shfaqje e kësaj prirjeje ishte dhe konflikti i lindur midis ekzekutivit dhe gjyqësorit, si një fenomen i ri. Megjithatë gjatë kësaj periudhe u shënuar progres i prekshëm në fushën e reformave në këtë sektor dhe anëtarësimi në NATO si dhe ecuria e procesit të integritimit në BE, ishin tregues të këtij progresi.

Aneks 1: Analiza e aktoreve kryesore politike

Lloji i aktorit	Interesat	Strategjitë	Kapacitetet	Marrëdhëniet
Partia Demokratike				
Parti politike: demokratike, pro regjimit.	<p><u>Orientimi politik:</u> qendra e djathtë, konservatore.</p> <p><u>Motivimi:</u> marrja e pushtetit.</p> <p>Aktor kryesor në të tre periudhat ka ndikuar mbi RSS nëpërmjet interesave, vizionit kapaciteteve dhe mënyrës së ndërveprimit.</p>	<p>Përveç përdorimit të mjeteve politike demokratike ka përdorur dhe mënyra më pak demokratike veçanërisht gjatë viteve 1996-1999.</p> <p>Megjithëse erdhi në pushtet si parti anti-komuniste dhe anti-autoritariste, gjatë qeverisjes së viteve 1992-1997 u kritikua mjaft për mos respektimin e të drejtave të njeriut dhe prirjet autoritariste.</p>	<p>Gjatë viteve 1991-1997, nga një parti me bazë tepër të gjerë shoqërore në të gjithë vendin, u rrudh në një parti identiteti i të cilës shihet si i lidhur me veriun e vendit.</p> <p>Duke rifituar mbështetjen e humbur gjatë viteve në opozitë, fitoi zgjedhjet e vitit 2005.</p> <p>Në zgjedhjet e vitit 2009 arriti të merrte shumicën por më pak se 50 për qind të vendeve në parlament dhe formoi koalicion me një parti të qendrës së majtë për të siguruar shumicën qeverisëse.</p>	<p>Alieatët kryesorë: parti të tjera të djathta dhe të qendrës së djathtë.</p> <p>Megjithatë ka hyrë në koalicion dy herë me parti të qendrës së majtë: me Social Demokratët, gjatë viteve 1992-1994 dhe me Lëvizjen Socialiste për Integrim, në 2009.</p> <p><u>Kundërshtarët kryesorë:</u> Partia Socialiste dhe grupet mbështetëse të saj.</p>
Partia Socialiste				
Parti politike: demokratike, pro regjimit.	<p><u>Orientimi politik:</u> e majtë, social demokratike.</p> <p><u>Motivimi:</u> marrja e pushtetit</p>	<p>Përdorim i mjeteve demokratike dhe institucionale të politikës. që nga krijimi si vazhduese e Partisë së Punës në vitin 1991, i qëndroi besnike ideologjisë marksiste drej në vitin 1996, megjithse nuk e aplikoi atë.</p>	<p>Trashëgoi strukturat dhe kapacitetet e Partisë së Punës dhe gjithmonë ka pasur epërsi organizative ndaj kundërshtarëve të saj.</p> <p>Përveç zgjedhjeve të vitit 1992, ka pasur vazhdimisht mbështetje konstante nga elektorati e cila nuk ka rënë asnjëherë poshtë 40 për qind.</p>	<p>Për shkak të trashëgimisë komuniste, deri në vitin 1996 ka vuajtur nga një izolim pothuaj i plotë.</p> <p>Gjatë krizës së skemave piramidale u bë koordinuese kryesore e të gjitha partive dhe grupeve opozitare, përfshirë shoqërimë civile dhe median e pavarur.</p> <p><u>Kundërshtar kryesor:</u> Partia Demokratike</p>

Lëvizja Socialiste për Integrim			
Parti politike: demokratike, pro regjimit.	Orientimi politik: qëndra e majtë, social demokratike. <u>Motivimi:</u> marrja e pushtetit.	U krijua si fraksion i shkëputur nga Partia Socialiste në vitin 2004, me gjithë numrin e vogël të vendeve në parlament (5 në zgjedhjet e 2005 dhe 4 në zgjedhjet e 2009), ka qenë faktor për përcaktimin e kahut të pushtetit	E lindur si forcë brenda parlamentit, mbështetja e saj bazohet në elektoratin socialist. Ka kërkuar të zgjerohë bazën elektorale tek pensionistët dhe të rinjtë nëpërmjet ofrimit të perspektivës Evropiane.
Radio Televizioni Shqiptar			
Aktor në mbështetje të regjimit.	<u>Orientimi politik:</u> ka bërë pak pë të qenë i paanshëm duke qenë vazhdimisht mbështetës i shumicës qeverisëse, veçanë- risht gjatë periudhës së parë. Megjithë legjisllacionin për garantimin e paanësisë gjatë periudhës së dytë, pak është arritur. <u>Motivimi:</u> ka qenën nën presion për t'ju konformuar agjendave të shumicës.	Nuk ka ndonjë strategji të vetën. udhëhiqet nga interesat e qeverive dhe partive në pushtet.	Gjatë periudhës së parë ishte media e vetme audio-vizive në vend që transmetonte në shkallë kombëtare. Dominimi i RTSH u sfidua nga zhvillimi i shpejtë i mediave audio-vizive private duke çuar në uljen e vazhdueshme të niveilit të besueshmërisë së tij, veçanërisht gjatë periudhës së tretë.
Media Private			
Të ndryshme por kryesisht demokratike	<u>Orientimi politik:</u> i ndryshëm - disa por qeveritare disa kundër - në varësi të strukturës së pronësisë. <u>Motivimi:</u> përfitimi ekonomik, përfitimi nga tregu i mediave.	Përdorim modest të metodave investigative mediatike që përdoren kryesisht si forma për të dëmtuar kundërshtarët se sa në interes të informimit publik.	Që nga fillimi i viteve 2000 e ka tejkalluar median elektronike private, përsa i përket kapaciteteve dhe pjesës së tregut. Ka rol të rëndësishëm në influencimin e vendimmarrjes nëpërmjet ndikimit tek publiku, megjithëse jo gjithmonë në kahun pozitiv.
		<u>Alatët kryesorë:</u> qeveria, partitë politike në pushtet. <u>Kundërshtar kryesor:</u> nuk ka kundërshtarë natyralë përveç konkurrencës nga mediat private të cilat sidoqoftë nuk ndikojnë në buxhetin dhe burimet e tij.	<u>Alatët kryesorë:</u> në varësitë strukturës së pronësisë, partitë politike, politikanë të veçantë, biznese private. <u>Kundërshtar kryesor:</u> konkurrentët

Komuniteti i Biznesit			
<p>Aktor pro regjimit por jo gjithmonë demokratik</p>	<p><u>Orientimi politik:</u> në varësi të partisë politike në pushtet. Gjatë periudhës së parë, për shkak të praktikave selektive të PD me licencat, shumia e bizneseve ishte në mbështetje të saj. Gjatë dy periudhave të tjera ka qenë shumë më e shumëllojshme dhe fluide.</p> <p><u>Motivimi:</u> përfitimi ekonomik, akses i ndaj pushtetit nëpërmjet influencimit të politikave</p>	<p>Influencimi kryesisht nëpërmjet mbështetjes dhe financimit të partive politike gjatë fushatave elektorale.</p>	<p>Mundësi të mëdha financiare dhe klientelizmi në ofertë për partitë politike. Jo koheziv në termat politikë dhe shpesh në dëm të konkurrencës. Pa influencë të vecantë në RSS, përveç cilësisë së shërbimit kur kontraktohet nga institucionet e sigurisë.</p>
<p>Aleatët kryesorë:</p> <p>politikanët dhe partitë politike.</p> <p><u>Kundërshtar kryesor:</u> në mungesë pothuaj tërësore të organizimit të sindikatave nuk ka kundërshtarë natyralë përveç konkurrentëve.</p>			
Organizatat Ndërkombëtare			
<p>Aktor Pro-demokratik</p>	<p><u>Orientimi politik:</u> për shkak të politikës izoluase dhe faktit që ishte vendi i fundit në rajon komunist që përqafoi ndryshimet demokratike, ishte mjaft i hapur në mbështetje të PD. Në dy fazat e tjera ka qenë më i ekuilibruar por gjithëprania e tij shpesh është keqpërdorur nga aktorët politikë të vendit.</p> <p><u>Motivimi:</u> kontributi për stabilitetin dhe demokracinë.</p>	<p><u>Metoda e aksionit politik:</u> presioni dhe motivimi Respektimi për të drejtat e njeriut dhe demokracinë: angazhim tërësor për respektimin e të drejtave të njeriut duke plotësuar vakumin e krijuar nga aktiviteti i dobët i shoqërisë civile.</p>	<p>Autoritet të konsiderueshëm në ndikimin e sjelljes së aktorëve të vendit por jo gjithmonë koheziv (vende të veçanta dhe organizatat ndërkombëtare). Mbështetje e fuqishme për RSS nëpërmjet kushtëzimit politik dhe mbështetjes financiare dhe teknike.</p>
<p>Motivimi: mbështetje nga partitë politike, shoqëria civile por dhe nga publiku i gjerë.</p> <p><u>Kundërshtar kryesor:</u> nuk ka kundërshtarë.</p>			



Bibliografia

Artikuj nga libra

- § Bumçi, Aldo, 2005, 'Security Sector Reform in Albania' in Philipp H. Fluri and Jan A. Trapans (eds.), in *Defence and Security Sector Governance and Reform in South East Europe: Insights and Perspectives*. Vol. 1. DCAF.
- § Çili, Henri. 2005, 'Security and Defence – Civil Society and the Media' in Philipp H. Fluri and Jan A. Trapans (eds.) *Defence and Security Sector Governance and Reform in South East Europe: Insights and Perspectives*. Vol. 1. DCAF.
- § Donais, T. 2005. 'Albania: Analysis of the Stability Pact Self-Assessment Studies', in Philipp H. Fluri and Jan A. Trapans (eds.) 2005, *Defence and Security Sector Governance and Reform in South East Europe: Insights and Perspectives*. Vol. 1. DCAF.
- § Hroni, S. 2007. 'Reform of the Albanian State Police'. in Anja Ebnöther, Philipp Fluri, and Predrag Jurekovic (eds.). *Security Sector Governance in the Western Balkans: Self-Assessment Studies on Defence, Intelligence, Police and Border Management Reform*. Vienna and Geneva.
- § Institute for Democracy and Mediation. 2006. *Albanian agenda for regional security*. Gjetur gusht 2009, në: <http://idmalbania.org/alb/publikime.php>.
- § Islami, K. 2007. 'Strategjia e Sigurisë Kombëtare në kontekstin e rreziqeve e kercenimeve rajonale' tek Hroni. S (ed), *Mbi zhvillimin e strategjisë së sigurisë kombëtare*. Toena.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.idmalbania.org/publications/alb/Mbi%20zhvillimin%20e%20strategjise.pdf>
- § Londo, I. 2004. 'Albania: Media ownership and its impact on media independence and pluralism' in Brankica Petrović (eds). 2004, *Media ownership and its impact on media independence and pluralism*. Peace Institute, Ljubljana, Slovenia.
- § Mobekk, E. 2007, *Police Reform in South East Europe: An Analysis of the Stability Pact Self-Assessment Studies, Defence and Security Sector Governance and Reform in South East Europe: Insights and Perspectives*. Vol. 1. DCAF.



- § Pettifer, J & Vickers. M (A). 2007. *The Albanian question: Reshaping the Balkans*. I.B.Tauris.
- § Vickers, M. and Pettifer. James (B). 1997. *Albania: From Anarchy to a Balkan Identity*. Hurst & Company, London.
- § Phinimore. D & Siani-Davies, P. 2003. 'Beyond intervention? The Balkans, the Stability Pact and the European Union'. in Siani-Davies, Peter. Ed. *International Intervention in the Balkans since 1995*. Routledge.

Artikuj dhe Studime

- § Abazi, E. 2004. 'Defense Reform of the Albanian Armed Forces: Democratization and Transformation'. September 2004
Gjetur gusht 2009, në: www.ciaonet.org/olj/co/co_sep04/co_sep04c.pdf.
- § Abrahams, F. 1997. 'Albania. Foreign Policy In Focus'. Vol. 2 (33),
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.fpif.org/briefs/vol2/v2n33alb.html>.
- § American Bar Association. 2006. 'Judicial Reform Index for Albania. Vol. 3,
Gjetur gusht 2009, në: www.abanet.org/rol/publications/judicial_reform_index.shtml.
- § Amnesty International Reports on Albania. 1994, 1995, 1996, 1997.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.unhcr.org/refworld/publisher,AMNESTY,ANNUALREPORT,ALB,,0.html>.
- § Baka, B. 2009. 'Policimi ne Komunitet: Filozofia dhe Sfidat e Zbatimit Teknik' Instituti për Democraci dhe Ndërmjetësim.
Gjetur gusht 2009, në: <http://idmalbania.org/alb/publikime.php>.
- § Bala, E. 2008. 'Intelligence Reform in Albania: Its Relation to Democratization and Integration into the EU and NATO'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.stormingmedia.us/31/3189/A318974.html>
- § Bazo, Jeronim. Shaping the future – A New Profile of the Albanian Military Officer, US Army War College, Pennsylvania 2006
<http://www.strategicstudiesinstitute.army.mil/pdffiles/ksil275.pdf>.
- § Binaj, Dh. 2004. 'An analysis of United States-Albanian Security Relations. Naval Postgraduate School', California.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.dtic.mil/cgi-bin/GetTRDoc?AD=ADA429684&Location=U2&doc=GetTRDoc.pdf>



- § Born, H. 2002. 'Learning from best practices of parliamentary oversight of the security sector'. DCAF.
Gjetur gusht 2009, në: http://www.dcaf.ch/_docs/sourcebk_ssr/Born.pdf
- § Brokaj, S. 2001. 'Civil-Military Relations in Albania: Phases of Evolution. Austrian Armed Forces'.
Gjetur gusht 2009, në: http://www.bmlv.gv.at/pdf_pool/publikationen/civil-military_relations_i.pdf.
- § Bureau of European and Eurasian Affairs. 2009. 'Adriatic Charter. US Department of State'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.state.gov/p/eur/rls/fs/112766.htm>.
- § Çela, E. 2007. 'Albania's PM and Prosecutor Fight Corruption and Each Other'. Balkan Investigative Reporting Network.
Gjetur gusht 2009, në: <http://birn.eu.com/en/110/10/5413/>.
- § Central Electoral Commission. 2009. 'Final Results of Parliamentary Elections 2009'. Gjetur gusht 2009, në: <http://www.cec.org.al>.
- § Jarvis, Chris, (1999) The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania. IMF Working Paper, Vol. , pp. 1-36, 1999. Available at SSRN:
- § Commission on the European Communities. 'Albania 2008 Progress Report'.
Gjetur gusht 2009, në: http://www.delalb.ec.europa.eu/files/albania_progress_report_2008.pdf.
- § Commission on Security and Cooperation in Europe. 1991. 'The Elections in Albania, March-April 1991'.
Gjetur gusht 2009, në: http://csce.gov/index.cfm?FuseAction=UserGroups.Home&ContentRecord_id=205&ContentType=G&ContentRecordType=G&UserGroup_id=76&Subaction=ByDate&CFID=16566219&CFTOKEN=25169183.
- § Çopani, A. 1996. 'The new dimensions of Albania's security posture'. NATO Review (online), 44 (2), pp. 24-28.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.nato.int/docu/review/1996/9602-6.htm>
- § Çopani, A. 1998. 'Civil-military relations in discord'. Camberley, England : Conflict Studies Research Centre, RMA Sandhurst.
Gjetur gusht 2009, në: www.da.mod.uk/colleges/arag/document-listings/cee/G62.pdf



- § Country Information and Policy Unit, Immigration and Nationality Directorate, Home Office – UK, Republic of Albania – Country Report 2003. Gjetur gusht 2009, në: http://www.ecoi.net/file_upload/1329_1200403953_albania-october-2003.pdf
- § Dirk J, B. 2001. 'Post-socialist financial fragility: the case of Albania'. Oxford University Press. Cambridge Journal of Economics. Vol. 25, No. 1. p1-23(23).
- § Dempsey, Th. 2009. 'Assessing Intelligence Capacity Building in Albania'. PKSOI. Gjetur gusht 2009, në: http://pksoi.army.mil/PKM/publications/PKSOI_Perspectives/Perspectives%20Assessing%20Intelligence%20Capacity%20Building%20in%20Albania_1%20JUL%202009.pdf.
- § Dyrmishi, A. 2009. 'Interceptimi i Komunikimeve në Shqipëri'. IDN-Qendra për Studime Europiane dhe të Sigurisë. Gjetur gusht 2009, në: http://www.idmalbania.org/publications/alb/Bacgrounder_Intercept.pdf
- § East European Constitutional Review. 1998. 'Albania Update'. Volume 7. Number 4. Fall 1998;
- § East European Constitutional Review . 1999. 'Albania Update'. Volume 8. Number 4. Fall 1999.
- § Gazeta Shqiptare 2008. 'Kuvend: Kushtetuta, miratohen me 115 vota ndryshimet' 21.04.2008. Gjetur gusht 2009, në: <http://balkanweb.com/sitev4/arkivi.php?id=19804>
- § Hanggi, H. & Tanner, F. 2005. 'Promoting security sector governance in the EU's neighbourhood'. Institute for Security Studies. Gjetur gusht 2009, në: <http://www.iss.Europa.eu/uploads/media/cp080.pdf>
- § International Crisis Group. 2000. 'Albania: State of the Nation'. 1 March 2000. ICG Balkans Report N° 87.
- § Jarvis, Ch. 2000. 'The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania'. IMF Staff Papers, Vol. 47(1), International Monetary Fund.
- § Katsirdakis, G. 1998. 'Albania: A Case Study in the Practical Implementation of Partnership for Peace'. NATO Review 46 (2) pp. 22–26. Gjetur gusht 2009, në: <http://www.nato.int/docu/review/1998/9802-07.htm>.



- § Lora, A. 2003. 'Understanding Defence and Security in Correlation to Civil Society and Media'. Albanian Institute for International Studies.
Gjetur gusht 2009, në: http://docs.google.com/gview?a=v&q=cache:lrHWUcCdeiwJ:https://intra.css.ethz.ch/civsoc/ev_belgrade_031114Arbana.pdf+%22civil+society%22+%22security+sector%22+albania&hl=en.
- § Luarasi, A. 1997. 'Legal and institutional reform in Albania after the democratic revolution (1991-1997)'. Tirana University.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.nato.int/acad/fellow/95-97/luarasi.pdf>
- § OECD DAC. ed. 2007. 'Handbook on Security System Reform: Supporting Security and Justice'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.oecd.org/dataoecd/43/25/38406485.pdf>.
- § OSCE. 2000-2009. 'Election Documents. Albania'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.osce.org/odihr-elections/documents.html?lsi=true&src=6&grp=207&limit=10&pos=10>.
- § Panorama 2007. 'Njësia u krijua me kërkesën e të huajve', (The Unit was created from the foreign request) May 22nd 2007.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.panorama.com.al/index.php?id=4344>
- § Rapushi, R. 2008. 'Dekreti i Topit, tani do te pergjojne dhe policia e Ministria'. (Topi's decree: now even Police & Ministry will be wiretapped). Koha Jone.
Gjetur gusht 2009, në: http://kohajone.com/html/artikull_21661.html
- § Ryan, Barry J. 2009. 'The EU's Emergent Security-First Agenda: Securing Albania and Montenegro'. Security Dialogue.40; 311.
Gjetur gusht 2009, në: <http://sdi.sagepub.com/cgi/content/abstract/40/3/311>
- § Rynn, S. et al. 2005. 'SALW and Private Security Companies in South Eastern Europe: A Cause or Effect of Insecurity?', SEESAC.
Gjetur gusht 2009, në: http://www.saferworld.org.uk/images/pubdocs/SALW_and_PSCs.pdf
- § Santiago et al. 2004. 'Money Laundering in Albania'. Centre for OSCE Research, Hamburg.
Gjetur gusht 2009, në: http://www.core-hamburg.de/documents/yearbook/english/04/Fink_Baumeister_Muco.pdf



- § Shqip 2008. 'PD nuk terhiqet, dublon SHISH-in'. 24 Shtator 2008.
- § SIDA. 2007. 'Albania Anticorruption Study'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.aidharmonisation.org.al/skedarret/1203101753-SIDA%20Albania%20Anti-Corruption%20Study%20-%20Revised.pdf>
- § The Economist, 'Oh, dear', London: Jun 5, 1993. Vol.327, Iss.7814;
- § The Economist, 'You're out', London: Oct 7, 1995. Vol.337, Iss.7935;
- § The Economist, 'Bad for Berisha, bad for the West', London: Jun 1, 1996. Vol.339, Iss.7968;
- § The Economist, 'Berisha broken', London: Nov 12, 1994. Vol.333, Iss.7889
- § The Economist, 'Seeking friends: Albania', London: Jul 24, 1993. Vol.328, Iss.7821.
- § UNDP-AIIS. 2004. Human Security in Albania. Early warning Report.
- § UNHCR. 1998. 'Albania: Questions on the Movement for Legality Party and the SHIK'. Gjetur gusht 2009, në: <http://www.unhcr.org/refworld/docid/3df08e791.html>
- § Van den Doel, Th. 2004. 'Parliamentary Oversight of the Security Sector in South East Europe: An Analysis of the Stability Pact Self-Assessment Studies', DCAF.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.google.com/search?hl=en&q=Theo+van+den+Doel%2C+Parliamentary+Oversight+of+the+Security+Sector+in+South+East+Europe%3A+An+Analysis+of+the+Stability+Pact+Self-Assessment+Studies%2C+DCAF>
- § Zakaria, F. 1997. 'The Rise of Illiberal Democracy'. Foreign Affairs.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.fareedzakaria.com/ARTICLES/other/democracy.html>

Raporte

- § European Commission. 2003. 'Albania stabilization report 2003'. Brussels.
Gjetur gusht 2009, në: http://ec.Europa.eu/enlargement/pdf/albania/com03_339_en.pdf.
- § European Commission. 2006. 'Albania – Progress Report 2006'. Brussels.
Gjetur gusht 2009, në: http://ec.Europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2006/nov/al_sec_1383_en.pdf.



- § European Commission.2007. 'Albania 2007 Progress Report'. Brussels.
Gjetur gusht 2009, në: http://ec.Europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/albania_progress_reports_en.pdf.
- § European Commission.2008. 'Albania, progress report 2008'. Brussels.
Gjetur gusht 2009, në: http://www.delalb.ec.Europa.eu/files/albania_progress_report_2008.pdf.
- § European Commission. 2009. 'Albania – Financial Assistance'. Brussels.
Gjetur gusht 2009, në: http://ec.Europa.eu/enlargement/potential-candidates/albania/financial-assistance/index_en.htm.
- § Europol. 2008. 'Strategic Agreement between the Republic of Albania and the European Police Office'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.Europol.Europa.eu/legal/agreements/Agreements/Albania.pdf>
- § Freedom House. 2007. Freedom in the World – Albania.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.freedomhouse.org/template.cfm?page=22&year=2007&country=7120>
- § Freedom House. 2008. Freedom in the World - Albania.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.freedomhouse.org/template.cfm?page=22&year=2008&country=7337>
- § Human Rights Watch, 1993, 'World Report on Albania'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.hrw.org/>.
- § Human Rights Watch, 1995, 'World Report on Albania'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.hrw.org/>.
- § Human Rights Watch, 1996, 'World Report on Albania'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.hrw.org/>.
- § Human Rights Watch, 1998, 'World Report on Albania'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.hrw.org/>.
- § Human Rights Watch, 1999, 'World Report on Albania'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.hrw.org/>.
- § NATO Press Release. 1998.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.nato.int/docu/pr/1998/p98-069e.htm>.
- § NATO Update. 1999. 'Albania develops its cooperation with NATO'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.nato.int/docu/update/1999/1201e.htm>



- § NATO. 1998. Press Release (98)69.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.nato.int/docu/pr/1998/p98-069e.htm>.
- § NATO. 1997. 'Welcoming Remarks by the NATO Secretary General on the occasion of the visit of the Albanian Prime Minister at the NATO HQ'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.nato.int/docu/speech/1997/s970910a.htm>.
- § Network of Open Society for Albania (NOSA). 2007. 'Monitoring Report of Stabilization Association Agreement: June 2006 – September'.
Gjetur gusht 2009, në: http://www.soros.al/monitorimi_MSA.pdf.
- § Solana. J, 1997. 'Welcoming Remarks by the NATO Secretary General', 10 September 1997.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.nato.int/docu/speech/1997/s970910a.htm>
- § Transparency International. 2006. 'Global Corruption Report'.
Gjetur gusht 2009, në: http://www.transparency.org/publications/gcr/gcr_2006#download
- § USAID. Budget – Albania.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.usaid.gov/policy/budget/cbj2007/ee/al.html>
- § US Department of State. 2009. 'Background Note: Albania'.
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.state.gov/r/pa/ei/bgn/3235.htm>
- § Venice Commission. 2009. 'For the Constitutional Court of Albania on the Admissibility of a Referendum to Abrogate Constitutional Amendments'. Opinion No. 517/2009, 13 March 2009,
Gjetur gusht 2009, në: <http://www.venice.coe.int/docs/2009/CDL-AD%282009%29007-e.asp>

Ligje dhe dokumente strategjike

- § Dekreti Nr. 7463, datë 31.01.1991. Për Policinë Financiare
- § Këshilli i Ministrave. 2004. Vendimi Nr. 194. datë 10.04.2004
- § Këshilli i Ministrave. 2008: Vendim Nr.14, datë 9.1.2008, Për Miratimin e Strategjisë Sektoriale të Rendit Publik
- § Ligji Nr.9877, datë 18.2.2008. 'Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në



Republikën e Shqipërisë’

- § Ligji Nr. 9074 datë 29.05.2003. Për Shërbimin Informativ të Ushtrisë
- § Ligji Nr.10 002 datë 06.10.2008. ‘Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme’
- § Ligji Nr.10172, datë 22.10.2009. Për Disa Shtesa në Ligjin Nr.9157, datë 4.12.2003 ‘Për Përgjimin e Telekomunikacioneve’
- § Ligji Nr. 8553 datë 25.11.1999. Për Policinë e Shtetit
- § Ligji Nr. 9749, datë 4.6.2007, Për Policinë e Shtetit
- § Ligji Nr. 9322, datë 25.11.2004. Për Miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë
- § Ligji Nr. 7508, datë.08.1991. Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura
- § Ligji Nr. 7938, datë 24.05.1995, ‘Për miratimin e dekretit nr. 1701, datë 09.01.1997 ‘Për një shtesë në dekretin nr. 1074, datë 21.04.1995 ‘Për shpërbërjen e Policisë Financiare dhe krijimin e Policisë Doganore dhe Policisë Tatimore’ miratuar me ligjin nr. 7938, datë 24.05.1995’
- § Ligji Nr.8391 datë 28.10.1998. Për Shërbimin Informativ Kombëtar
- § Ligji Nr.8479 datë 29.4.1999. Për disa Ndryshime në Ligjin Nr.8391, datë 28.10.1998 ‘Për Shërbimin Informativ Kombëtar’
- § Ligji Nr. 7752, datë 28.03.1993. Për Policinë e Ndërtimit
- § Ligji Nr.8410 datë 30.9.1998. ‘Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë’
- § Ligji Nr.8503 datë 30.06.1999. ‘Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare’
- § Ligji Nr. 7623, datë 13.10.1992. ‘Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor’
- § Ligji nr.7495, datë 2.7.1991 ‘Për organizimin e Shërbimit Informativ Kombëtar’
- § Ligji Nr. 7574 datë 24.6.1992 .Për Organizimin e Drejtësisë dhe disa Ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile
- § Ligji Nr 7696 datë 07.04.1993. ‘Për shërbimin e rojave civile’ dhe Ligji Nr 7985, datë 13.9.1995. ‘Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr.7696,




Datë 7.4.1993 'Për Shërbimin e Rojave Civile'

- § Ligji Nr.8321 datë 02.04.1998. 'Për policinë e burgjeve'
- § Ligji Nr. 8408, datë 25.09.1998. 'Për Policinë e Ndërtimit'
- § Ligji Nr. 8224, datë 15.5.1997. 'Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës'
- § Ligji Nr. 9074, datë 29.05.2003. Për Shërbimin Informativ Ushtarak.
- § Ligji Nr. 8637, datë 06.07.2000 . 'Për policinë elektrike
- § Ligji Nr. 9397, datë 12.05.2005, 'Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në sistemin e burgjeve'
- § Ligji Nr.9917, datë 19.5.2008, Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- § Dokumenti i Politikës të Mbrojtjes: 2000, Ligji Nr. 8571, datë 27.1.2000. Për Miratimin e Dokumentit të Politikës së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë
- § Ligji Nr 8930 Datë 25-07-2002, 'Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë'
- § Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes: 2005, Ligji Nr.9419, datë 20.5.2005, 'Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë'
- § Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes: 2007, Ligji Nr. 9858 Datë 27-12-2007, 'Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë'
- § Strategjia e Sigurisë Kombëtare: 2000, Ligji Nr.8572, datë 27.1.2000, Për miratimin e Dokumentit të Strategjisë së Sigurimi të Republikës së Shqipërisë
- § Strategjia e Sigurisë Kombëtare: 2004, Ligji Nr.9322, datë 25.11.2004, Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë'



KRONOLOGJIA





KRONOLOGJIA E REFORMËS SË SEKTORIT TË SIGURISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Periodizimi dhe kronologjia e ngjarjeve që lidhen me Reformën e Sektorit të Sigurisë në Shqipëri

Reforma e Sektorit të Sigurisë në Shqipëri ndahet në tre periudha të ndryshme. Kjo ndarje lidhet ngushtë me zhvillimet kryesore politike. Kjo ilustron edhe njëherë gjetjet e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) se RSS është mbi të gjitha një proces politik.⁹

Periudha e parë fillon me rënien e sistemit një partiak komunist, i pasuar nga instalimi i sistemit me zgjedhje të lira dhe konkurrencë midis partive politike dhe ekonomia e tregut, për të mbaruar në vitin 1997 me rrëzimin e strukturave të sigurisë dhe institucioneve të shtetit. Gjatë kësaj periudhe u realizuan reforma të rëndësishme ligjore dhe institucionale, të cilat shënuan shkëputjen tërësore me regjimin komunist, megjithatë, për shkak të kulturës së shkuar politike proceset politike dështuan në arritjen e standardeve të demokracisë liberale, duke çuar në të njëjtën kohë dhe në dëmtime serioze të RSS. Gjatë kësaj periudhe RSS në Shqipëri u zhvilluan në kontekstin post-autoritar.

Periudha e dytë fillon në vitin 1997 dhe mbaron në vitin 2000. Gjatë kësaj periudhe RSS u orientua drejt adresimit të çështjeve të një konteksti post-autoritar por edhe të kontekstit post konflikt.¹⁰

Periudha e tretë fillon në vitin 2000, me hapjen e perspektivës së anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) në këmbim të demokracisë, pajtimit dhe

⁹ OECD, DAC 'Handbook on security system reform: supporting security and justice'. OECD Publishing, 2007.

¹⁰ Dallimi i Shqipërisë nga vendet e tjera me kontekst post-konfliktual të Ballkanit konsiston në faktin se konflikti nuk buronte nga ndarjet etnike por nga politika konfliktuale ndërmjet partive politike.



bashkëpunimit rajonal,¹¹ dhe mbaron me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO.

Kronologjia e ngjarjeve më të rëndësishme

Ngjarjet e sjella në këtë kronologji konsiderohen se përbëjnë ato më të rëndësishmet në nivel kombëtar, rajonal dhe botëror, që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në proceset politike dhe RSS në Shqipëri. Burimet kryesore që janë konsultuar për këtë qëllim janë raporte të medias, raporte dhe studime të organizatave ndërkombëtare, faqet zyrtare në internet të Qendrës së Publikimeve Zyrtare, NATO-s, Bashkimit Evropian, Departamentit të Shtetit të SHBA, etj.

1990

Prill

Shqipëria shpreh vullnetin e saj për të vendosur marrëdhënie diplomatike me Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.¹²

Maj

12. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Javier Perez de Cuellar, viziton Shqipërinë për të zhvilluar bisedime me udhëheqësit komunistë.¹³

Shqipëria shpreh vullnetin për t'iu bashkuar Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.¹⁴

Shtator

29. President i Shqipërisë, Ramiz Alia shprehet për dhënien fund të izolimit të vetë imponuar të Shqipërisë, në fjalimin e tij për herë të parë përpara

¹¹ Deklarata përfundimtare e Samitit të Zagrebit, 24 nëndor 2000, http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accession_process/how_does_a_country_join_the_eu/sap/zagreb_summit_en.htm.

¹² Chris Hedges, 'After a 51-Year Break, Albania Seeks Diplomatic Ties with US'. The New York Times, September 29, 1990.

¹³ David Binder, 'Evolution in Europe; Perez de Cuellar visits Albanians'. The New York Times, May 12, 1990

¹⁴ Chris Hedges, 'After a 51-Year Break, Albania Seeks Diplomatic Ties with US'. The New York Times, September 29, 1990.



Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.¹⁵

Dhjetor

18. Krijohet Partia Demokratike e Shqipërisë, si partia e parë opozitare mbas shumë dekadash, dhe që do të shtronte rrugën drejt një sistemi demokratik shumëpartiak.

24. Qeveria Shqiptare riformatohet në një përpjekje për të sjellë reformistë në skenën politike zyrtare. Fatos Nano emërohet në postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.¹⁶

1991

Janar

14. Kryeministri Grek Konstandin Micotakis viziton Shqipërinë, duke u bërë udhëheqësi i parë i një vendi perëndimor që kryen një vizitë të tillë mbas shumë dekadash, me synim arritjen e një marrëveshje për t'i dhënë fund fluksit të refugjatëve shqiptarë drejt Greqisë. Greqia e konsideronte këtë eksod, si të nxitur nga vetë autoritetet Shqiptare, me synim për të hequr qafe minoritetin që e shihte si kërcënim, dhe për të dobësuar opozitën në prag të zgjedhjeve të para shumë-partiake të planifikuara për në Shkurt.

31. Krijohet Policia Financiare me Dekret të Presidentit.¹⁷

Shkurt

21. Rreth 100.000 njerëz grumbullohen në sheshin 'Skënderbej' të Tiranës dhe rrëzojnë statujën e Enver Hoxhës.¹⁸

23. Katër vetë vriten në një përplasje midis forcave të sigurisë dhe civilëve në Tiranë. Në përpjekje për të shmangur protestat, Presidenti Ramiz Alia emëron një qeveri teknike të drejtuar nga Fatos Nano si Kryeministër.¹⁹

Mars

12. Qeveria shpall amnistinë për të gjithë të burgosurit politikë.²⁰

¹⁵ Ibid.

¹⁶ DReuters, 'Albania Alters Cabinet, Naming a Reformist'. December 24, 1990.

¹⁷ Dekreti Nr. 7463, 31.01.1991, 'Për policinë financiare'

¹⁸ David Binder, 'Political Violence Kills 5 in Albania'. The New York Times, February 26, 1991.

¹⁹ David Binder, 'Albanian Names Cabinet Amid Unrest'. The New York Times, February 23, 1991.

²⁰ David Binder, 'Albanian Names Cabinet amid Unrest'. The New York Times, February 23, 1991.



15. Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës rivendosin marrëdhëniet diplomatike mbas një ndërprerje prej 35 vjetësh. Në Uashington u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit nga Sekretari i Departamentit të Shtetit të SHBA dhe Ministri i Punëve të Jashtme i Shqipërisë.²¹

31. Mbahen zgjedhjet e para shumëpartiake që prej viteve 1920. Dy raundet e zgjedhjeve i dhanë shumicën Partisë së Punës, e cila së bashku me Komitetin e Veteranëve fitoi 56 për qind të votave dhe 68 për qind të vendeve në parlament, ndërsa Partia Demokratike fitoi 30 për qind.²²

- Autoritetet Italiane lejuan disa anije me rreth 25,000 shqiptarë në bord që të hyjnë në portin e Barit, por anije të tjera që mbërritën më vonë u kthyen mbrapa.²³

Prill

3. Tre vetë u vranë dhe shumë të tjerë u plagosën në qytetin e Shkodrës kur njësite të ushtrisë hapën zjarr mbi demonstruesit që protestonin kundër rezultatit të zgjedhjeve.²⁴

29. Parlamenti miraton ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese, i cili shfuqizoi Kushtetutën e vitit 1976, përfshiu të drejtat themelore të njeriut dhe ndarjen e pushteteve. Dispozitat kushtetuese e përcaktuan Shqipërinë si republikë parlamentare, me parlamentin si organi më i lartë që zgjedh Këshillin e Ministrave, Presidentin dhe një pjesë të organeve të larta të gjyqësorit.²⁵

Maj

10. Fatos Nano shpall kabinetin me 25 anëtarë. Ministria e Brendshme u transformua në Ministrinë e Rendit Publik dhe u krijua një Komitet për Sigurinë Kombëtare.²⁶

Qershor

5. Qeveria jep dorëheqjen mbas grevës së përgjithshme të sindikatave, të cilat protestuan për përkeqësimin e kushteve të jetesës dhe vrasjen e tre

²¹ Fact Sheet: Albania, Anonymous. *U.S. Department of State Dispatch*; Mar 18, 1991; 2, 11; Research Library Core p.196.

²² Commission on Security and Cooperation in Europe, 'The Elections in Albania; March-April 1991'. Report prepared by the staff of the Commission on Security and Cooperation in Europe.

²³ Rusell King and Juli Vullnetari, 'Migration and Development in Albania, Working Paper C5, Sussex Centre for Migration Research. December 2003.

²⁴ David Binder, 'Albanian Troops Kill 3 Protesters and Wound 30' Special to The New York Times, April 3, 1991.

²⁵ Ligji Nr. 7491, 29.04.1991, 'Per dispozitat kryesore kushtetuese'

²⁶ Associated Press, 'Albanian Names an All-Communist Cabinet'. May 10, 1991.



demonstruesve të opozitës në qytetin e Shkodrës. Një qeveri me koalicion me bazë të gjerë u formua me pjesëmarrjen edhe të partive të opozitës.²⁷

19. Shqipëria pranohet si anëtare e OSBE.²⁸

23. Sekretari i Shtetit i SHBA Xhejms Beiker kryen vizitën e parë të kryer ndonjëherë nga një zyrtar i lartë amerikan në Shqipëri.^{29 30}

Korrik

2. 'Sigurimi', agjencia shtetërore e sigurisë gjatë periudhës së komunizmit shpërbëhet dhe krijohet Shërbimi Informativ Kombëtar, si një organ informativ-gjurmues, pjesë e Forcave të Armatosura.³¹ Afërsisht 98 për qind e personelit të Sigurimit u shkarkua nga detyra.³²

3. Parlamenti miraton ligjin për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura. Sipas këtij ligji detyrat kryesore të ushtarakut janë besnikëria ndaj atdheut, aftësitë ushtarake, shpirti i sakrificës, bindja ndaj kushtetutës dhe ligjeve, ruajtja e sekretit ushtarak dhe e pronës së ushtrisë. Nga kufizimet kryesore ligji parashikonte ndalimin për të marrë pjesë në parti politike, sindikata dhe ndalonte grevën dhe kundërshtimin kolektiv.³³

6. Rivendosen gradat në ushtri, të hequra që në vitin 1966.³⁴

Gusht

Parlamenti diskuton për marrjen e masave mbi rolin e ushtrisë, organeve të punëve të brendshme dhe organeve të drejtësisë në kushtet e pluralizmit politik.³⁵ Në vijim miraton ligjin për depolitizimin e institucioneve të sigurisë.³⁶

²⁷ David Binder, 'Albania Picks a Caretaker Chief'. The New York Times, June 6, 1991.

²⁸ OSCE, Participating States, <http://www.osce.org/about/13131.html>. Gjetur, qershor 2009.

²⁹ The New York Times, '300,000 Albanians Pour into Streets to Welcome Baker', June 23, 1991.

³⁰ Fact Sheet: Secretary Baker Visits Yugoslavia and Albania', Anonymous, *U.S. Department of State Dispatch*; Jul 1, 1991; 2, 26; Research Library Core, pg. 469

³¹ Ligji nr.7495, datë 2.7.1991 'Për organizimin e Shërbimit Informativ Kombëtar'.

³² Aleks Luarasi, 'Legal and institutional reform in Albania after the democratic revolution (1991 - 1997)'; Tirana University, Albania. May, 1997.

<http://www.nato.int/acad/fellow/95-97/luarasi.pdf>. Gjetur, qershor 2009.

³³ Ligji Nr. 7496 datë 3.7.1991, Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

³⁴ Ligji Nr. 7499, datë 6.7.1991, Për rivendosjen e gradave ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë

³⁵ Aleks Luarasi, 'Legal and Institutional Reform in Albania after the Democratic Revolution (1991 - 1997)'; Tirana, University, Albania. May, 1997.

³⁶ Ligj Nr 7492 datë 08-06-1991, 'Për departizimin dhe depolitizimin e disa organeve shtetërore'



Tetor

1. Ambasada e SHBA rihapet në Tiranë, 52 vjet mbas mbylljes në vijim të fillimit të Luftës së Dytë Botërore.³⁷

15. Shqipëria bëhet anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar.³⁸

Dhjetor

5. Partia Demokratike tërhiqet nga koalicioni qeverisës. Krijohet qeveria teknike dhe vendoset çuarja e vendit në zgjedhje të parakohshme.³⁹

11. Parlamenti miraton ligjin për krijimin e Shërbimit Informativ të Ushtrisë dhe të Kundërzbulimit në organet e Ministrisë së Rendit Publik.⁴⁰

17. Parlamenti amendon ligjin për prokurorinë,⁴¹ dhe miraton ligjin për hetimin.⁴²

1992

Janar

30. Parlamenti amendon ligjin për Kodin Penal.⁴³

22. Parlamenti miraton ligjin për forcat e ndërhyrjes së shpejtë. Këto forca varen nga Ministria e Rendit Publik dhe përmbajnë forca speciale të trajnuara për të ndërhyrë në raste kur çënohet rëndë rendi publik, në akte terrori, dhune dhe në çdo rast kur forcat e policisë së rendit nuk janë efektive.⁴⁴

Maj

Shqipëria nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Ekonomik dhe Tregëtar me Bashkimin Evropian.⁴⁵

³⁷ Albania (03/99), <http://www.state.gov/outofdate/bgn/a/9200.htm>. Gjetur, qershor 2009.

³⁸ Albania and the IMF. <http://www.imf.org/external/country/ALB/index.htm?pn=0>. Gjetur, qershor 2009.

³⁹ The New York Times, 'Main Opposition Party Quits Albania Cabinet', December 5, 1991.

⁴⁰ Ligji Nr. 7530 datë 11.12.1991, Për Organizimin e Shërbimit Informativ Ushtarak dhe të Shërbimit të Kundërzbulimit në Organet e Rendit Publik.

⁴¹ Ligji Nr. 7538 datë 17.12.1991, Për disa ndryshime në ligjin nr. 6298, datë 27.03.1981 'Për Prokurorinë e Republikës së Shqipërisë'.

⁴² Ligji Nr. 7539 datë 17.12.1991, Për ndryshimin e ligjit nr. 6800, datë 29.06.1983 'Për Hetuesinë e Republikës së Shqipërisë'.

⁴³ Ligji Nr. 7553 datë 30.01.1992, Për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

⁴⁴ Ligji Nr. 7551, datë 22.01.1992, Për Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë.

⁴⁵ Delegation of the European Commission (EC) to Albania

http://www.delalib.ec.europa.eu/en/eu_and_albania/agreements. Gjetur, qershor 2009.



Mars

22. Mbahen zgjedhjet e dyta shumëpartiake. Partia Demokratike fiton 92 nga 140 vendet në parlament.⁴⁶

Prill

5. Presidenti Ramiz Alia i dorëzon dorëheqjen parlamentit të sapozgjedhur. Lideri i Partisë Demokratike Sali Berisha, zgjidhet si Presidenti i parë i periudhës postkomuniste.⁴⁷

Qershor

5. Shqipëria i bashkohet Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior (i riemëruar si Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik në vitin 1997).⁴⁸

16. Presidenti shqiptar Sali Berisha takohet me Presidentin e SHBA Xhorxh Bush. Siguria dhe stabiliteti në Ballkan ishin temat kryesore e diskutimeve.⁴⁹

Shtator

Parlamenti shkarkon Prokurorin e Përgjithshëm, Maks Haxhia. Një muaj më vonë Gjykata Kushtetuese e gjykoi shkarkimin si jo kushtetues, megjithatë parlamenti emëron Alush Dragoshin në këtë detyrë.

29. Ministrat e financës të Komunitetit Evropian miratojnë një grant prej 95 milionë dollarë për të ndihmuar vendin.⁵¹

Tetor

6. Shqipëria ratifikon Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Tregtinë dhe

⁴⁶ Henry Kamm, 'Ex-Communists Lose in Albania Vote', The New York Times, March 23, 1992.

⁴⁷ 'Albania's Democratic Party Names Surgeon to Fill President's Post', The New York Times, April 5, 1992.

⁴⁸ NATO news, http://www.nato.int/cps/en/natolive/news_23923.htm?selectedLocale=en. Gjetur, qershor 2009.

⁴⁹ David Binder, 'Albanian Leader Tells Bush of His Fear of Serbia', The New York Times, June 16, 1992.

⁵⁰ -Vendimi i Kuvendit Popullor Nr. 231, datë 17.09.1992, për shkarkimi nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm Maks Haxhia.

- Vendim Nr. 12, 28.10.1992 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë me objekt 'Pakushtetueshmëria e Vendimit të Kuvendit Popullor nr. 231, datë 17.09.1992, për shkarkimin nga detyra..'

⁵¹ 'European Grant to Albania', The New York Times, September 29, 1992.



Bashkëpunimin Ekonomik dhe Tregtar me Bashkimin Evropian.⁵² Marrëveshja hyri në fuqi në dhjetor 1992.

13. Parlamenti miraton ligjin për pyjet dhe Policinë Pyjore.⁵³

- Shqipëria anëtarësohet në Organizatën e Konferencës Islamike. Kjo lëvizje, e mbeshetur nga vetë Presidenti Berisha, shkaktoi reagime kritike në vend dhe në kancelaritë Evropiane.⁵⁴

Dhjetor

16. Presidenti Berisha viziton Shtabin e NATO-s. Ai mbajti një fjalë në Këshillin e Atlantikut Verior dhe u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të organizatës Manfred Worner.⁵⁵

17. Në një takim me Sekretarin e Përgjithshëm, Manfred Worner dhe me përfaqësuesit e 16 vendeve të NATO-s, Presidenti Berisha deklaroi zyrtarisht se Shqipëria kërkon të anëtarësohet në Aleancë.⁵⁶

1993

Janar

- Qeveria e Shqipërisë i ofron NATO-s bazat e saj ajrore dhe detare në ndihmë të zbatimit të sanksioneve të OKB dhe operacioneve kundër Jugosllavisë.⁵⁷

Mars

19. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Manfred Worner viziton Shqipërinë. Në fjalën e mbajtur në Parlament ai u shpreh se 'Shqipëria mund të jetë vend i vogël por ka një rol të rëndësishëm për të luajtur'.⁵⁸

⁵² Ligji Nr. datë 6.10.1992, Për Ratifikimin e 'Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Ekonomik Evropian për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar dhe Ekonomik'.

⁵³ Ligji Nr. 7623 datë 13.10.1992, 'Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor'.

⁵⁴ Remzi Lani and Fabian Schmidt, 'Albanian Foreign Policy between Geography and History', *The International Spectator*, Volume XXXIII No. 2 (April-June 1998).

⁵⁵ Adem Copani 'The new dimensions of Albania security posture', 1996 <http://www.nato.int/docu/review/1996/9602-6.htm>. Gjetur, qershor 2009.

⁵⁶ 'Albania Seeks Tie to NATO, and Protection', December 17, 1992.

⁵⁷ Adem Copani 'The new dimensions of Albania security posture', 1996 <http://www.nato.int/docu/review/1996/9602-6.htm>. Gjetur, qershor 2009.

⁵⁸ 'NATO Secretary General addresses Albanian Parliament' http://www.nato.int/cps/en/natolive/news_24105.htm?selectedLocale=en. Gjetur, qershor 2009.



28. Parlamenti miraton ligjin për Policinë Ndërtimore.⁵⁹

Prill

- Shqipëria njeh Republikën Ish-Jugosllave të Maqedonisë.

7. Parlamenti miraton ligjin për shërbimin e rojeve civile.⁶⁰

25. Papa Gjon Pali II viziton Shqipërinë. Në fjalën e tij, Papa Gjon Pali II e krahasoi fatin e Shqipërisë me pasionin e Krishtit duke thënë se është 'pasuruar nga kaq shumë martirë' dhe që po gëzon 'lirinë e ringjalljes'.^{61 62}

Maj

31. Presidenti Sali Berisha i kërkon SHBA dhe NATO-s të dërgojnë trupa në provincën e Kosovës, në Serbi, për të ndaluar shtrirjen e 'pastrimit etnik' në popullsinë shqiptare të rajonit.⁶³

Qershor

- Shqipëria largon nga vendi një prift ortodoks Grek, mbi akuza për nxitje të pakënaqësive tek minoriteti Grek në jug të vendit. Greqia u kundërpërgjigj me dëbimin e 30,000 emigrantëve ilegalë shqiptarë atje.⁶⁴

- Shërbimi civil trazohet nga zëvendësimet masive të teknokratëve dhe zyrtarëve të regjimit të mëparshëm me mbështetës të Partisë Demokratike. Edhe qeverisja lokale kalon në kaos, pasi zyrtarët e Partisë Demokratike në qeverisjen qendrore përplasen me kryetarët e sapozgjedhur të bashkive dhe komuneve të Partisë Socialiste që fituan në zgjedhjet lokale.⁶⁵

Korrik

- Lideri i Partisë Socialiste, ish Kryeministri Fatos Nano, arrestohet me akuzën se

⁵⁹ Ligji Nr. 7752 datë 28.03.1993, Për Policinë Ndërtimit

⁶⁰ Ligji Nr. 7696 datë 07.04.1993, Për shërbimin e rojave civile

⁶¹ Alan Cowell, 'Pope Goes to Albania and Warns of 'Aggressive Nationalism', The New York Times, Monday, April 26, 1993.

⁶² 'Pope's Visit Confirms Albania's New Status', National Catholic Reporter; May 7, 1993; 29, 27; Research Library Core, pg. 13.

⁶³ Henry Kamm, 'Albania Chief Urges West to Send Troops to Kosovo to Prevent War', The New York Times, May 31, 1993.

⁶⁴ Human Rights Watch, 'ALBANIA, THE GREEK MINORITY', February 1994 Vol. 7, No. 4 (D) http://www.hrw.org/legacy/reports/1995/Albania.htm#P196_34923#P196_34923. Gjetur, qershor 2009.

⁶⁵ 'Albania: Oh, dear', *Anonymous*. The Economist. London: Jun 5, 1993. Vol. 327, Iss. 7814; pg. 56.



ka abuzuar me pushtetin.⁶⁶

- Shqipëria ratifikon Konventën e Armëve Kimike.⁶⁷

Gusht

- Ish Presidenti komunist, Ramiz Alia arrestohet dhe gjykohet për abuzim me pushtetin. Më shumë se 30 ish-zyrtarë të lartë komunistë arrestohen dhe burgosen për hetime me akuzën për genocid. Deri në fund të vitit 30 nga ata u dënuan për 'krime kundër njerzimit'.⁶⁸

Tetor

- SHBA nënshkruajnë një marrëveshje me Shqipërinë, e para e këtij lloji me një vend ish komunist, për zgjerimin e marrëdhënieve ushtarake dhe të mbrojtjes ndërmjet dy vendeve. Marrëveshja u nënshkrua nga Sekretari i Mbrojtjes i SHBA, Les Aspin (8 tetor) dhe nga Ministri i Mbrojtjes, Safet Zhulali (14 tetor).⁶⁹

1994

Janar

30. Shqipëria vë në dispozicion bazat e saj ajrore, për t'u përdorur nga avionët spiunë të SHBA, të cilët merrnin të dhëna fotografike mbi betejat dhe lëvizjet e trupave në Serbi dhe Bosnje Hercegovinë.⁷⁰

Shkurt

23. Presidenti Sali Berisha viziton Shtabin e NATO-s për të nënshkruar Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe.

⁶⁶ Council of Europe, Parliamentary Assembly, 'MOTION FOR A RESOLUTION on the case of Mr Fatos Nano, member of the Parliament of Albania presented by Mr ROMAN and others', <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/WorkingDocs/Doc94/EDOC7014.htm> . Gjetur, qershor 2009.

⁶⁷ Ligji Nr.7747 datë 29.07.1993, Për ratifikimin e konventës 'Për ndalimin e zhvillimit, prodhimit, stokimit e përdorimit të armëve kimike dhe shkatërrimin e tyre.

⁶⁸ Amnesty International, 1997 Annual Report for Albania, <http://www.amnestyusa.org/annualreport.php?id=D8FADB8615E000C880256A0F005BEA9D&c=ALB>. Gjetur, qershor 2009.

⁶⁹ David Binder 'U.S. and Albania Sign a Military Agreement', The New York Times, October 21, 1993.

⁷⁰ 'US to Base Balkans Spy Plane in Albania', The New York Times, January 30, 1994.



Prill

3. Lideri i opozitës, Fatos Nano dënohet me 12 vjet burg për keqpërdorim të fondeve shtetërore gjatë mandatit si Kryeministër. Gjyqi u konsiderua si një shfaqje politike.⁷¹

10. Dy ushtarë shqiptarë vriten në një repart ushtarak në jug të vendit nga sulmues të Frontit për Çlirimin e Epirit të Veriut.⁷² Marrëdhëniet Shqiptaro-Greke përkeqësohen akoma më tepër.⁷³

18. Si rezultat i një veprimi të koordinuar policor të ndërmarrë në jugun e vendit, ku është e përqendruar minoriteti grek, u arrestuan 30 vetë. Marrëdhëniet midis dy vendeve njohin përkeqësim të thellë me dëbime diplomatësh dhe mbyllje të kufijve.⁷⁴

20. Parlamenti ratifikon Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe midis Shqipërisë dhe NATO-s.⁷⁵

Maj

5. Presidenti Sali Berisha fal pesë gazetarë të dënuar për shpifje ndaj shërbimit sekret, publikim të sekreteve shtetërore dhe fyerje ndaj Presidentit Berisha.⁷⁶

Korrik

3. Ish Presidenti Ramiz Alia dënohet me nëntë vjetë burg për abuzim me pushtetin dhe dhunim të të drejtave të shtetasve. Dënimi i tij dhe i 9 zyrtarëve të tjerë të lartë të komunizmit mbylli proceset ndaj ish zyrtarëve të elitës komuniste.⁷⁷

Shtator

7. Pesë anëtarë të rëndësishëm të organizatës së lëvizjes politike të minoritetit

⁷¹ 'Albania: Just for show', *Anonymous*. The Economist. London: Apr 9, 1994. Vol. 331, Iss. 7858; pg. 53.

⁷² Greece and Albania: Border blows, *Anonymous*. The Economist. London: Apr 30, 1994. Vol. 331, Iss. 7861; pg. 60.

⁷³ Maria Vidali, 'Living in a Policy Vacuum: The plight of Albanian immigrants in Greece', Central Europe Review Vol 1, No 21, 15 November 1999.

⁷⁴ Human Rights Watch, 'Albania: The Greek Minority', February 1994 Vol. 7, No. 4 (D) http://www.hrw.org/legacy/reports/1995/Albania.htm#P196_34923#P196_34923. Gjetur, qershor 2009.

⁷⁵ Ligji Nr. 7816 datë 20.04.1994, 'Për ratifikimin e Dokumentit Kuadër të Partneritetit për Paqe mes RSH dhe Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior.

⁷⁶ The New York Times, 'Albania Pardons 5 journalists', May 5, 1994.

⁷⁷ '9 Years for Albanian', The New York Times, July 3, 1994.



Grek 'Omonia', të arrestuar në prill, u dënuan me burgime nga 6 deri në 8 vjet, me akuzën e spiunazhit për Greqinë dhe mbajtje të paligjshme të armëve.⁷⁸

22. Shqipëria dorëzon në NATO dokumentin e Partneritetit për Paqe.⁷⁹

Nëntor

6. Shumica (53.9%) e votuesve shqiptarë votuan kundër kushtetutës, të cilën Presidenti Berisha kishte mbështetur personalisht në një fushatë intensive.⁸⁰

Dhjetor

Marrëdhëniet me Greqinë vazhdojnë të përkeqësohen.⁸¹

1995

Janar

27. Parlamenti miraton Kodin e ri Penal.⁸²

Shkurt

- Marrëdhëniet me Greqinë fillojnë të përmirësohen. Gjykata e Lartë vendos për lirimin e katër aktivistëve minoritarë grekë.⁸³

Prill

- Këshilli i Mbrojtjes miraton 'Politikën e Sigurisë dhe Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë', hera e parë që miratohet një dokument i tillë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.⁸⁴

⁷⁸ Greece v Albania: Elsewhere in the Balkans .../Anonymous. The Economist. London: Sep 17, 1994. Vol. 332, Iss. 7881; pg. 59.

⁷⁹ NATO Homepage, <http://www.nato.int/docu/update/1994/9409e.htm>. Gjetur, qershor 2009.

⁸⁰ Henry Kamm, 'President of Albania is Rebuffed on Charter', The New York Times, December 1, 1994.

⁸¹ Henry Kamm, 'Conflict with Greece Leaves Some in Albania Perplexed', The New York Times, December 19, 1994.

<http://www.nytimes.com/1994/12/19/world/conflict-with-greece-leaves-some-in-albania-perplexed.html>. Gjetur, qershor 2009

⁸² Ligji Nr.7895 datë 27.01.1995, Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

⁸³ Human Rights Watch, Human Rights Developments, Albania 1995, http://www.hrw.org/reports/1996/WR96/Helsinki-01.htm#P125_26490. Gjetur, qershor 2009.

⁸⁴ Adem Copani 'The new dimensions of Albania security posture', 1996 <http://www.nato.int/docu/review/1996/9602-6.htm>. Gjetur, qershor 2009.



- Shqipëria bëhet objekt kritikash për shkelje të embargos së OKB ndaj Jugosllavisë.⁸⁵

Maj

24. Parlamenti ndryshon ligjin dhe zëvendëson Policinë Financiare me Policinë Doganore dhe Tatimore.⁸⁶

Korrik

8. Ish Presidenti Ramiz Alia lirohet nga burgju. Lirimi i tij u konsiderua si lëvizje në prag të anëtarësimit të pritshëm të Shqipërisë në Këshillin e Evropës.⁸⁷

13. Shqipëria bëhet vendi i 35-të i Këshillit të Evropës.⁸⁸

17-21. SHBA dhe Shqipëria organizojnë stërvitjen e përbashkët ushtarake 'Rescue Eagle'. Forcave të Armatosura shqiptare iu bashkuan dhe forcat amfibe të Flotës së Gjashtë dhe 1700 marinsa nga Marine Expedition Unit, së bashku me helikoptermbajtësen USS Kearsarge dhe USS Nashville.⁸⁹

26. Parlamenti miraton ligjin për Forcat e Armatosura. Sipas këtij ligji, Forcat e Armatosura përbëhen nga tre pjesë: ushtria, forcat policore të Ministrisë së Rendit Publik dhe nga Shërbimi Informativ Kombëtar.⁹⁰

Gusht

10. Krijohet Policia Gjyqësore në vijim të miratimit të Kodit Penal. Misioni i saj është që të identifikojë dhe hetojë aktivitetet kriminale me iniciativën e saj, ose me autorizim nga prokurori. Oficerët e këtij organi do të varen administrativisht nga Ministria e Rendit Publik, por kryejnë shërbime për prokurorinë ose gjykatat sipas Kodit të Procedurës Penale.⁹¹

- Trupat shqiptare marrin pjesë në stërvitje të përbashkët me ushtrinë e SHBA në stërvitjen 'Operation Cooperative Nugget 95', në Fort Pol,

⁸⁵ Raymond Bonner, 'Embargo against Belgrade Has a Major Leak', the New York Times, April 15, 1995.

⁸⁶ Ligji Nr. 7938, datë 24.05.1995, 'Për Miratimin me Ndryshime të Dekretit Nr.1074, Datë 21.4.1995 'Për Shpërbërjen e Policisë Financiare dhe Krijimin e Policisë Doganore dhe Policisë Tatimore'

⁸⁷ The New York Times, 'Albania Frees Communist', July 8, 1995.

⁸⁸ 'Albania and Council of Europe', http://www.coe.int/T/e/com/about_coe/member_states/e_al.asp. Gjetur, qershor 2009.

⁸⁹ Adem Copani 'The new dimensions of Albania security posture', 1996 <http://www.nato.int/docu/review/1996/9602-6.htm>. Gjetur, qershor 2009.

⁹⁰ Ligji Nr. 7978 datë 26.07.1995, Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

⁹¹ Ligji Nr. 1188 datë 10.08.1995, Për Policinë Gjyqësore .



Louisiana të SHBA. ⁹²

Shtator

11. Presidenti Sali Berisha viziton SHBA ku takohet me Presidentin Bill Clinton, i cili shprehet se SHBA vazhdojnë të jenë mbështetës të fuqishëm të Shqipërisë. ⁹³

21. Me propozim të Presidentit Sali Berisha, Parlamenti shkarkon nga detyra Kryetarin e Gjykatës së Lartë Zef Brozi. Gjykata Kushtetuese e vlerëson shkarkimin si jo kushtetues. ⁹⁴

22. Parlamenti miraton një ligj, i cili ndalon zgjedhjen ose emërimin në funksione në institucione qendrore ose lokale, në sistemin gjyqësor dhe në media të gjithë personave që kanë kryer krime ose kanë mbajtur pozicione të larta gjatë regjimit komunist. ⁹⁵

28. Parlamenti miraton Kodin Penal Ushtarak. ⁹⁶

Nëntor

22. Shqipëria ratifikon marrëdhënien shumëpalëshe për Statusin e Forcave (SOFA) me NATO-n në kuadër të Partneritetit për Paqe. ⁹⁷

30. Parlamenti miraton një ligj sipas të cilit, individët që kanë pasur pozicione të larta në administratën komuniste që nga 28 Nëntori 1944, nuk mund të zgjidhen ose mbajnë funksione të rëndësishme në qeverinë demokratike. ⁹⁸

⁹² Adem Copani 'The new dimensions of Albania security posture', 1996
<http://www.nato.int/docu/review/1996/9602-6.htm>. Gjetur, qershor 2009.

⁹³ Steven Lee Myers, 'U.S. Long Shot in Albania Fails to Pay Off', The New York Times, March 20, 1997.

⁹⁴ Marianne Sullivan, 'ALBANIA: Tyranny in the Robes of Democracy', Transition - VOL. 2 NO. 3 - 9 February 1996.

⁹⁵ Aleks Luarasi, 'Legal and Institutional Reform in Albania after the Democratic Revolution (1991 - 1997)', Tirana, University, Albania. May, 1997.
<http://www.nato.int/acad/fellow/95-97/luarasi.pdf>. Gjetur, qershor 2009.

⁹⁶ Ligji Nr. 8003 datë 28.09.1995, 'Kodi Penal Ushtarak i Republikës së Shqipërisë'

⁹⁷ Ligji Nr. 8034 datë 22.11.1995, Për Ratifikimin e 'Marrëveshjes Ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut Lidhur me Statusin e Forcave', Nënshkruar në Londër më 19 Qershor 1951, dhe të 'Marrëveshjes Ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të Tjera që Marrin Pjesë në Partneritetin për Paqe Përsa i Përket Statusit të Forcave të Tyre', Nënshkruar Në Bruksel Më 10 Janar 1994, si dhe të Protokollit Shtesë për Marrëveshjen Ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe të Shteteve të Tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe Përsa i Përket Statusit të Forcave të Tyre.

⁹⁸ Aleks Luarasi, 'Legal and Institutional Reform in Albania after the Democratic Revolution (1991 - 1997)', Tirana, University, Albania. May, 1997.
<http://www.nato.int/acad/fellow/95-97/luarasi.pdf>. Gjetur, qershor 2009



1996

Janar

23. Bëhen amendime në Kodin Penal, me qëllim forcimin e disa dënimeve që kanë të bëjnë me kontrabandën, trafikun e drogës, armëve dhe prostitucionit, rëmbimin e personave dhe korrupsionin.⁹⁹

Shkurt

26. Një makinë bombë vret 5 vetë dhe plagos 30 të tjerë, përpara një supermarketi në qendër të Tiranës.¹⁰⁰

26. BE miraton Qasjen Rajonale për vendet e Evropës Juglindore.¹⁰¹

Maj

26. Zgjedhjet e treta parlamentare e zhysin vendin në krizë të thellë politike. Partitë e opozitës akuzuan qeverinë për manipulim të votimit dhe ndërmoren protesta të cilat u shpërndanë me forcë nga policia. Komuniteti ndërkombëtar reagon duke kërcënuar Shqipërinë me izolim dhe përjashtim nga Këshilli i Evropës.^{102 103 104}

Korrik

31. Shqipëria ratifikon Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.¹⁰⁵

Shtator

5. Shqipëria vendos të dërgojë trupa në Bosnje Hercegovina për të marrë pjesë

⁹⁹ Ligji Nr. 8175 datë 23.12.1996, 'Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

¹⁰⁰ The New York Times, 'Bomb Kills 5 in Albania; 2 Ex-Officers Arrested' February 27, 1996.

¹⁰¹ Conclusions of the General Affairs Council of 26 February 1996.

http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressdata/en/gena/028a0001.htm. Gjetur, qershor 2009

¹⁰² Jane Perlez, 'Riot Police Beat and Arrest Albania Election Protesters', The New York Times, May 29, 1996

¹⁰³ Jane Perlez '2 Monitoring Groups Call Albania Vote Marred', The New York Times, May 30, 1996

¹⁰⁴ Daniels Anthony, 'Eye of the beholder', National Review. New York: Jul 1, 1996. Vol. 48, Iss. 12; pg. 43

¹⁰⁵ Ligji Nr. 8137 datë 31.07.1996, 'Për ratifikimin e Konventës Evropiane 'Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore'



në misionin e IFOR. Kjo është hera e parë që trupa Shqiptare dërgohen me mision jashtë vendit. Njësia me 33 vetë personel ushtarak, do të shërbejë në kuadër të kontigjentit gjerman të IFOR.¹⁰⁶

Dhjetor

- Protesta anti-qeveritare fillojnë në Tiranë kur skema piramidale investimesh filluan të shemben.¹⁰⁷

1997

Janar-Shkurt

- Qeveria reagon ndaj protestave në rritje me shtypje dhe forcë. Ndërsa demonstratat bëhen gjithnjë e më të dhunshme, turma njerëzish bastisin zyra të Partisë Demokratike dhe pushtetit lokal në jug të vendit.¹⁰⁸

Mars

2-3. Kryeministri Aleksander Meksi jep dorëheqjen dhe shpallet gjendja e jashtëzakonshme. Presidenti Berisha rizgjidhet nga Parlamenti. Ushtria dhe i tërë aparati shtetëror filluan të bien dhe popullsia civile armatoset me të gjitha llojet e armëve që gjenden në depot e ushtrisë.¹⁰⁹

9. Si rezultat i presionit ndërkombëtar dhe situatës së brendshme në përkeqësim, arrihet një marrëveshje ndërmjet Presidentit Berisha dhe partive kryesore politike për formimin e një qeverie të pajtimit kombëtar.¹¹⁰

13. Evakuohen qytetarët e parë amerikanë nga Shqipëria. Departamenti i Shtetit i SHBA i bën thirrje të 2000 shtetasve amerikanë që gjenden në Shqipëri, të largohen nga vendi.¹¹¹

14. Udhëheqësit politikë të Shqipërisë bëjnë apel për ndihmë të menjëherëshme nga NATO, BE dhe OKB. Ish Kancelari i Austrisë Franz Vranitzky merr

¹⁰⁶ Ligji Nr.8139 datë 05.09.1996, Për dërgimin e Kompanisë Paqeruajtëse Shqiptare, për të marrë pjesë në operacion e NATO-s 'Përpjekja e përbashkët' në ish-Jugosllavi

¹⁰⁷ Human Rights Developments, Human Rights Watch World Report 1998, ALBANIA http://www.hrw.org/worldreport/Helsinki-01.htm#P125_41527. Gjetur, qershor 2009

¹⁰⁸ Ibid

¹⁰⁹ Ibid

¹¹⁰ Ibid

¹¹¹ Jane Perlez 'Bitter Albanians, Facing Anarchy, Arm Themselves', The New York Times, March 14, 1997.



rolin e ndërmjetësit politik në Shqipëri, i caktuar nga OSBE. ¹¹²

15. Ministri i Mbrojtjes Safet Zhulali dhe zyrtarë të tjerë të lartë largohen nga vendi. Vendet e huaja evakujnë shtetasit e tyre nga Shqipëria. ¹¹³

28. 81 vetë humbën jetën mbas përplasjes së një anije të ushtrisë italiane, me një anije të vogël me të cilin qytetarë shqiptarë po largoheshin drejt Italisë. Aludimet për një veprim të paramenduar nga anija Italiane, rrezikojnë planin e OKB për një mision ushtarak në Shqipëri të drejtuar nga Italia. ¹¹⁴

28. Këshilli i Sigurimit i OKB autorizon një forcë me pjesëmarrjen e tetë vendeve, të drejtuar nga Italia, për të siguruar shpërndarjen e ndihmave humanitare, edhe pse organizatat humanitare u shprehën se nuk kishin nevojë për një ndihmë të tillë. Shumë vëzhgues besonin se arsyeja e pa thënë për këtë ndërhyrje, ishte ndalimi i një fluksi refugjatësh shqiptarë drejt Italisë dhe vendeve të tjera fqinje. ^{115 116}

Prill

- Forca shumëkombëshe, e udhëhequr nga Italia fillon të mbërrijë në Shqipëri me mandat të Këshillit të Sigurimit të OKB. 7000 trupa nga tetë vende Evropiane marrin pjesë në 'Operacionin Alba'.

14. Kryeministri Italian Romano Prodi viziton Shqipërinë, ndërsa trupat e para italiane mbërritën për të përgatitur terrenin për ardhjen e forcës shumëkombëshe. ¹¹⁷

Qershor

- Partia Socialiste, e udhëhequr nga Fatos Nano fiton zgjedhjet parlamentare me 100 nga 155 vendet në parlament. Partitë aleate të saj fituan 17 vende dhe Partia Demokratike fitoi vetëm 27 vende. Në referendumin e mbajtur në të njëjtën ditë, rreth një e treta e votuesve mbështetën rivendosjen e monarkisë.

¹¹² 'Europe's Role in Albania', The New York Times, March 14, 1997.

¹¹³ Jane Perlez, 'Albania Chief's Associates Flee; Gunfire Halts Evacuation by US', The New York Times, March 15, 1997.

¹¹⁴ John Taligabue, 'Albania Envoy Accuses Italy in Sinking of Refugee Boat', The New York Times, March 31, 1997.

¹¹⁵ Human Rights Developments. Human Rights Watch World Report 1998, ALBANIA. http://www.hrw.org/worldreport/Helsinki-01.htm#P125_41527. Gjetur, qershor 2009.

¹¹⁶ Paul Lewis, 'UN Backs Sending Troops to Restore Order in Albania', The New York Times, March 29, 1997.

¹¹⁷ 'Italian Prime Minister, Visiting Albania, Vows to Restore Order', The New York Times, April 14, 1997.



Korrik

- 23.** Presidenti Berisha jep dorëheqjen.
- 24.** Parlamenti zgjedh Rexhep Mejdani President. Në të njëjtën ditë hiqet dhe gjendja e jashtëzakonshme e vendosur që prej 5 muajsh.
- 25.** Prezantohet qeveria e re e koalicionit me Fatos Nanon si Kryeministër, Paskal Milo Ministër i Jashtëm, Sabit Brokaj Ministër i Mbrojtjes dhe Neritan Ceka Ministër i Rendit Publik.¹¹⁸

Gusht

- 8.** Prokurori i Përgjithshëm, Alush Dragoshi jep dorëheqjen.¹¹⁹
- 11.** Gjashtëdhjetë trupat e fundit të forcës paqeruajtëse ndërkombëtare largohen nga Shqipëria, një ditë përpara përfundimit të mandatit të Operacionit ALBA.¹²⁰
- 13.** Arben Rakipi emërohet Prokurori i Përgjithshëm.¹²¹

Shtator

- 7.** Presidenti Rexhep Mejdani shkarkon 17 gjeneralë, në një përpjekje për të riformtuar Forcat e Armatosura për paaftësinë e treguar në menaxhimin e krizës së muajit mars 1997.¹²²
- 20.** Deputeti i Partisë Demokratike, Azem Hajdari plagoset me armë zjarri brenda Parlamentit nga një deputet i Partisë Socialiste.¹²³

Nëntor

- 4.** Kryeministri Fatos Nano takohet me Presidentin jugosllav Miloseviç, në Kretë të Greqisë. Takimi i parë i një niveli të tillë mbas 50 vjetësh u përqendrua në çështjen e Kosovës.¹²⁴

- Këshilli i Ministrave të BE vendos politikën e kushtëzimit ekonomik dhe

¹¹⁸ Rulers, <http://rulers.org/1997-07.html>. Gjetur, qershor 2009.

¹¹⁹ Agjensia Telegrafike Shqiptare (ATSH), 97-08-08 <https://www.hri.org/news/balkans/ata/1997/97-08-08.ata.html#10>. Gjetur, qershor 2009.

¹²⁰ RFE/RL Newsline, Vol. 1, No. 93, 97-08-12 Radio Free Europe/Radio Liberty <http://www.hri.org/news/balkans/rferl/1997/97-08-12.rferl.html#11>. Gjetur, qershor 2009.

¹²¹ Agjensia Telegrafike Shqiptare (ATSH), 97-08-13 <http://www.hri.org/news/balkans/ata/1997/97-08-13.ata.html#04>. Gjetur, qershor 2009.

¹²² 'Albania's New President Ousts 17 Generals', The New York Times, September 7, 1997.

¹²³ Human Rights Developments, Albania Human Rights Watch World Report 1998 http://www.hrw.org/worldreport/Helsinki-01.htm#P125_41527. Gjetur, qershor 2009.

¹²⁴ Milosevic-Nano meeting focuses on Kosovo, <http://www.greekembassy.org/Embassy/content/en/Article.aspx?office=3&folder=259&article=1793>. Gjetur, qershor 2009.



politik ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor.¹²⁵

1998

Mars

12. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana viziton Shqipërinë.¹²⁶ Arsyeya kryesore e vizitës është diskutimi i situatës së sigurisë në Kosovë me zyrtarët shqiptarë.

Qershor

1. NATO hap Zyrën e Partneritetit për Paqe në Shqipëri. Zyra do të luajë rol të drejtpërdrejtë në koordinimin dhe zbatimin me efektivitet të Programit Individual të Partneritetit, në kuadër të Partneritetit për Paqe për vitin 1998.¹²⁷

15. NATO kryen ushtrimet ajrore 'Determined Falcon' në Shqipëri dhe në Republikën Ish-Jugosllave të Maqedonisë, në marrëveshje me dy qeveritë respektive.¹²⁸

Korrik

1. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana viziton Shqipërinë për të diskutuar për situatën në Shqipëri, ku janë strehuar rreth 10 mijë refugjatë kosovarë, shumica gra dhe fëmijë.¹²⁹ Ai deklaron se tërheqja e forcave serbe nga Kosova do të jetë hapi i parë drejt dialogut ndërmjet dy palëve për zgjidhjen e krizës.¹³⁰

Gusht

- Forca të sigurisë shqiptare parandalojnë një atentat ndaj Ambasadës së SHBA

¹²⁵ European Commission, http://ec.europa.eu/enlargement/potential-candidate-countries/albania/eu_albania_relations_en.htm. Gjetur, qershor 2009.

¹²⁶ NATO, Press Release (98)31, <http://www.nato.int/docu/pr/1998/p98-031e.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹²⁷ NATO Press Release (98)69, <http://www.nato.int/docu/pr/1998/p98-069e.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹²⁸ NATO Homepage, <http://www.nato.int/docu/update/1998/9806e.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹²⁹ NATO, Press Release (98)87, <http://www.nato.int/docu/pr/1998/p98-087e.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹³⁰ Agjensia Telegrafike Shqiptare (ATSH), 98-07-03 <http://www.hri.org/news/balkans/ata/1998/98-07-03.ata.html#01>. Gjetur, qershor 2009.



në Tiranë dhe në bashkëpunim me SHBA shkatërrojnë celula të Al-Kaidës në Shqipëri.

16. Ambasada e SHBA në Tiranë redukton personelin dhe aktivitetin e saj në shërbime minimale, mbas atentateve në Ambasadat e SHBA në Tanzani dhe Kenia. 200 marinsa të njësisë elitë SEALS dislokohen në Shqipëri për të siguruar stafin e ambasadës.¹³¹

22. Gjashtë ish zyrtarë të lartë gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike, përfshirë ish Ministrat e Mbrojtjes, të Rendit Publik, dhe Zëvendëskryetarin e SHIK, arrestohen me akuzat se kanë dhënë urdhër për përdorimin e armëve kimike, aviacionit dhe helikopterëve kundër civilëve gjatë protestave të marsit 1997.¹³²

Shtator

11. Vritet pranë zyrave të partisë në Tiranë, deputeti i Partisë Demokratike Azem Hajdari.¹³³

14. Mbështetës të Partisë Demokratike bastisin dhe i vënë zjarrin zyrave dhe automjeteve të Kryeministrit.¹³⁴

19. Parlamenti i heq imunitetin liderit të opozitës Sali Berisha, dhe i hap rrugën Prokurorisë për vazhdimin e hetimit mbi akuzën për tentativë grushti shteti.¹³⁵

27. Shqipëria i bashkohet Bullgarisë Maqedonisë, Greqisë, Italisë, Rumanisë dhe Turqisë në krijimin e një force paqeruajtëse shumëkombëshe të Evropës Juglindore dhe krijojnë SEEBRIG, një brigadë të përbërë nga 3-4 mijë trupa.¹³⁶

- Ahmet Krasniqi, komandanti i të ashtuquajturës Forca të Armatosura të Republikës së Kosovës, FARK, vritet në Tiranë.¹³⁷

- Kryeministri Fatos Nano jep dorëheqjen mbas dështimit për të marrë mbështetjen e koalicionit për riformatimin e kabinetit qeverisës.

¹³¹ Text of a letter from the President to the speaker of the House of Representatives and the President pro tempore of the Senate
<http://www.globalsecurity.org/intell/library/news/1998/08/980818-wh1.htm>.
Gjetur, qershor 2009.

¹³² Agjensia Telegrafike Shqiptare (ATSH), 98-08-26
<http://www.hri.org/news/balkans/ata/1998/98-08-26.ata.html#16>. Gjetur, qershor 2009.

¹³³ BBC World, 'Europe Concern over Albanian instability',
<http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/171535.stm>. Gjetur, qershor 2009.

¹³⁴ Ibid

¹³⁵ 'Albanians Clear the Way for the Arrest of Ex-President', The New York Times, September 19, 1998.

¹³⁶ Steven Lee Mayers, '7 Southeast Europe Nations Form a Joint Military Force', The New York Times, September 27, 1998.

¹³⁷ Tim Judah, 'Kosovo Liberation Army', Perceptions, September-November 2000.



Tetor

2. Pandeli Majko emërohet Kryeministër i qeverisë së re, me Ministër të Rendit Publik Petro Koçi, Ministër të Mbrojtjes Luan Hajdaraga dhe Ministër të Jashtëm Paskal Milo.¹³⁸

28. Parlamenti miraton ligjin e ri për Shërbimin Informativ Kombëtar, duke e transformuar këtë shërbim në një organ tërësisht informativ, pa kompetenca ekzekutive, dhe të shkëputur nga Forcat e Armatosura.¹³⁹

Nëntor

22. Më shumë se 90 për qind e votuesve mbështet Kushtetutën e re të votuar me referendum.¹⁴⁰

28. Presidenti dekreton Kushtetutën në mënyrë simbolike në ditën e pavarësisë së vendit. Kushtetuta përbëhet nga 18 pjesë në të cilat sanksionohet demokracia parlamentare, sovraniteti i popullit, të drejtat themelore të shtetasve dhe, çështje të tjera të rëndësishme. Kushtetuta u vlerësua si një dokument që plotëson kërkesat e një kushtetute moderne Evropiane.¹⁴¹

1999

Shkurt

6. Dështojnë bisedimet e paqes ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë, të mbajtura në Rambuje të Francës.¹⁴²

Mars

15. NATO organizon një seminar për legjislacionin për emergjencat civile në Tiranë me qëllim mbështetjen e autoriteteve shqiptare në krijimin e legjislacionit në këtë fushë, duke ndarë eksperiencën me vende të NATO-s dhe vendet partnere.¹⁴³

¹³⁸ Agjensia Telegrafike Shqiptare (ATSH), 98-10-02

<http://www.hri.org/news/balkans/ata/1998/98-10-02.ata.html#12>. Gjetur, qershor 2009.

¹³⁹ Sotiraq Hroni & Enis Sulstarova, Republic of Albania: Survey on Intelligence Services, in Fluri et al, Security Sector Governance in the Western Balkans: Self-Assessment Studies on Defence, Intelligence, Police and Border Management Reform, DCAF 2007.

¹⁴⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/r18003_en.htm. Gjetur, qershor 2009.

¹⁴¹ Për informacion të mëtejshëm për historinë e kushtetutuesë të Shqipërisë vizito: <http://www.ipls.org/services/others/chist.html>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁴² Tim Judah, 'Kosovo Liberation Army', Perceptions, September-November 2000.

¹⁴³ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/1999/0310e.htm>. Gjetur, qershor 2009.



24. Fillon Operacioni 'Allied Force' kundër objektivave ushtarake të Jugosllavisë mbas dështimit të përpjekjeve diplomatike disa mujore për zgjidhjen paqësore të çështjes së Kosovës.

31. 430,000 refugjatë nga Kosova vërshojnë në Shqipëri dhe Maqedoni që me fillimin e Operacionit 'Allied Force'.

Prill

18. Jugosllavia ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Ministri i Jashtëm Jugosllav akuzon Shqipërinë për përfshirje në sulmet e NATO-s ndaj Jugosllavisë.¹⁴⁴

23-25. Samiti i NATO-s në Uashington i jep Shqipërisë, Planin e Veprimit të Anëtarësimit së bashku me Bullgarinë, Estoninë, Lituanië, Maqedoninë, Rumaninë, Sllovakinë, dhe Slloveninë. Kryetarët e shteteve dhe qeverive anëtare të NATO-s diskutojnë mbi krizën në Kosovë, ndikimin e saj në rajon dhe strategjitë afatgjata për sigurinë dhe stabilitetin në rajonin e Evropës Juglindore më përfaqësues të Bullgarisë, Estonisë, Latuanisë, Maqedonisë, Rumanisë, Sllovakisë, dhe Sllovenisë.¹⁴⁵

28. Këshilli i Atlantikut Verior zgjat misionin e ekipit të ekspertëve për trajnimin e ushtrisë shqiptare për pastrimin e mjeteve shpërthyesë, të përbërë nga vendet anëtare të NATO-s dhe vendet partnere.¹⁴⁶

Maj

26. Komisioni Evropian propozon krijimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit për Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë, Federatën Jugosllave, dhe Maqedoninë, si një kuadër i ri për zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian.¹⁴⁷

Qershor

11. Përfundon Operacioni 'Allied Force' i NATO-s mbi Jugosllavi. Refugjatët kosovarë fillojnë kthimin në Kosovë.

¹⁴⁴ 'Yugoslavia breaks ties with Albania as NATO raids continue'

CNN News: <http://www.cnn.com/WORLD/europe/9904/18/kosovo.02/>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁴⁵ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/1999/upd1999.htm>.

Gjetur, qershor 2009.

¹⁴⁶ Ibid

¹⁴⁷ Delegacioni i Komisionit Evropian (KE) në Shqipëri

http://www.delalab.ec.europa.eu/al/eu_in_see/stabilisation.htm Gjetur, qershor 2009.



Korrik

19. Në Shtabin e NATO-s zhvillohet nja forum konsultimi mbi çështje të sigurisë në Evropën Juglindore. Vendet e NATO-s dhe shtatë vendet fqinje me Kosovën (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Rumania, Sllovenia dhe Maqedonia) takohen për të diskutuar për situatën në Kosovë dhe Bosnje dhe sigurinë në Evropën Juglindore.¹⁴⁸

30. Këshilli i Ministrave të BE-së, i mbajtur në Këln të Gjermanisë, bie dakord për krijimin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore.¹⁴⁹

Gusht

31. NATO krijon Communication Zone West – COMMZ (W), të vendosur në qytetin port të Durrësit.¹⁵⁰

Shtator

- Lideri Socialist Fatos Nano, i cili kishte dhënë dorëheqjen nga posti i kryetarit të partisë më herët në shkurt, akuzon publikisht Kryeministrin Majko për tolerim të trafikut të armëve nga veriu i Shqipërisë drejt Kosovës.

Tetor

- Kryeministri Majko jep dorëheqjen mbasi humbet në garën për kryetar të Partisë Socialiste kundër Fatos Nanos.

27. Presidenti Mejdani ngarkon Ilir Metën për formimin e qeverisë së re.

29. Qeveria e re betohet përpara Presidentit.¹⁵¹

Nëntor

11. Parlamenti miraton ligjin për statusin e nëpunësit civil, i cili konsiderohet si sukses në reformën e administratës civile.¹⁵²

25. Parlamenti miraton ligjin për Policinë e Shtetit, duke bërë përmirësime të

¹⁴⁸ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/1999/0714e.htm>.

Gjetur, qershor 2009.

¹⁴⁹ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/1999/0714e.htm>,

Gjetur, qershor 2009.

¹⁵⁰ Organizata AJFCN, <http://www.afsouth.nato.int/organization/NHQTRANA/index.htm>.

Gjetur, qershor 2009.

¹⁵¹ Rulers, <http://rulers.org/1999-10.html>. Gjetur, qershor 2009

¹⁵² Ligji nr.8549, datë 11.11.1999 'Statusi i nëpunësit civil'



konsiderueshme dhe duke e shkëputur policinë nga Forcat e Armatosura.¹⁵³

2000

Janar

27. Parlamenti miraton për herë të parë dokumentin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, që përcakton themelet e politikave të sigurisë dhe vendim-marrjes në sektorin e sigurisë në Shqipëri.¹⁵⁴ Në të njëjtën ditë u miratua dhe Dokumenti i Politikës së Mbrojtjes.¹⁵⁵

Shkurt

18. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lord Robertson viziton Shqipërinë për të diskutuar reformën në Forcat e Armatosura sipas Planit të Veprimit për Anëtarësim.¹⁵⁶

Mars

- Shqipëria merr 112 milionë Euro ndihmë për rehabilitimin e infrastrukturës në kuadrin e Paktit të Stabilitetit të Evropës Juglindore.

20. Në një vizitë në Shtabin e NATO-s, Kryeministri Ilir Meta dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lord Robertson diskutojnë për reformën e mbrojtjes në Shqipëri, Paktin e Stabilitetit dhe situatën në Mal të Zi.¹⁵⁷

Prill

- Në Shqipëri organizohet stërvitja e Partneritetit për Paqen 'Adventure Express'.¹⁵⁸

Maj

17. Parlamenti miraton ligjin për ndalimin e pastrimit të parave.¹⁵⁹ Me gjithë legjislacionin e përmirësuar, zbatimi i tij qëndron si problem kryesor si pasojë e mungesës së eksperiencës, bashkëpunimit dhe burimeve të pamjaftueshme.

¹⁵³ Ligji Nr. 8553, datë 25.11.1999 'Për Policinë e Shtetit'

¹⁵⁴ Bahja Zija, Security Sector Expert Formation: Achievements and Needs in Albania, DCAF, http://www.dcaf.ch/ssr_wg/pb_secsecexp_bahja.pdf. Gjetur, qershor 2009.

¹⁵⁵ Ligj Nr. 8571, 27.01.2000, 'Për miratimin e Dokumentit të Politikës së Mbrojtjes të RSH-së'. Fletore Zyrtare Nr. 3, 2000, p. 19.

¹⁵⁶ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2000/0216/eng.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁵⁷ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2000/0315/eng.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁵⁸ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2000/0621/eng.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁵⁹ Ligji Nr. 8610, datë 17.05.2000, Për parandalimin e pastrimit të parave.



Qershor

19-20. Këshilli i Bashkimit Evropian në Santa Maria Da Feira, Portugali, deklaroi se vendet anëtare të Procesit të Stabilizim-Asociimit janë kandidatë të mundshëm për anëtarësim në BE.¹⁶⁰

21. Në Shqipëri organizohet stërvitja e Partneritetit për Paqen 'Cooperative Dragon 2000'.¹⁶¹

Korrik

7. Në një rifORMATIM të kabinetit qeverisës, Ilir Gjoni zëvendëson Luan Haxhdaragën si Ministër i Mbrojtjes.

13. Parlamenti ratifikon Konventën Evropiane për Shtypjen e Terrorizmit, si shprehje e ndërgjegjësimit ndaj rritjes së akteve të terrorizmit dhe nevojës për marrjen e masave të efektshme që personat që kanë kryer veprave terroriste të mos i shpëtojnë drejtësisë.¹⁶²

Shtator

8. Shqipëria bëhet vendi i 138 anëtar i Organizatës Botërore të Tregtisë.¹⁶³

Tetor

26. Parlamenti miraton ligjin për gradat dhe karrierën në Forcat e Armatosura që përcakton kriteret dhe autoritetet që vendosin për pranimin në Forcat e Armatosura, gradat, ngritjen në gradë dhe karrierë si dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga karakteri i veçantë i detyrës së ushtarakut, dhe ligjin për autoritetet e komandimit strategjik të Forcave të Armatosura, që përcakton mënyrën e vendimmarrjes dhe nivelet e kontrollit të Forcave të Armatosura.¹⁶⁴

Nëntor

- Bashkimi Evropian miraton zyrtarisht Procesin e Stabilizim-Asociimit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky proces u miratua si strategji politike e BE-së

¹⁶⁰ Santa Maria Da Feira, Këshilli Evropian, 'Përfundimet e Presidencës', 19-20 Qershor - 2000, http://www.europarl.europa.eu/summits/fei1_en.htm. Gjetur, qershor 2009.

¹⁶¹ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2000/0621/eng.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁶² Për më shumë informacion vizitoni Konventën Evropiane për Shtypjen e Terrorizmit, <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/090.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁶³ Qendra për Studime Parlamentare, Revista No.1, 2000 http://www.ascdpd.org/revistaeng/revista1_eng.pdf. Gjetur, qershor 2009.

¹⁶⁴ Faqja zyrtare e OBT, http://www.wto.org/english/news_e/pres00_e/pr189_e.htm. Gjetur, qershor 2009.



për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë gjithë rrugës deri në anëtarësimin e mundshëm.¹⁶⁵

17. Në Tiranë organizohet konferenca 'Zhvillimi ekonomik i Ballkanit, si një faktor i rëndësishëm për sigurinë dhe paqen në rajon', për të diskutuar mbi rolin e BE-së dhe NATO-s në zbatimin e Paktit të Stabilitetit. Konferenca tërhoqi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë nga rrethet politike, ushtarake dhe akademike të vendit si dhe nga NATO, përfaqësitë diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare të vendosura në Shqipëri.¹⁶⁶

Dhjetor

- Shqipëria aderon në Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike,¹⁶⁷ dhe të Lëndëve Psikotrope dhe në Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike.¹⁶⁸

2001

Janar

25. NATO dhe vendet partnere ndërtojnë një projekt asistence për shkatërrimin gjatë 16 muajve të ardhshëm të stokut të minave anti-person. Projekti është i pari në kuadër të Fondit të Besimit të Partneritetit për Paqe për shkatërrimin e minave anti-person.¹⁶⁹

Shkurt

12. Parlamenti miraton ligjin e ri për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, duke forcuar pavarësinë institucionale dhe kushtetuese të institucionit dhe në vlerësim të garantimit dhe respektit për të drejtat e njeriut.¹⁷⁰

¹⁶⁵ Komisioni Evropian, 'Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor', 2005 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/nf5703249enc_web_en.pdf. Gjetur, qershor 2009.

¹⁶⁶ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2000/1115/eng.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁶⁷ Ligj Nr. 8722, datë 26.12.2000, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në 'Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike'

¹⁶⁸ Ligj Nr. 8723, datë 26.12.2000, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në 'Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, e Ndryshuar nga Protokollin e Vitit 1972 për Ndryshimin e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961'

¹⁶⁹ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2001/0122/e0125b.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁷⁰ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Newsletter Korrik-Shtator 2008, http://www.ahc.org.al/kshh/te_tjera/ang%20buletin%20korrik-shtator%202008.pdf. Gjetur, qershor 2009.



Mars

Qeveria e Shqipërisë rreshtohet me komunitetin ndërkombëtar dhe mbështet negociatat e paqes për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet minoritetit etnik shqiptar dhe qeverisë Maqedonase.

Prill

- Qeveria e Shqipërisë kritikohet rëndë nga Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM), për dështimin e politikave kundër trafikimit të qenieve.¹⁷¹

- Në Shqipëri fillon faza e parë e stërvitjes së Partneritetit për Paqen 'Adventure Express 01'.¹⁷²

Maj

- Brigada e Evropës Juglindore, SEEBRIG, bëhet tërësisht operacionale. Detyrat që SEEBRIG pritet të angazhohet përfshijnë operacione mbështetëse paqeruajtëse me mandate të OKB-së ose OSBE-së, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit dhe Kartës së OKB-së.¹⁷³

Qershor

- Këshilli i Bashkimit Evropian i mbledhur në Göteborg, fton Komisionin Evropian për të paraqitur një draft direktive për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimiit me Shqipërinë.¹⁷⁴

- Në zgjedhjet parlamentare Partia Socialiste fiton 73 nga 140 vendet në Parlament. Zgjedhjet shënuan progres në standarde në krahasim me zgjedhjet e mëparshme përse i përket fushatës, mediave dhe administrimit zgjedhor. Megjithatë procesi ishte i tejzgjatur, me debate, dhe i fragmentuar. Procesi mbaroi mbas pesë raundesh votimi.¹⁷⁵

Korrik

12. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lord Robertson, dhe përfaqësuesit e

¹⁷¹ IOM & ICRC, 'Research Report on Third Country National Trafficking Victims in Albania', <http://www.iomtirana.org/al/en/E-Library/Reports/3rd country Research Report 2001.pdf>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁷² Ministria e Punëve të Jashtme në Shqipëri, 'Shqipëria dhe PpP'

http://www.mfa.gov.al/web/Albania_and_Pfp_8609_2.php. Gjetur, qershor 2009.

¹⁷³ Për më shumë informacion vizitoni: www.seebrig.org.

¹⁷⁴ Bashkimi Evropian, Göteborg Këshilli Evropian– Konkluzionet e presidencës, Qershor 2001, http://ue.eu.int/ueDocs/cms_Data/docs/pressdata/en/ec/00200-r1.en1.pdf. Gjetur, qershor 2009.

¹⁷⁵ OSBE, Republika e Shqipërisë, Zgjedhjet Parlamentare 24 Qershor-19 Gusht 2001, http://www.osce.org/documents/odihr/2001/10/1170_en.pdf. Gjetur, qershor 2009.



përhershëm të 19 vendeve shkojnë në Shqipëri për të diskutuar marrëdhëniet NATO-Shqipëri dhe situatën në Republikën Ish-Jugosllave të Maqedonisë.¹⁷⁶

Gusht

- Konflikti në Maqedoni përfundon mbas arritjes së Marrëveshjes së Ohrit, e negociuar nën përkujdesjen e BE-së.¹⁷⁷

Shtator

12. Parlamenti voton qeverinë e re të Partisë Socialiste dhe të katër partive aleate të saj nën drejtimin e Kryeministrit Ilir Meta. Ministër i Mbrojtjes Pandeli Majko, Ministër i Rendit Publik Ilir Gjoni dhe Ministër i Jashtëm Arta Dade.¹⁷⁸

Tetor

15. Parlamenti vendos pjesëmarrjen e Shqipërisë në aleancën kundër terrorizmit ndërkombëtar.¹⁷⁹

Nëntor

- Shqipëria aderon në Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste¹⁸⁰ dhe Konventën Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve.¹⁸¹

Dhjetor

- Parlamenti miratoi Strategjinë Kombëtare kundër Trafikimit Njerëzor, si një përpjekje për të konsoliduar masat institucionale dhe përballuar më mirë fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore.¹⁸²

¹⁷⁶ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2001/0709/e0712a.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁷⁷ 'Ohrid Agreement': www.coe.int/.../OHRID%20Agreement%2013august2001.asp. Gjetur, qershor 2009.

¹⁷⁸ Rulers, <http://rulers.org/2001-09.html>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁷⁹ Ministria e Punëve të Jashtme, Raporti për implementimin nga Republika e Shqipërisë të Deklaratës mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar, Maj 2003, http://mfa.gov.al/web/pub/raporti_20antiterrorizmit2912.pdf. Gjetur, qershor 2009.

¹⁸⁰ Obeid Ghassan, Measures to eliminate international terrorism, Report of the Sixth Committee - United Nations, <http://www.un.org/law/cod/terroris.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁸¹ Kombet e Bashkuara, 'Konventën Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve' <http://untreaty.un.org/English/Terrorism/Conv5.pdf>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁸² Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore: http://www.caaht.com/resources/NationalStrategy2005-7_ALB.pdf. Gjetur, qershor 2009.



2002

Janar

17. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lord Robertson viziton Shqipërinë për të diskutuar mbi ecurinë e vendit në drejtim të plotësisimit të kriterëve të anëtarësimit.¹⁸³

29. Kryeministri Ilir Meta jep dorëheqjen mbas mosmarrëveshjeve me liderin e Partisë Socialiste Fatos Nano.¹⁸⁴

Shkurt

22. Ministri i Mbrojtjes Pandeli Majko emërohet për të dytën herë si Kryeministër i një qeverie të Partisë Socialiste.

- Pjesë të konsiderueshme të territorit të vendit, si në veri ashtu edhe në jug, u izoluan si rezultat i kushteve të rënda të motit. Në një situatë të tillë, siguria e shumë qytetarëve u vu në rrezik për arsye të ndërprerjes së furnizimit me ushqime, energji elektrike dhe mungesës së aftësisë së institucioneve për të rivendosur komunikimin me pjesë të tjera të vendit.

Mars

- Mbas një viti debati të politizuar, parlamenti vendos për t'i propozuar Presidentit shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm Arben Rakipi. Gjykatat Kushtetuese e konsideroi shkarkimin si jo kushtetues por parlamenti emëron Theodhori Sollakun si Prokuror të Përgjithshëm.¹⁸⁵

Qershor

17. KFOR Communication Zone WEST transferohet nga Durrësi në Tiranë, dhe transformohet në Shtabin e NATO-s Tiranë, më mision mbështetjen e Shqipërisë në zbatimin e reformave të kapaciteteve ushtarake si dhe për të kontribuar në komandimin dhe kontrollin e KFOR-it.¹⁸⁶

¹⁸³ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2002/01-january/e0117a.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁸⁴ New York Times, 'As Split of Albania Socialists Worsens, Prime Minister Quits', 22 January 2002, <http://www.nytimes.com/2002/01/30/world/as-split-of-albania-socialists-worsens-prime-minister-quits.html>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁸⁵ Virginie. Jouan, *Nations in Transit- Albania 2003*, Freedom House Report, http://www.freedomhouse.org/inc/content/pubs/nit/inc_country_detail.cfm?page=47&nit=158&year=2003&pf. Gjetur, qershor 2009.

¹⁸⁶ Zyrrat Qendrore të NATO-s Tiranë <http://www.afsouth.nato.int/organization/NHQTIRANA/index.htm>. Gjetur, qershor 2009.



24. Si rezultat i presionit nga Parlamenti Evropian, udhëheqësit politikë Nano and Berisha arrijnë në një kompromis për të zgjedhur një president konsensual, të mbështetur nga dy partitë e mëdha. Parlamenti zgjedh Alfred Moisiun si President.¹⁸⁷

Korrik

25. Parlamenti miraton Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë, e cila përcaktoi si objektiva kryesore ndërtimin e një force ushtarake profesioniste, reduktimin e rekrutëve me detyrim sipas ligjit për shërbimin e detyruar ushtarak, dhe rritjen me 0.1 për qind në vit të buxhetit të mbrojtjes, deri në arritjen në 2 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto.¹⁸⁸

25-31. Kryeministri Pandeli Majko jep dorëheqjen. Parlamenti miraton qeverinë e re të Partisë Socialiste të drejtuar nga Fatos Nano si Kryeministër, Pandeli Majko si Ministër i Mbrojtjes, Ilir Meta si Ministër i Jashtëm dhe Luan Rama Ministër i Rendit Publik.¹⁸⁹

Gusht

- Një togë me 22 vetë personel ushtarak nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë dërgohet në Afganistan për të marrë pjesë në misionin e ISAF.¹⁹⁰

- Mbas disa muajsh debati të politizuar dhe krijimit të një komisioni hetimor parlamentar, Kryeministri Nano, duke përmbushur një nga kërkesat kryesore të Partisë Demokratike, i propozon Presidentit shkarkimin e Kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar Fatos Klosi. Shkarkimi Kryetarit të Shërbimit Informativ dhe i Prokurorit të Përgjithshëm u konsideruan si pjesë e marrëveshjes Nano-Berisha për zgjedhjen e Presidentit konsensual.¹⁹¹

Nëntor

29. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lord Robertson viziton Shqipërinë për të dhënë mesazhin se dera e Aleancës së Atlantikut mbetet e hapur dhe kërkon vazhdimin e reformave. Shqipëria dështoi në marrjen e ftesës për anëtarësim

¹⁸⁷ International Crisis Group, Albania State of Nation 2003, Report no.140 – March 11th 2003.

¹⁸⁸ Caparini. Marina, Security Sector Reform and Post-Conflict Stabilization: The Case of the Western Balkans, SIPRI Yearbook 2004.

¹⁸⁹ Rulers, <http://rulers.org/2002-07.htm>. Gjetur, qershor 2009l .

¹⁹⁰ Home Index, NATO's role in Afghanistan, North Atlantic Treaty Organization, <http://www.nato.int/issues/Afghanistan/index.html>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁹¹ Constitution Watch, Albania. East European Constitutional, Review fall 2002/winter 2003. http://www1.law.nyu.edu/eecr/vol11_12num4_1/constitutionwatch/constwatch.pdf. Gjetur, qershor 2009.



në Aleancë gjatë Samitit të Pragës të mbajtur më 21-22 Nëntor.¹⁹²

2003

Janar

Presidenti i Komisionit Evropian Romano Prodi deklaroi zyrtarisht fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit midis Shqipërisë dhe BE-së.¹⁹³

Prill

Forcat e Armatosura shqiptare dërgojnë një personel ushtarak prej 72 vetë për të marrë pjesë në Operacionin 'Liria e Irakut'.¹⁹⁴

Maj

2. Shqipëria, Kroacia, Maqedonia dhe Sekretari i Departamentit të Shtetit të SHBA-ve nënshkruajnë marrëveshjen për Kartën e Adriatikut, një mekanizëm sipas modelit të Kartës së Baltikut, për nxitjen e bashkëpunimit rajonal në rrugën drejt anëtarësimit në Aleancë të secilit vend.¹⁹⁵

- Me gjithë kundërshtimin e fortë nga Bashkimi Evropian, Shqipëria nënshkroi një marrëveshje dypalëshe me SHBA-në, për mosdorëzimin e personave sipas Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë. Sipas kësaj marrëveshjeje Shqipëria është e detyruar të mos dorëzojë sipas juridiksionit të kësaj gjykate shtetas Amerikanë.¹⁹⁶

Qershor

21. Samiti i BE-së i mbajtur në Selanik të Greqisë konfirmoi Procesin e Stabilizim-Asociimit si politikën e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, mbasi ato të kenë plotësuar kushtet, duke ofruar kështu një perspektivë dhe axhendë konkrete për këto vende.¹⁹⁷

¹⁹² Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2002/11-november/e1129b.htm>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁹³ Komisioni Evropian, http://ec.europa.eu/enlargement/potential-candidate-countries/albania/eu_albania_relations_en.htm. Gjetur, qershor 2009.

¹⁹⁴ Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, <http://www.gs.mil.al/mat.php?idr=79&idm=-451&lang=EN>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁹⁵ Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, <http://www.state.gov/p/eur/rls/fs/112766.htm>.

¹⁹⁶ Gjeni dokumentin zyrtar në: <http://www.state.gov/documents/organization/97155.pdf>. Gjetur, qershor 2009.

¹⁹⁷ Ministria e Punëve të Jashtme - Shqipëri, Marrëveshja për Bashkëpunimin Tregtar dhe Ekonomik dhe Procesin e Stabilizim Asociimit, http://www.mfa.gov.al/web/The_Agreement_on_Trade_and_Economic_Coop_29_2.php. Gjetur, qershor 2009.



Korrik

- 3.** Shqipëria miraton ligjin për zbatimin e Konventës për Armët Kimike.¹⁹⁸
- 17.** Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lord Robertson viziton Shqipërinë për bisedime dy-ditore mbi përpjekjet e Shqipërisë për anëtarësimin në NATO dhe reformën e mbrojtjes.¹⁹⁹
- 18.** Ministri i Jashtëm Ilir Meta jep dorëheqjen, mbas mosmarrëveshjeve me Kryeministrin Fatos Nano.
- 22.** Marko Bello propozohet si Ministër i Jashtëm, por emërtesa e re nuk arrin të marrë votat e nevojshme në Parlament, duke e lënë këtë pozicion vakant.
- 29.** Luan Hajdaraga caktohet si Ministri i Jashtëm *ad interim*.²⁰⁰
- 24.** Shqipëria miraton ligjin për krijimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda me qëllim rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si dhe për të rritur cilësinë e gjyqimit.²⁰¹
- 31.** NATO miraton zyrtarisht një projekt për shkatërrimin e 11.6 mijë tonë municione për armë të vogla dhe të lehta në Shqipëri.²⁰²

Tetor

- 17.** Ministri i Rendit Publik Luan Rama shkarkohet mbasi akuzohet se ka dhunuar fizikisht një gazetar.
- 23.** Propozimet e Kryeministrit Fatos Nano për emërimin e Namik Dokles si Ministër i Jashtëm dhe të Fatmir Xhafës si Ministër i Rendit Publik nuk marrin votat e nevojshme në Parlament.
- 25.** Igli Toska emërohet si Ministri i Rendit Publik *ad interim*.²⁰³

Dhjetor

- 4.** Parlamenti miraton ligjin për interceptimin e telekomunikimeve i cili bën një rregullim të përgjithshëm të realizimit të përgjimeve nga institucionet

¹⁹⁸ Ligj Nr. 9092, 03.07.2003, 'Për zbatimin e "Konventës për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre", Fletore Zyrtare, Nr. 63, 2003, p. 2809.

¹⁹⁹ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2003/07-july/e0717a.htm>. Gjetur, qershor 2009.

²⁰⁰ Rulers, <http://rulers.org/2003-07.html>. Gjetur, qershor 2009.

²⁰¹ Ligji Nr.9110, datë 24.07.2003, Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave për Krime të Rënda'

²⁰² Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2003/07-july/e0717a.htm>. Gjetur, qershor 2009.

²⁰³ Rulers, <http://rulers.org/2003-10.html>. Gjetur, qershor 2009.



informative dhe të zbatimit të ligjit.²⁰⁴

29. Parlamenti arrin të miratojë mbas disa muajsh Kastriot Islamin si Ministër i Jashtëm dhe Igli Toskën si Ministër i Rendit Publik.²⁰⁵

2004

Janar

22. Parlamenti miraton një ligj të ri për gradat dhe karrierën në Forcat e Armatosura.²⁰⁶

Shkurt

- Opozita organizon protesta ku kërkon dorëheqjen e Kryeministrit Fatos Nano dhe krijimin e kushteve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme.²⁰⁷

Maj

7. Qeveria miraton një strategji pesëvjeçare për luftën kundër narkotikëve e cila synon krijimin e një sistemi të efektshëm për frenimin e këtij trafiku dhe përmirësimin e luftës kundër prodhimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike.²⁰⁸

27. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer viziton Shqipërinë dhe nënvizon faktin se dera e NATO-s qëndron e hapur, por anëtarësimi varet nga reformat.²⁰⁹

Qershor

17. Ministrat e Jashtëm të Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë, paraqesin në Shtabin e NATO-s një strategji të përbashkët për anëtarësimin në Aleancë.²¹⁰

²⁰⁴ Dyrmishi. Arjan, Interceptimi dhe Telekomunikimet në Shqipëri – Kontrolli dhe Mbikëqyrja, IDN Qendra për Studimet e Sigurisë, www.idmalbania.org. Gjetur, qershor 2009.

²⁰⁵ Rulers, <http://rulers.org/2003-12.html>. Gjetur, qershor 2009.

²⁰⁶ Simon Jeffrey, Roadmap to NATO Accession: Preparing for Membership, The Institute for National Strategic Studies, http://www.ndu.edu/inss/strforum/SR_02/SR_02.htm. Gjetur, qershor 2009.

²⁰⁷ Agolli. Ilirian, 'Mijëra vetë marrin pjesë në protestën e opozitës kundër qeverisë së kryeministrit Nano', Zëri i Amerikës, 21 Shkurt 2004. <http://www.voanews.com/albanian/archive/2004-02/a-2004-02-21-6-1.cfm?moddate=2004-02-21>. Gjetur, qershor 2009.

²⁰⁸ Vendim Nr 292 datë 07.05.2004, Këshilli i Ministrave, Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare Antidrogë 2004-2010

²⁰⁹ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2004/05-may/e0526a.htm>. Gjetur, qershor 2009.

²¹⁰ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2004/06-june/e0617a.htm>. Gjetur, qershor 2009.



Nentor

11. Parlamenti vendos të vazhdojë mbajtjen e prezencës në misionin ushtarak në Bosnje dhe Hercegovinë, emri i të cilit do të jetë ALTHEA dhe drejtohet nga BE.²¹¹

25. Parlamenti miraton dokumentin e rishikuar të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare i cili përbën një version të përmirësuar të vlerësimit të kërcënimeve dhe rreziqeve si dhe të masave për mbrojtjen e sigurisë kombëtare.²¹²

2005

Prill

Shqipëria deklaron dy njësi si kontigjent për forca të NATO-s, në 'Pool of forces', në kuadër të zbatimit të Konceptit të Kapaciteteve Operacionale, si një mekanizëm nëpërmjet të cilit njësitë në dispozicion të operacioneve të Partneritetit për Paqe vlerësohen dhe integrohen me forcat e NATO-s për të rritur efektivitetin operacional.²¹³

Maj

4. Shqipëria kontraktonte kompaninë amerikane Lockheed Martin për ndërtimin e sistemit të integruar të mbikëqyrjes së hapësirës. Sistemi i ri, që parashikohet të realizohet brenda katër viteve të ardhshme, do të shërbejë përveç të tjerave edhe si një instrument në luftën kundër terrorizmit dhe trafikëve si dhe do të rrisë sigurinë e kufijve.^{214 215}

20. Parlamenti miraton dokumentin e rishikuar të Strategjisë Ushtarake. Dokumenti vlerëson mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm të sigurisë, progresin e transformimit të Forcave të Armatosura si dhe ecurinë e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FA dhe reflekton ndryshimet e nevojshme për

²¹¹ Ligji Nr. 9315 datë 11.11.2004, 'Për dërgimin e kompanisë paqeruajtëse shqiptare në Bosnjë-Hercegovinë, për të marrë pjesë në operacionin 'ALTHEA' të Bashkimit Europian

²¹² Republika e Shqipërisë, Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë http://merln.ndu.edu/whitepapers/Albania_English-2004.pdf. Gjetur, qershor 2009.

²¹³ Ministria e Punëve të Jashtme, Shqipëria dhe PFP

http://www.mfa.gov.al/web/Albania_and_PfP_8609_2.php. Gjetur, qershor 2009.

²¹⁴ Selimaj, Erlis, Lockheed Martin, Albania ink deal for maritime surveillance system, SETimes, http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2006/08/25/feature-02. Gjetur, qershor 2009.

²¹⁵ Ligji Nr. 9384 datë 04.05.2005, Për miratimin e Projekt-kontratës mes qeverisë së RSH dhe Lockheed Martin Global Inc për modernizimin e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror.



konceptin, misionin, organizimin e FA.²¹⁶

Korrik

3. Mbahen zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, por për arsye të parregullsive dhe klimës politike të tensionuar rezultatet nuk do të dalin deri në fillim të shtatorit.²¹⁷

Gusht

Një njësi më personel mjekësor ushtarak dërgohet me mision në Afganistan, në përbërje të një ekipi të përbashkët mjekësor, të formuar së bashku me Kroacinë dhe Maqedoninë, në kuadër të Kartës së Adriatikut.²¹⁸

Shtator

2. Koalicioni i partive i drejtuar nga Partia Demokratike shpallet fitues i zgjedhjeve parlamentare të 3 korrikut, mbas disa javë vonesash në nxjerrjen e rezultatit. Sipas organizatave monitoruese ndërkombëtare, zgjedhjet shënuan progres por plotësuan vetëm pjesërisht rekomandimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe demokratike.²¹⁹

12-13. Në kuadër të Partneritetit për Paqe, organizohet në Shqipëri stërvitja e përbashkët 'Cooperative Engagement 05', në të cilën marrin pjesë 1.500 trupa nga vendet anëtare dhe partnere të NATO-s.²²⁰

Tetor

Shqipëria nënshkruan në Athinë Traktatin e Energjisë me Komisionin Evropian, i cili parashikohet të rregullojë tregun rajonal të energjisë. Kjo iniciativë synon krijimin e një tregu të integruar të gazit natyror dhe energjisë elektrike ndërmjet palëve, mbi bazën e interesit të përbashkët dhe solidaritetit.²²¹

²¹⁶ Ligji Nr.9419, datë 20.5.2005, 'Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë'

²¹⁷ Inter-Parliamentary Union, http://www.ipu.org/parline-e/reports/2001_E.htm. Gjetur, qershor 2009.

²¹⁸ Vincent Morelli, Carl Ek, Paul Belkin, Steven Woehrel, Jim Nichol, 'NATO Enlargement: Albania, Croatia, and Possible Future Candidates', Congressional Research Service <http://www.fas.org/sgp/crs/row/RL34701.pdf>. Gjetur, qershor 2009.

²¹⁹ OSCE/ODHIR, Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet Parlamentare 3 Korrik 2003. http://www.osce.org/documents/odih/2005/11/16905_en.pdf. Gjetur, qershor 2009.

²²⁰ Marrëdhëniet e NATO's me Shqipërinë.

http://www.nato.int/cps/en/SID-7467F0AB-31D46D24/natolive/topics_48891.htm.

²²¹ Komisioni Evropian, Traktati: Krijimi i Komunitetit Evropian

http://ec.europa.eu/energy/electricity/south_east/doc/treaty/treaty.pdf. Gjetur, qershor 2009.



Nëntor

30. Kryeministri Sali Berisha, viziton Shtabin e NATO-s dhe prezanton planet e qeverisë për reformat në fushën e mbrojtjes.²²²

Dhjetor

21. Kongresi i SHBA-ve miraton një Rezolutë për anëtarësimin në NATO të vendeve të Kartës së Adriatikut.²²³

2006

Prill

3. Parlamenti miraton një ligj për vendosjen e moratoriumit tre vjeçar që ndalon qarkullimin e mjeteve lundruese motorike të shpejta në të gjithë ujërat territoriale të Shqipërisë. Kjo masë drastike u ndërmor në kuadër të përpjekjeve për të frenuar trafiqet e paligjshme të njerëzve dhe narkotikëve.²²⁴

Maj

5. Shqipëria pranon të strehojë pesë shtetas kinezë me kombësi ujqure, të cilët kishin qenë të mbajtur në burgun e Gjirit të Guantanamo, por që nuk mund të kthehen në Kinë për arsye të represionit politik.²²⁵ Grupet ndërkombëtare të drejtave të njeriut e akuzojnë Kinën se përdor metoda represioni ndaj lëvizjes separatiste të nëntë milion ujqurëve në Xingjang.²²⁶

7. Në një takim me liderët e të tre vendeve, në Dubrovnik të Kroacisë, Zëvendës Presidenti i SHBA Dick Cheney shprehu mbështetjen e NATO-s për aspiratat për anëtarësim të Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë.²²⁷

²²² Faqja zyrtare e NATO-s,

<http://www.nato.int/docu/update/2005/11-november/e1130a.htm>. Gjetur, qershor 2009.

²²³ Rezoluta 342 e Senatit të SHBA-ve, <http://zagreb.usembassy.gov/policy/focus/nato/res342.html>. Gjetur, qershor 2009.

²²⁴ Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, *International Narcotics Control Strategy Report - Europe and Central Asia*,

<http://www.state.gov/p/inl/rls/nrcrpt/2007/vol1/html/80860.htm>. Gjetur, qershor 2009.

²²⁵ Neil A. Lewis, 'Freed From Guantánamo but Stranded Far From Home', *The New York Times*, August 15, 2006.

²²⁶ Golden Tim, Chinese Leave Guantánamo for Albanian Limbo, *The New York Times*, June 10 2007, <http://www.nytimes.com/2007/06/10/world/europe/10resettle.html>. Gjetur, qershor 2009.

²²⁷ Çështje të diskutuara nga Zv. Presidenti Dick Cheney, Kryeministri i Kroacisë Ivo Sanader, Kryeministri i Maqedonisë Vlado Buckovski, and Kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha në një Takim të tre Liderëve të Adriatikut. http://www.southeasteurope.org/subpage.php?sub_site=2&id=17118&head=if&site=4. Gjetur, qershor 2009.



- Një shpërthim në një kompleks prej 6 depush ushtarake, në fshatin Dhëmban të Tepelenës, në jug të vendit, shkakton shkatërrime masive dhe vdekjen e katër personave, duke nxjerrë në pah problemin e municioneve të tepërta të vendosura në depo pranë zonave të banuara.²²⁸

Qershor

Nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me BE-në, në Këshillin e Çështjeve të Përgjithshme dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në Luksemburg.²²⁹

Korrik

6. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer viziton Kroacinë dhe Shqipërinë dhe përcjell mesazhin se anëtarësimi nuk është çështje *'në qoftë se'* por *'kur'*. Ai përgëzon të dy vendet për progresin mbresëlënës që kanë bërë në përgatitjet për anëtarësimin në Aleancë.²³⁰

2007

Maj

10-11. Në Shqipëri mbahet takimi vjetor i Grupit Këshillimor të Politikave Euro-Atlantike i Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik, për të diskutuar integrimin e Ballkanit Perëndimor në komunitetin e vendeve Euro-Atlantike, thellimin dhe zgjerimin e marrëdhëniet të partneritetit me NATO-n dhe sfidën për sigurimin e mbështetjes së publikut për bashkëpunimin në fushën e sigurisë.²³¹

24. Gjatë vizitës në Shtabin e NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer, i kërkon Kryeministrit Berisha vazhdimin e reformave politike.²³²

Qershor

4. Parlamenti miraton ligjin për Policinë e Shtetit, i cili përcakton normat

²²⁸ 'L'Albanie sur un baril de poudre', <http://www.avmaroc.com/actualite/albanie-baril-poudre-a124559.html>. Gjetur, qershor 2009.

²²⁹ Komisioni Evropian- Zgjerimi – Shqipëria, Marrëdhëniet Shqipëri-BE http://ec.europa.eu/enlargement/potential-candidate-countries/albania/eu_albania_relations_en.htm. Gjetur, qershor 2009.

²³⁰ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2006/07-july/e0706a.htm>. Gjetur, qershor 2009.

²³¹ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2007/05-may/e0524a.html>. Gjetur, qershor 2009.

²³² Ibid



dhe procedurat e aktivitetit të policisë si dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të punonjësve të policisë në kuadër të policimit në përputhje me standardet demokratike.²³³

10. Presidenti Bush viziton Shqipërinë i cili përbën një eveniment historik për vendin, pasi është vizita e parë e një presidenti të SHBA-ve. Bush deklaroi se OKB-ja duhet që sa më shpejt t'i akordojë Kosovës pavarësinë.²³⁴

Korrik

Mbas tre raundesh votimi të dështuara, Parlamenti zgjedh zëvendës Kryetarin e Partisë Demokratike Bamir Topi si President. Tre raundet e para dështuan në gjetjen e një kandidati konsensual për president, duke ngritur tensionin politik dhe rrezikuar çuarjen e vendit në zgjedhje të parakohshme.²³⁵

Gusht

Shqipëria bëhet vendi i parë në botë që përfundon shkatërrimin e plotë të stokut të lëndëve kimike luftarake të ngelura nga periudha e regjimit komunist, në zbatim të Konventës për Armët Kimike. Që në vitin 2004, Presidenti i SHBA-ve kishte autorizuar përdorimin e 20 milionë dollarëve, nga programi Nunn-Lugar i Bashkëpunimit për Reduktimin e Kërcënimeve, të destinuar për vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, duke e bërë Shqipërinë vendin e vetëm ku fonde të tilla u autorizuan për përdorim jashtë destinacionit.²³⁶

Tetor

4. Mbaron projekti i filluar në dhjetor 2002, i mbështetur nga Fondi i Besimit i NATO-s dhe Partneriteti për Paqe. Projekti i dha mundësinë Shqipërisë që t'i përgjigjej me sukses problemit të tepricës së municioneve për armë të vogla dhe të lehta, duke shkatërruar 105 milionë fishekë për armë të vogla, 2 milionë granata dore dhe 130 mijë predha mortaje.²³⁷

7. NATO, vende të Partneritetit për Paqe dhe vende të Mesdheut shpallin

²³³ Ligj Nr. 9749, datë 4.6.2007, Për Policinë e Shtetit

²³⁴ Bush greeted as hero in Albania.

<http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/6738055.stm>. Gjetur, qershor 2009.

²³⁵ Bamir Topi, President i Shqipërisë, http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/info/CountryPage/setimes/resource_centre/bios/topi_bamir?country=Albania. Gjetur, qershor 2009.

²³⁶ Ambasada e SHBA-ve në Shqipëri, 'Shqipëria Përfundon Shkatërrimin e Armëve Kimike Vdekjeprurëse', 17.08.2007

http://albanian.tirana.usembassy.gov/07pr_0817.html. Gjetur, qershor 2009.

²³⁷ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2007/10-october/index.html>. Gjetur, qershor 2009.



zyrtarisht në Tiranë fillimin e dy stërviitjeve të përbashkëta, 'Cooperative Longbow 07' dhe 'Cooperative Lancer 07' (CO LW / CO LR 07).²³⁸

19. Gjatë një vizite të Presidentit të Shqipërisë në NATO, Sekretari i Përgjithshëm Jaap de Hoop Scheffer i tregon atij se 'reforma të mëtejshme janë tepër të rëndësishme' dhe se 'biletat për ftesën (për anëtarësim në NATO) nuk janë prerë akoma'.²³⁹

- Parlamenti krijon një komision hetimor parlamentar mbi interceptime të paligjshme, të kërkuar nga Partia Kristian Demokrate.

Nëntor

- Mbas debatesh të gjata dhe të politizuara, dhe në vijim të punës së një komisioni hetimor parlamentar, Presidenti dekreton shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm Theodhori Sollaku. Edhe në këtë rast, Gjykata Kushtetuese e konsideroi procedurën si jo kushtetuese, por parlamenti voton pro kandidaturës së propozuar nga Presidenti, duke emëruar Ina Ramën si gruaja e parë që merr këtë detyrë.²⁴⁰

Dhjetor

27. Parlamenti miraton dokumentin e rishikuar të Strategjisë Ushtarake në prag të anëtarësimit në NATO.²⁴¹

2008

Janar

1. Në përfundim të negociatave që kishin filluar që në Nëntor 2006, hyn në fuqi Marrëveshja për Lehtësimin e Vizave me Bashkimin Evropian. Marrëveshja synon lehtësimin në marrjen e vizave për qëndrimet jo më të gjatë se 90 ditë për një periudhë 180 ditore të shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së.²⁴²

²³⁸ Ibid

²³⁹ Ibid

²⁴⁰ Weekly News, A Weekly Bulletin of the Council of Ministers Republic of Albania, Year 1/ Number 27 26 November 2007. <http://www.km.gov.al/skedaret/1196179084-Weekly%20news%20nr%2027.pdf>. Gjetur, qershor 2009.

²⁴¹ Ligji Nr. 9858 datë 27-12-2007, 'Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë'.

²⁴² Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian, Marrëveshja ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për Lehtësimin lëshimit të Vizave me Bashkimin Evropian 19.12.2007, http://www.delalb.ec.europa.eu/files/visa_facilitation_agreement-EU_Official_Journal.pdf. Gjetur, qershor 2009.



21. Parlamenti shqiptar miraton rezolutën për anëtarësimin në NATO. Rezoluta u mbështet si nga shumica ashtu edhe nga partitë opozitare.²⁴³

30. Kryeministri Sali Berisha viziton Shtabin e NATO-s për të diskutuar me Sekretarin e Përgjithshëm mbi raportin e progresit të Shqipërisë në kuadër të Planit të Veprimit për Anëtarësim. Të gjitha vendet e Aleancës ranë dakord sa Shqipëria ka bërë progres në zbatimin e reformave politike, ekonomike dhe ushtarake por përsëri ka detyra për të përmbushur.²⁴⁴

Mars

3. Parlamenti amendon ligjin për interceptimin e telekomunikimeve. Ligji i amenduar i jep Ministrit të Brendshëm akses të barabartë me Drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Prokurorin e Përgjithshëm. Amendimet u kundërshtuan nga partitë e opozitës duke i konsideruar ato si një përpjekje të Partisë Demokratike për të kontrolluar opozitën.²⁴⁵

16. 26 vetë u vranë, qindra të tjerë u plagosën dhe qindra banesa dhe biznese u dëmtuan si rezultat i një shpërthimi në një bazë ushtarake që përdorej për demontimin e municioneve në fshatin Gërdec, pranë Tiranës.²⁴⁶

Prill

3. Shqipëria merr ftesën për fillimin e bisedimeve për anëtarësim gjatë Samitit të NATO-s në Bukuresht të Rumanisë.²⁴⁷

25. Shqipëria fillon bisedimet për anëtarësim në Aleancë mbas marrjes së ftesës gjatë Samitit të Bukureshtit.²⁴⁸

- Në një raport të Misionit të UNDAC mbi shpërthimin në Gërdec, publikohen të dhëna se me gjithë progresin e bërë në shkatërrimin e municioneve të tepërta, Shqipëria vlerësohet se ka akoma 100 mijë tonë municione të tjera të tepërta.²⁴⁹

²⁴³ Parlamenti i Shqipërisë, 'Rezoluta për anëtarësimin Shqipërisë në NATO'
<http://www.parlament.al/>.

²⁴⁴ Faqja zyrtare e NATO-s,

<http://www.nato.int/docu/update/2008/01-january/e0130a.html>. Gjetur, qershor 2009.

²⁴⁵ Ligji Nr. 9885 datë 03.03.2008, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9157, datë 04.12.2003 'Për përgjimin e telekomunikimeve'

²⁴⁶ 'Munitions depot explodes in Albania', The New York Times, March 16, 2008.

²⁴⁷ Faqja zyrtare e NATO-s, <http://www.nato.int/docu/update/2008/04-april/index.html>.

Gjetur, qershor 2009.

²⁴⁸ Ibid

²⁴⁹ UNDAC, Assessment and Recommendations Following the Gerdec Explosion, April 8th 2009, <http://www.unep.org/greenstar/publications/Report%20Ammunition%20Blast,%20Albania,%202008%5B2%5D.pdf>. Gjetur, qershor 2009.



Qershor

16. Me kërkesë e Kryeministrit Berisha, Presidenti shkarkon nga detyra Shefin e Shtabit të Përgjithshëm Luan Hoxha, për përgjegjësi në lidhje me shpërthimin në Gërdec.²⁵⁰

16. Parlamenti i heq imunitetin parlamentar Ministrit të Mbrojtjes Fatmir Mediu, duke i hapur rrugën hetimeve të mëtejshme ndaj tij mbi dyshime për përgjegjësi në shpërthimin e ndodhur në Gërdec.²⁵¹

Korrik

9. Vendet aleate të NATO-s nënshkruajnë protokollin e anëtarësimit të Shqipërisë në Aleancë. Në vijim të nënshkrimit nga secili vend anëtar i NATO-s, parlamentet respektive do të fillojnë ratifikimin e Protokolleve të Anëtarësimit.²⁵²

- Shqipëria dërgon 62 vetë personel ushtarak për të marrë pjesë në misionin 'EUFOR Chad/RCA' të udhëhequr nga BE-ja në Republikën e Çadit në Afrikën Qendrore. Trupat shqiptare që janë të inkuadruara nën komandën e kontigjentit francez marrin pjesë për herë të parë në një mision ushtarak në Afrikë.²⁵³

Shtator

24. Shqipëria kontraktin kompaninë franceze SAGEM SECURITE, për prodhimin e pasaportave dhe kartave të identitetit biometrike për shtetasit shqiptarë.²⁵⁴

Dhjetor

3. Ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s deklarojnë se Shqipëria

²⁵⁰ BIRN, 'Albania's Army Chief of Staff Sacked'

<http://balkaninsight.com/en/main/news/11051/?tpl=297>. Gjetur, qershor 2009.

²⁵¹ Departamenti i Shtetit të ShBA, '2008 Human Rights Report: Albania'

<http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2008/eur/119064.htm>. Gjetur, qershor 2009.

²⁵² NATO, 'NATO Allies sign Accession Protocols for Albania and Croatia', 09 Jul. 2008, http://www.nato.int/cps/en/SID-80FADD50-F2042F0E/natolive/news_8091.htm?selectedLocale=en. Gjetur, qershor 2009.

²⁵³ Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, 'Albania sends the First Peacekeeping Contingent in Chad and the third in Herat', <http://www.mod.gov.al/botime/html/revista/2008/08/faqe13.htm>. Gjetur, qershor 2009.

²⁵⁴ 'Albania selects Sagem Sécurité for secure ID documents'

<http://www.sagem-securite.com/eng/site.php?spage=04010822>. Gjetur, qershor 2009.

²⁵⁵ Congressional Research Service, 'NATO enlargement: Albania, Croatia, and Possible future candidates', <http://openncrs.com/document/RL34701/>



dhe Kroacia pritet të jenë vendet më të reja anëtare të Aleancës, duke hapur kështu rrugën për anëtarësime të ardhshme nga vende të tjera partnere.²⁵⁵

19. Shqipëria tërheq kontigjentin e saj prej 218 trupash nga Iraku. Gjatë këtij misioni 1368 personel ushtarak i Forcave të Armatosura Shqiptare shërbyen në qytetin e Mosulit, në veri të Irakut.^{256 257}

30. Parlamenti miraton një ligj për lustrimin sipas të cilit zyrtarë të lidhur me shërbimin sekret gjatë periudhës së komunizmit duhet të largohen nga pozicionet zyrtare. Ligji u kundërshtua nga partitë e opozitës dhe komuniteti ndërkombëtar, si dhe u vu në diskutim kushtetutshmëria e tij.²⁵⁸

2009

Prill

3. Shqipëria pranohet si vend anëtar me të drejta të plota në NATO.²⁵⁹

28. Shqipëria aplikon zyrtarisht për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Megjithëse, sipas vlerësimeve të ekspertëve Shqipëria nuk parashikohet të anëtarësohet në BE përpara vitit 2015, aplikimi konsiderohet si hap i rëndësishëm drejt anëtarësimit të plotë.²⁶¹

Qershor

29. Në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, koalicioni i udhëhequr nga Partia Demokratike fiton 70 nga 140 vendet në parlament. Megjithëse, zgjedhjet shënuan progres në drejtim të regjistrimit dhe identifikimit të votuesve, ky progres u errësua nga politizimi i aspekteve teknike dhe dhuna gjatë procesit, të cilat lëkundën besimin e publikut në procesin zgjedhor.²⁶²

²⁵⁶ Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, http://www.mod.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=35&Itemid=74&lang=sq. Gjetur, qershor 2009.

²⁵⁷ *The Associated Press*, Albania Now Pulling Its 218 Troops out of Iraq, December 18 2008, <http://abcnews.go.com/International/wireStory?id=6486521>. Gjetur, qershor 2009.

²⁵⁸ 'CoE urges changes to Albanian lustration law', http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/newsbriefs/2009/02/13/nb-11. Gjetur, qershor 2009.

²⁵⁹ Organizata e Atlantikut të Veriut, 'Vendet Anëtare', http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_52044.htm?selectedLocale=en. Gjetur, qershor 2009.

²⁶⁰ EurActiv News, 'Albania files EU membership application', <http://www.euractiv.com/en/enlargement/albania-files-eu-membership-application/article-181819>. Gjetur, qershor 2009.

²⁶¹ BBC, Albania applies for EU membership, 28 April 2009 <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/8023127.stm>. Gjetur, qershor 2009.

²⁶² 29 June 2009 - Improvements in Albania's election process, but violations persist, observers say, <http://www.nato-pa.int/default.asp?SHORTCUT=1878>



Publikuar nga:
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
Tiranë
www.idmalbania.org

Rr. Shenasi Dishnica, Nr. 37
P.O.Box 8177, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 240 0241, Fax: +355 4 240 0640
E-mail: info@idmalbania.org

Autorët:
Arian Dyrmishi
Besnik Baka
Mariola Qesaraku

Shtypur në:
Gent Grafik

ISBN 978 – 99956 – 831 – 2 – 2
Tiranë, 2011

© DCAF & IDM, 2010
Të gjitha të drejtat e Autorit.